

MANUAL

PËR MONITORIMIN E GJUHËS
SË URREJTJES DHE DISKRIMINIMIT
ME BAZË GJINORE NË SHQIPËRI



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

MANUAL

**PËR MONITORIMIN E GJUHËS
SË URREJTJES DHE DISKRIMINIMIT
ME BAZË GJINORE NË SHQIPËRI**

Prodhuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

© Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2021

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret dhe kopjohet lirisht për qëllime edukimi dhe qëllime jokomerciale, me kusht që në çdo riprodhim të përmendet OSBE-ja si burimi i këtij dokumenti.

Përgatitur nga: Viacheslav Likhachev – Pjesa I

Iris Luarasi – Pjesa II

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë, domosdoshmërisht, qëndrimin zyrtar të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Dizenjoi: Graphic Line-01

Citimi: Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, “Manual për monitorimin e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit me bazë gjinore në Shqipëri” (Tiranë, 2021)

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E MANUALIT

Hartimi dhe publikimi i këtij Manuali është financuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri (këtej e tutje “Prezenca”) në kuadrin e projektit “Promovimi dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri” – faza IV. Hartimi i Manualit është fryt i bashkëpunimit të konsoliduar mes Prezencës dhe Institucioneve Kombëtare për Të Drejtat e Njeriut (IKDNj) në Shqipëri dhe synon të forcojë kapacitetet monitoruese dhe kuadrin institucional për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Në këtë kuadër, Prezenca ka përpiluar një vlerësim të nevojave për IKDNj-të në Shqipëri, përkatësisht Avokatin e Popullit (AP) dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) për të identifikuar nevojat dhe sfidat konkrete si dhe praktikatat më të mira të përdorura nga IKDNj-të në monitorimin, mbledhjen e të dhënave dhe raportimin e problematikave të të drejtave të njeriut dhe diskriminimit. Raporti i hartuar shërbeu si bazë për zhvillimin e këtij manuali në fushën e mosdiskriminimit për personelin e IKDNj-ve.

Manuali ka përfituar nga ekspertiza e konsulentëve të specializuar në gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin ndaj grave, të kontraktuar nga Prezenca për këtë qëllim, si dhe nga puna e Departamentit për Sundimin e Ligjit dhe të Drejtat e Njeriut. Manuali ka për qëllim të ofrojë mjete praktike, burime dhe metodologji të përqendruar për IKDNj-të në Shqipëri për të rritur kapacitetet e tyre monitoruese në fushën e mosdiskriminimit. Fokusi specifik është te gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi me bazë gjinore, problematika këto që u shfaqën - nga rezultatet e vlerësimit të nevojave - si veçanërisht të rëndësishme për punën e IKDNj-ve.

Në veçanti, ky manual:

- Jep një prezantim të përgjithshëm me fenomenet e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit me bazë gjinore;
- Përshkruan përjasje metodologjike për monitorimin dhe dokumentimin;
- Jep një panoramë të standardeve ndërkombëtare për gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin me bazë gjinore;
- Prezanton mjete praktike me shembuj specifike për mbledhjen e të dhënave, që lehtësojnë punën e personelit të IKDNj-ve në monitorimin dhe raportimin e diskriminimit me bazë gjinore dhe gjuhës së urrejtjes.

PASQYRA E LËNDËS

Qëllimi dhe objektivat e Manualit	3
Përkufizime	7

PJESA I - MONITORIMI I GJUHËS SË URREJTJES NË SHQIPËRI

HYRJE	12
TË KUPTOJMË GJUHËN E URREJTJES: SFONDI TEORIK	13
Përkufizimi i gjuhës së urrejtjes	13
Rreziku dhe pasojat e gjuhës së urrejtjes	15
Roli i medias	17
Teoria e Përgjithshme e Ksenofobisë “Ne k. ATYRE”:	18
KUADRI LIGJOR	21
Standardet ndërkombëtare	21
Legjislacioni shqiptar	24
MONITORIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT	26
Dokumentimi dhe monitorimi	26
Parimet bazë të monitorimit të të drejtave të njeriut	27
Qëllimet e monitorimit	28
Llojet e gjuhës së urrejtjes	28
Gradimi i gjuhës së urrejtjes	31
Objektet e gjuhës së urrejtjes	32
METOLOGJIA E MONITORIMIT TË GJUHËS SË URREJTJES	33
Sistemi i mbledhjes së të dhënave	33
Monitorimi i medias së shkruar	33
Mediat online dhe faqet e internetit	35
Rrjetet sociale	36
Monitorimi i Radios dhe Televizionit	37
Deklaratat verbale	38
Marrja e Ankesave dhe Intervistimi	38
PËRFUNDIM	40
SHTOJCA 1	41
SHTOJCA 2	44
SHTOJCA 3	52

REFERENCAT	57
Dokumentet ligjore dhe të politikave	57
Udhëzuesit, Manualet dhe Raportet	57
Literatura	59

PJESA II - MONITORIMI I DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE DHE DHUNA ME BAZË GJINORE

LISTA E SHKURTIMEVE	66
DISKRIMINIMI NDAJ GRAVE DHE DHUNA ME BAZË GJINORE	67
KONTESTI I VENDIT	67
KUADRI LIGJOR	70
Kuadri i Brendshëm Ligjor	70
Kuadri i Brendshëm Ligjor për Diskriminimin Gjinator në Shqipëri	70
Kuadri i Brendshëm Ligjor për Dhunën në Familje, përfshirë Dhunën me bazë Gjinore	70
Standardet Ndërkombëtare për të Drejtat e Grave dhe DhBGj	73
PRAKTIKAT MË TË MIRA TË IKDNJ-VE NË MONITORIMIN E TË DREJTAVE TË GRAVE DHE DHBGJ	78
Institucioni i Avokatit të Popullit	79
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	81
MONITORIMI I DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE DHE DHBGJ	84
Diskriminimi ndaj Grave	90
Monitorimi i Dhunës ndaj Grave	94
Dhuna seksuale	95
Monitorimi i Legjislacionit	97
Monitorimi i Stereotipizimit Gjinator	97
Jeta private	99
Mbrojtësit e të drejtave të njeriut të grave	100
Shëndeti seksual dhe riprodhues dhe të drejtat lidhur me të	101
Vdekshmëria mëmësore dhe sëmundshmëria	103
Puna dhe punësimi	105
Strehimi, toka dhe prona	106
Arsimi	106
Aksesi në drejtësi	108
KU TË REFEROHEN VIKTIMAT PËR NDIHMË	112
REFERENCAT	116

PËRKUFIZIME

Disa prej termave që përkufizohen më poshtë përshkruajnë aspekte të ndryshme të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Lista e këtyre termave që shfaqen më shpesh gjatë monitorimit, nuk është shteruese. Vini re se përkufizimet shpesh u referohen një gjuhe specifike që përdoren në të drejtën ndërkombëtare apo në diskursin mes profesionistëve që punojnë në këtë fushë.

Dhunë - shtë çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.¹

I pandehur - personi i akuzuar dhe/ose dhunuesi në çështjet civile apo penale.

Diskriminimi ndaj Grave: Çdo dallim, përjashtim apo kufizim të bazuar në seksin që ka për efekt apo qëllim të komprometojë apo asgjësojë njohjen, gëzimin apo ushtrimin nga gratë, cilado qoftë gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas, të të drejtave dhe të lirive themelore në fushat politike, shoqërore, kulturore e civile ose në çdo fushë tjetër.

Legjislacioni diskriminues ndaj grave: Ligje që nuk përcaktojnë masat e nevojshme legislative për të garantuar realizimin e plotë të të drejtave të grave dhe institucionalizojnë një status të dorës së dytë për gratë dhe vajzat lidhur me kombësinë dhe shtetësinë, shëndetin, arsimin, të drejtat martesore, të drejtat e punësimit, të drejtat prindërore, të drejtat e trashëgimisë dhe të drejtat e pronësisë.

Diskriminim strukturor: është ajo formë diskriminimi që u referohet rregullave, normave, praktikave, modeleve të qëndrimeve dhe sjelljeve në institucione dhe në struktura të tjera shoqërore, që në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme paraqesin pengesa për grupet ose individët për të pasur të njëjta të drejta dhe mundësi si të tjerët dhe që kontribuojnë në rezultate më pak të favorshme për ta në raport me të tjerët.

Diskriminim i tërthortë: është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

Diskriminimi i shumëfishtë: Çdo kombinim i formave të diskriminimit ndaj personave mbi shkaqet e seksit, racës, përkatësisë etnike, fesë apo besimit, aftësisë së kufizuar, moshës, orientimit seksual, identitetit gjinor apo karakteristikave të tjera, si edhe i diskriminimit që pësohet prej personave që kanë ose perceptohet se kanë ato

1 Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare". Gjetendet në: <http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2016/12/30437.pdf>

karakteristika.

Dhuna në familje - nënkupton çdo akt dhune që rezulton apo ka gjasa të rezultojë në dëmtim fizik, seksual apo psikologjik, përfshirë kërcënimet për kryerjen e akteve të tilla, shtrëngimin apo heqjen arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike apo private.

Gjinia - nënkupton rolet e ndërtuara në kontekstin social, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për burrat dhe gratë..²

Dhuna me bazë gjinore ndaj grave - nënkupton dhunën që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë joproporcionale.³

Gjuha e urrejtjes - është çdo formë e shprehjes publike përmes çfarëdo mjeti, e promovimit dhe nxitjes së denigrimit, urrejtjes apo përgojimit, çdo ngacmim, ofendim, stereotipizim negativ, stigmatizim apo kërcënim ndaj një personi apo grupi personash, si edhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes mbi bazën e një liste joshteruese të shkaqeve.

Numri jeshil/Linja e këshillimit - numër telefoni falas 24 orë/7 ditë të javës ku përgjigjen këshillues dhe avokatë që ndihmojnë viktimat e dhunës në familje. Ndihma mund të përfshijë mbështetje psikologjike dhe emocionale, strehim, shërbime juridike dhe/ose planifikim të sigurisë.

Urdhër mbrojtjeje - është urdhër i lëshuar nga gjykata që i ofron viktimës masa mbrojtëse.

Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje - urdhër i përkohshëm i gjykatës i vlefshëm për një periudhë të caktuar.

Recidivizëm - kthimi i sjelljes shkelëse pas një periudhe pa shkelje. Tendenca për të rënë sërish në një sjellje të caktuar.

Sulmi seksual - akte seksuale që mund të mos përfshijnë penetrimin, të cilat kryhen kundër dëshirës së dikujt, me anë të dhunës apo kërcënimit të dhunës apo në situata ku individit e ka të pamundur të shprehë miratim.

Ngacmimi seksual - sjellje seksuale e padëshiruar që ndërhyjnë në jetën, punën apo arsimimin e një individit. Kjo sjellje mund të përfshijë akte verbale apo fizike, si edhe akte që krijojnë një mjedis armiqësor.

Dhuna seksuale - përfshin detyrimin, shtrëngimin apo tentativën për të shtrënguar dikë të kryejë kontakt apo sjellje seksuale kundër dëshirës. Sjellja seksuale përfshin

2 Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Stamboll, 11.5.2011. Gjetet në: <https://rm.coe.int/1680>

3 Po aty.

ndër të tjera përdhunimin bashkëshortor, sulmet ndaj pjesëve seksuale të trupit, seksin me detyrim pasi ndodh dhuna fizike, apo trajtimin e dikujt në një mënyrë seksualisht poshtëruese. Dhuna seksuale mund të kryhet nga partnerët intimë dhe familjarët në kontekstin e martesës, marrëdhënieve të njohjes dhe familjes.

Përndjekja - kur dikush ndjek apo ngacmon dikë tjetër kundër dëshirës. Shembujt përfshijnë ndër të tjera: telefonata të përsëritura të padëshiruara, ndjekja e viktimës, dërgimi i dhuratave të padëshiruara, shkatërrimi apo dhunimi i pronës së viktimës, kërcënimet e përsëritura dhe/ose gjurmimi i aktivitetit online të viktimës.

I/E mbijetuar - për qëllimet e këtij manuali, termi përdoret për të përshkruar një individ të dhunuar. Ky term përdoret gjerësisht nga grupet avokuese për të njohur forcën e individit që i reziston traumës siç është dhuna seksuale. Jo çdo individ e përcakton veten si i/e mbijetuar, prandaj gazetarët këshillohen që gjatë intervistave me të mbijetuarit të përdorin termin që individi i intervistuar parapëlqen.

Viktima - personi që ka qenë objekt i dhunës që ka rezultuar në dhunim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik. Kjo fjalë përdoret gjerësisht në sistemin e drejtësisë penale dhe nga publiku.

Dhuna ndaj grave - kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi ndaj grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që rezultojnë apo kanë gjasa të rezultojnë në dëmtim fizik, seksual, psikologjik apo ekonomik ose vuajtje të grave, përfshirë kërcënimet për kryerjen e akteve të tilla, shtrëngimin apo heqjen arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike apo private.⁴

4 Po aty.

PJESA 1:

MONITORIMI I GJUHËS SË URREJTJES NË SHQIPËRI

HYRJE

Gjuha e urrejtjes është një fenomen i rrezikshëm që ndikon për keq te individit, komuniteti dhe shoqëria. E rrënjësuar në paragjykime, anshmëri dhe armiqësi ndaj një grupi të caktuar njerëzish, gjuha e urrejtjes është sulm ndaj identitetit thelbësor të personit. Me të synohet të përhapet dhe të nxitet urrejtja apo dhuna ndaj individëve ose anëtarëve të komunitetit bazuar në karakteristika të caktuara si prejardhja etnike, kombësia, gjuha, feja, seksi, identiteti gjinor, orientimi seksual, aftësia e kufizuar ose mosha. Në këtë kontekst, gjuha e urrejtjes është e papajtueshme me vlerat themelore të një shoqërie demokratike, pasi ajo promovon intolerancën, urrejtjen ose dhunën.

"Gjuha e urrejtjes është në vetvete sulm ndaj tolerancës, përfshirjes, diversitetit dhe vetë thelbit të normave dhe parimeve tona të të drejtave të njeriut. Më gjerë, gjuha e urrejtjes minon kohezionin social, shkatërron vlerat e përbashkëta dhe mund të shtrojë themelet për dhunën duke cenuar paqen, stabilitetin, zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut për të gjithë."
- Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, António Guterres.⁵

Gjuha e urrejtjes nuk mbrohet nga liria e shprehjes dhe kështu mund të parandalohet dhe autorët të ndëshkohen. Ajo çka mund të konsiderohet gjuhë e urrejtjes apo jo ndahet me një vijë të hollë. Pasojat e gjuhës së urrejtjes së përhapur shpesh nënvlerësohen dhe anashkalohen.

Vitet e fundit, organizatat ndërkombëtare globale dhe rajonale si OKB-ja dhe Këshilli i Evropës⁶ konstatuan "tendenca alarmante të rritjes së ksenofobisë, racizmit dhe intolerancës, misogjenisë së dhunshme, antisemitizmit dhe urrejtjes ndaj myslimanëve në mbarë botën."⁷ Për të kuptuar shtrirjen e problemit, tendencat aktuale dhe kanalet e përhapjes është e nevojshme të hartohet një strategji kundërvënëse efektive.

5 Udhëzime të Hollësishme për Zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit të OKB-së për Zyrat në Terren f. 3. Gjetet në: https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/UN%20Strategy%20and%20PoA%20on%20Hate%20Speech_Guidance%20on%20Addressing%20in%20field.pdf

6 Raporti Vjetor për aktivitetet e ECRI-t për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2020. Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës, Këshilli i Evropës, Strasburg, mars 2021. Gjetet në: <https://rm.coe.int/annual-report-on-ecri-s-activities-for-2020/1680a1cd59>

7 Strategjia dhe Plani i Veprimit i OKB-së për Gjuhën e Urrëjtjes. Gjetet në: <https://www.un.org/en/genocideprevention/hate-speech-strategy.shtml>

TË KUPTOJMË GJUHËN E URREJTJES: SFONDI TEORIK

Gjuha e urrejtjes është formë e agresionit verbal të rrënjësuar në frikë, ankth dhe/ose frustrim nga e panjohura, dhe e paditura.⁸ Pavarësisht se shënjestrimi i drejtpërdrejtë është shpesh individ, gjuha e urrejtjes është sulm verbal ndaj vetë grupit në thelb, të shkaktuar nga ndjesia e kanosjes imagjinare ndaj identitetit të grupit.⁹ Për ta njohur në mënyrë adekuate si dhe për ta monitoruar efektivisht, është e nevojshme të kuptojmë në një nivel të caktuar natyrën e gjuhës së urrejtjes, përfshirë shenjat dhe manifestimet, dhe kornizën e ligjeve dhe politikave në luftën kundër saj.

Përkufizimi i gjuhës së urrejtjes

OSBE-ja nuk ka ndonjë përkufizim të gjuhës së urrejtjes që të jetë pranuar në mënyrë universale. Megjithatë, ekziston një përshkrim i përgjithshëm në dokumentet e punës së Organizatës se çka e përbën gjuhën e urrejtjes. Sipas udhëzuesit burimor për OJQ-të në rajonin e OSBE-së, "format e të shprehurit që motivohen nga, demonstrojnë ose nxitin armiqësi ndaj një grupi apo personi për shkak të anëtarësisë në atë grup, zakonisht quhen "gjuhë e urrejtjes"."¹⁰

Në mënyrë më gjithëpërfshirëse, Kombet e Bashkuara e përkufizojnë gjuhën e urrejtjes si: "Çdo lloj komunikimi verbal, me shkrim apo sjellje, që sulmon ose përdor gjuhë përçmuese apo diskriminuese ndaj një personi ose grupi për shkak të asaj se kush janë, ose ndryshe, për shkak të fesë, etnisë, kombësisë, racës, ngjyrës, prejardhjes, gjinisë ose faktorëve të tjerë të identitetit. Kjo shpesh e ka zanafillën në, dhe shkaktën, intolerancë dhe urrejtje, dhe në rrethana të caktuara mund të jetë poshtëruese ose përçarëse."¹¹

8 Jan Zhan, Jun Ren, Jin Fan, dhe Jing Luo. Efektet dalluese të induktimit të frikës dhe zemërimit të sjellja e zemëruar dhe agresive. *Frontiers of Psychology*. 6:725. <https://www.frontiersin.org/articles/10.3389/fpsyg.2015.00725/pdf>. Shih edhe: Inga D. Neumann, Alexa H. Veenema dhe Daniela I. Beiderbeck. Agreioni dhe Ankthi: Konteksti Social dhe Lidhjet Neorubiologjike. *Frontiers in Behavioral Neuroscience*. Vëll.4. 2010. <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC2854527/pdf/fnbeh-04-00012.pdf>. Shih edhe: Arnold Buss. Physical aggression in relation to different frustrations. *The Journal of Abnormal and Social Psychology*. 67 (1). 1963. p. 1-7; Leonard Berkoëtz. Frustration-aggression hypothesis: Examination and reformulation. *Psychological Bulletin*. 106 (1). 1989. pp. 59-73. Shihni gjithashtu: Crystal Raypole. Zbërthimi i ksenofobisë, ose frikës nga të huajt. Linja shëndetësore. 26 korrik 2021. <https://www.healthline.com/health/xenophobia>

9 Francis Fukuyama. Identiteti: Kërkesa për dinjitet dhe politika e pakënaqësisë. New York: Farrar, Straus and Giroux, 2018. fq.7-28

10 Parandalimi dhe reagimi ndaj krimeve të urrejtjes: Një udhëzues burimesh për OJQ-të në rajonin e OSBE-së.p.17 <https://www.osce.org/files/f/documents/8/a/39821.pdf>

11 Udhëzime të Detajuara, fq.10

Këshilli i Evropës është e para dhe e vetmja organizatë ndërkombëtare ndërqeveritare që ka miratuar një përkufizim zyrtar të gjuhës së urrejtjes. Sipas rekomandimeve të tij, “termi “gjuhë e urrejtjes” kuptohet se mbulon të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxitin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose format e tjera me bazë intolerance përfshirë intolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv dhe etnocentrizmi, diskriminimi dhe armiqësia ndaj pakicave, emigrantëve dhe personave me origjinë emigrante”.¹² Ky përkufizim përfshin kryesisht vetëm aspektet etnike dhe fetare: për shembull, aspekti i gjinisë mbetet jashtë këtij fushëveprimi.

Sipas Rekomandimit nr. 15 të Politikës së Përgjithshme për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes (2015) të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës, “Gjuha e urrejtjes [...] nënkupton përdorimin e një ose më shumë formave të veçanta të shprehjes - përkatësisht, avokimin, promovimin ose nxitjen e denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotipizim negativ, stigmatizim ose kërcënim i një personi ose personave të tillë dhe çdo justifikim të të gjitha këtyre formave të shprehjes - që bazohet në një listë joshteruese të karakteristikave personale apo statusit që përfshin “racën”, ngjyrën, gjuhën, fenë ose besimin, kombësinë ose prejardhjen kombëtare apo etnike, si dhe prejardhjen prindërore, moshën, aftësinë e kufizuar, seksin, gjininë, identitetin gjinor dhe orientimin seksual”.¹³

Për qëllime të këtij manuali, më i përshtatshëm është përkufizimi që përmban legjislacioni shqiptar. Sipas **Nenit 3.8 të Ligjit të Republikës së Shqipërisë për Mbrojtjen nga Diskriminimi**¹⁴, gjuha e urrejtjes është:

“Çdo formë e shprehjes në publik me çdo mjet e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve sipas nenit 1 të këtij ligji.”

Shkaqet e renditura në ligj lidhen me sa më poshtë:

“racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozitat gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”¹⁵

12 Rekomandimi Nr. R (97) 20 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare mbi “gjuhën e urrejtjes”. Shtojca. fq.107. Gjetet në <https://rm.coe.int/1680505d5b>

13 Rekomandimi Nr. 15 i Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Tolerancës për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, fq.16. Gjetet në: <https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-15-on-combating-hate-speech/16808b5b01>

14 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 10 221 datë 4.2.2010. I ndryshuar nga ligji nr. 124/2020. fq. 3. Gjetet në: <https://rm.coe.int/lmd-updated-version-english-translation/1680a0c1fc>

15 Po aty. f.1.

Vlen të përmendet se është çështje e diskutueshme nëse një deklaratë publike mund të konsiderohet vetëm si gjuhë e urrejtjes apo edhe personale. Sipas disa përkufizimeve, termi i referohet sferës publike ("gjuhë e urrejtjes" është çdo formë e shprehjes publike") dhe në këtë mënyrë përjashtohet sfera private.¹⁶ Përkrahësit e këtij qëndrimi rezultojnë nga të kuptuarit e gjuhës së urrejtjes si fenomen i rrezikshëm shoqëror. Komunikimi privat në kuadër të kësaj logjike nuk shkakton pasoja të rëndësishme shoqërore. Kundërshtarët e tyre argumentojnë se thelbi për ta kuptuar gjuhën e urrejtjes nuk është kanali i përhapjes, as qëllimet apo pasojat, por natyra e shprehjes. Nëse karakteristikat negative ose fyese, të përdorura në deklaratë, nuk shkaktohen nga cilësitë personale, por nga karakteristikat e grupit ose thjesht fakti i përkatësisë në një grup, e bëjnë gjuhën e urrejtjes gjuhë të urrejtjes, edhe nëse flasim për një mesazh privat të përcjellë në Messenger. Për më tepër, shprehjet private ksenofobe me gojë ose me shkrim janë të rëndësishme në disa çështje, për shembull, si një tregues i qëllimit të drejtpërdrejtë në raste të krimeve të urrejtjes ose sjelljes diskriminuese.

Në këtë kontekst, ky manual konsideron se **gjuhë e urrejtjes mund të jetë çdo formë e shprehjes që nxit urrejtje, pavarësisht nivelit të publicitetit**.

Rreziku dhe pasojat e gjuhës së urrejtjes

Gjuha urryese dhe armiqësia ndaj grupeve shpesh vulnerabël dhe të marginalizuara apo komunitetit përbën një kërcënim të veçantë për shoqërinë dhe sfidon bazat themelore të shtetit modern demokratik të qeverisur nga shteti i së drejtës.

"Gjuha e urrejtjes paraqet një rrezik të qartë, të pranishëm dhe të pashmangshëm për shoqërinë." - Konferenca e OSBE-së për Garantimin e Lirisë së Medias në Internet.¹⁷

Edhe pse shënjestrimi i drejtpërdrejtë i gjuhës së urrejtjes mund të jenë individit dhe grupi në tërësi, është e nevojshme të kuptohet se gjuha e urrejtjes shkaktohet pikërisht nga përkatësia e viktimës në grup, qoftë reale a imagjinare (në imagjinatën e autorit). Fyerja personale si shkak i armiqësisë individuale ose si përgjigje e sjelljes së një personi nuk është gjuhë e urrejtjes. Gjuha e urrejtjes kushtëzohet gjithmonë nga perceptimi i viktimës si përfaqësues i grupit dhe lidhet ngushtë me qëndrimin e pabarabartë, praktikën diskriminuese, pabarazinë institucionale, padrejtësinë, segregimin dhe dhunën e atij grupi të caktuar. Si pasojë, mohimi i individualitetit është, në zanafillën e gjërave, mohimi i tipareve njerëzore që çon në dehumanizimin e viktimave të tij dhe krijon kornizën bazë për gjuhën e urrejtjes dhe nxitjen e dhunës. Historia na ofron shembuj të shumtë që nga Holokausti në Evropë e deri në gjenocidin

16 Gabriella B. Klein, Gjuhësia e aplikuar për të identifikuar dhe kontrastuar 'gjuhën e urrejtjes' raciste: Raste nga gjuha angleze dhe italiane. Revista Kërkimore e Gjuhësisë së Aplikuar 2 (3). fq. 4-5. Gjetet në: https://jag.journalagent.com/alrj/pdfs/ALRJ_2_3_1_16.pdf

17 Sandy Starr, Hate speech: What is there to be worried about? Gjetet në <https://www.osce.org/files/f/documents/b/b/36098.pdf>

në Ruanda ku media dhe propaganda e urrejtjes ishin drejtpërdrejt përgjegjëse për masakra të tmerrshme. OSBE-ja vëren se “dhuna e motivuar nga urrejtja ndodh shpeshherë në kontekstin e gjuhës së urrejtjes”.¹⁸

Gjithashtu, gjuha e urrejtjes është, në një masë të gjerë, manifestim i një tipari tjetër karakteristik të ndërgjegjes njerëzore, prirjes drejt stereotipizimit.¹⁹ Stereotipizimi është tipar i perceptimit njerëzor që na ndihmon të përpunojmë një informacion që vjen nga bota e jashtme. Në marrëdhëniet shoqërore, stereotipizimi është “pjesë e qenësishme e procesit të komunikimit.”²⁰ Megjithatë, paragjykimet krijohen në mendjen e njeriut pikërisht për shkak të kësaj veçantie të perceptimit të informacionit nga bota e jashtme Stereotipet negative, për më tepër, shfaqen bashkë me emocione negative (p.sh., frikë, zemërim) në drejtim të grupit të jashtëm që lidhen fort me paragjykimin dhe shkaktojnë agresion, intolerancë dhe dhunë, gjuhë të urrejtjes dhe krime të urrejtjes.²¹

Formimi dhe riprodhimi i stereotipeve në gjuhë ndodh në nivele të subkoshiençës. Në media, gazetarët mund të përdorin gjuhë të urrejtjes (nëse kemi të bëjmë me një version “të butë” të saj) pa synimin e drejtpërdrejtë për të cenuar dinjitetin e personave të tjerë apo për të nxitur dhunë. Shpesh, gjuha e urrejtjes për shkak të stereotipeve përdoret pa kuptuar se deklarata të tilla janë cenuese në komunikimin e përditshëm midis njerëzve. Për shembull, stereotipet gjinore mund të jenë të përhapura në kulturën e përbashkët gjuhësore të një shoqërie patriarkale në formën e shakave të pasakta (përfshirë ato që janë relativisht “të pafajshme”, për shembull, për karakteristikat “femërore” të drejtimit të një makine), deklaratave fyese që objektivizojnë gratë, apo idetë për ndarjen e roleve gjinore në familje dhe shoqëri, bazuar në tablonë tradicionale fetare të botës. Të riprodhuara në mënyrë të përsëritur, qëndrime të tilla shkaktojnë konsolidimin e pabarazisë sistemike gjinore dhe diskriminimin ndaj vajzave dhe grave, pakësimin e mundësive për vetë-përmbushjen e tyre si dhe shtypjen e tyre në shoqëri dhe në familje. Në rastin më të keq të të ashtuquajturës kulturë përdhunimi, objektivizimi verbal i grave çon në praktikën e normalizimit të dhunës seksuale dhe në familje.²² “Pikëpamjet patriarkale dhe seksiste legjitimojnë dhunën për të siguruar dominimin dhe epërsinë e burrave.”²³

18 Preventing and responding to hate crimes: A resource guide for NGOs in the OSCE region. fq. 53. Gjetet në <https://www.osce.org/files/f/documents/8/a/39821.pdf>

19 Jonathan Matusitz. Relationship between Knowledge, Stereotyping, and Prejudice in Interethnic Communication// Pasos: Revista de Turismo y Patrimonio Cultural. Vol. 10, No 1, 2012. fq. 89–98.

20 Sheng-Yu Peng. Impact of Stereotypes on Intercultural Communication: a Chinese Perspective// Asia Pacific Educational Review. 2010.No. 11.p. 244.

21 Walter Stephan dhe Cookie Stephan. An Integrated Threat Theory of Prejudice. Psychology Press, 2000

22 Shih, për shembull: Saskia van Veen, Bethan Cansfield, dhe Sandrine Muir-Bouchard. ‘Let’s stop thinking it’s normal. Identifying patterns in social norms contributing to violence against women and girls across Africa, Latin America and the Caribbean and the Pacific. Oxfam research report. Nëntor 2018. Gjetet në https://oi-files-d8-prod.s3.eu-west-2.amazonaws.com/s3fs-public/file_attachments/tr-lets-stop-thinking-normal-evaw-social-norms-251118-en.pdf

23 Anca-Ruxandra Pandea, Dariusz Gremny, Ellie Keen. Gender Matters. Manual on addressing gender-based

dhe është gjuha e urrejtjes mizogjene që lejon përhapjen e këtyre pikëpamjeve.²⁴

Elenimi i plotë i gjuhës së urrejtjes është jashtëzakonisht i vështirë. Fushata të gjera publike mediatike dhe puna sistematike edukative, veçanërisht e synuar tek të rinjtë dhe adoleshentët (pasi stereotipet formohen në moshë të hershme), përfshirë punën në institucionet arsimore, mund të ndihmojnë në çrrënjosjen e paragjytimeve në shoqëri dhe ndryshimin e praktikave të zakonshme të gjuhës. Seminaret edukative dhe trajnimet për gazetarët kanë rëndësi të veçantë për të kuptuar më mirë natyrën e gjuhës së urrejtjes dhe për të mësuar se si ta shmangim atë. Kultivimi i standardeve të larta të ndjeshmërisë gjuhësore tregon se rënia e prevalencës së gjuhës së urrejtjes kontribuon drejtpërdrejt në mosdiskriminim, në vendosje të trajtimit të barabartë dhe kohezion social, në sigurinë për të gjithë, si dhe rritjen e nivelit të stabilitetit.

Roli i medias

Gjuha e urrejtjes në formë të “moderuar” (ose “të butë”, shih më poshtë) është e përhapur jo vetëm në komunikimet verbale, rrjetet sociale ose mediat por edhe në qarqet akademike dhe në arsim. Për shembull, siç tregon hulumtimi, disa elemente të gjuhës së urrejtjes dhe stereotipeve negative ndaj grupeve të caktuara etnike mund të shfaqen edhe në tekstet shkollore të historisë.²⁵ Disa karakteristika negative, si “shoviniste” apo “agresive”, janë përdorur në tekste shkollore shqiptare për disa kombe në tërësi.²⁶ Megjithatë, platforma kryesore për gjuhën e urrejtjes është media dhe interneti, dhe kryesisht rrjetet sociale gjatë viteve të fundit.

Përhapja e shpejtë e teknologjive online dhe inteligjencës artificiale i ka dhënë gjuhës së urrejtjes një valë të dytë. Rrjetet sociale janë platforma më e favorshme për përhapjen e plotë të gjuhës së urrejtjes për shkak të një sërë veçorish si shtrirja e gjerë, ndikimi dhe efekti tërheqës që kanë. Nivelet e larta të përfshirjes emocionale, qarkullimi i një numri të madh informacionesh të pavërtetuara dhe të rreme, joshja nga anonimati, dinamika virale e shpërndarjes së mesazheve, - të gjitha këto i bëjnë rrjetet sociale një hapësirë shumë të përshtatshme, me kosto dhe ndikim të lartë për gjuhën e urrejtjes jo vetëm për individët, por edhe për qeveritë. Siç raportohet nga

violence affecting young people. Second edition – fully revised and updated. Këshilli i Evropës, 2015. p.21. <https://rm.coe.int/gender-matters-a-manual-on-addressing-gender-based-violence-affecting-/16809e1c34>

24 Important Guidelines could help to avoid the sexist approach on a verbal level: Anita Ramšak. Guidelines for Gender Sensitive Reporting. Republic of Slovenia Ministry of Foreign Affairs. Gjendet në http://www.ekvilib.org/wp-content/uploads/2017/06/en_GUIDELINES_FOR_GENDER_SENSITIVE_REPORTING.pdf

25 Vujo Ilić. Etnički stereotipi u albanskim i srpskim udžbenicima istorije. In: Goran Tepšić, Radmila Nakarada, Mirjana Vasović (Eds.) Etnički stereotipi i nacionalni mitovi kao prepreke pomirenju u srpsko-albanskim odnosima. Beograd: Fakultet političkih nauka. 2015. fq. 177–212. Gjendet në https://www.academia.edu/6258496/Ethnic_Stereotypes_and_National_Myths_as_an_Obstacle_to_Reconciliation_Albanian_Serbian_Relations Stereotipe negative etnike kundër serbëve dhe turqve mund të gjenden në tekstet shkollore shqiptare. Shih: Po aty. fq. 187, 199–203.

26 Gjendet në <https://balkaninsight.com/2012/06/01/historia-e-kundert-serbe-dhe-shqiptare/?lang=sq>

misioni faktmbledhës i OKB-së, rrjetet sociale, dhe në veçanti Facebook, luajtën “rol përcaktues” në nxitjen e gjuhës së urrejtjes dhe dhunës kundër pakicës Rohingya si pjesë e një tentative të mundshme gjenocidi në Myanmar e cila rezultoi në krizë të tmerrshme humanitare.²⁷ Mediat sociale kanë rezultuar të shërbejnë si mjet instrumental për përhapjen dhe nxitjen jo vetëm të dhunës etnike dhe fetare, por edhe pikëpamjeve ksenofobe²⁸, homofobe dhe mizogjene.²⁹ Mungesa e përgjigjeve efektive juridike dhe të tjerash nga autoritetet publike dhe pronarët e platformave të mediave sociale mund të çojë në mizori masive dhe shkelje të të drejtave të njeriut.³⁰

Teoria e Përgjithshme e Ksenofobisë “Ne k. ATYRE”:

Gjuha e urrejtjes është shpesh manifestim verbal i sjelljes së shoqëruar ksenofobe ndaj grupit dhe individit.

Sociologjia i ka shpjeguar gjatë fenomenet e racizmit, ksenofobisë dhe intolerancës së ngjashme ndërgrupore si dhe armiqësisë nëpërmjet prizmit të interesave racionale kolektive si p.sh., konkurrencës për burime. Burimet nuk mund të jenë vetëm materiale por edhe simbolike si autoriteti apo statusi social. Kjo funksionon edhe në rastet e grupeve të formuara në mënyrë të rastësishme.³¹ Kjo ide përbënte bazën e teorisë realiste së konfliktit në grupe.³²

Megjithatë, hulumtime të tjera kanë dëshmuar se fenomene të ngjashme mund të vërehen edhe në mungesë të ndonjë arsyeje logjike, jo vetëm në situatën e konkurrencës ndërgrupore. Sot pranohet se identiteti i grupit dhe solidariteti brenda grupit dhe intoleranca e jashtme e grupit janë tipare themelore të sjelljes shoqërore.

Ndjenja e përkatësisë në grup është thelbësore për qenien njerëzore; ajo është një nga nevojat bazë të psikikës njerëzore. Disa studiues sugjerojnë se kjo shoqërueshmëri vjen si rezultat i natyrës biologjike të llojit homo sapiens

- 27 Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut. Seanca e dyzet e gjashtë. *Raporti i Relatorit të Posaçëm për çështjet e pakicave*. A/HRC/46/57 Gjendet në <https://undocs.org/A/HRC/46/57>. See also: Miles, T. U.N. investigators cite Facebook role in Myanmar crisis. Reuters. 12 mars 2018. Marrë nga [U.N. investigators cite Facebook role in Myanmar crisis | Reuters](#)
- 28 Sergio Andres Castano-Pulgarin, Natalia Suarez-Betancur, Luz Magnolia Tilano Vega, Harvey Mauricio Herrera Lopez. Internet, social media and online hate speech. Systematic review. *Aggression and Violent Behavior*. No 58. 2021. Gjendet në: <https://prohic.nl/wp-content/uploads/2021/05/213-17mei2021-InternetOnlineHateSpeechSystematicReview.pdf>.
- 29 Emma Alice Jane. “Back to the kitchen, cunt’: speaking the unspeakable about online misogyny”. *Continuum: Journal of Media & Cultural Studies*. 28 (4). 2014. fq. 558–570.
- 30 A/HRC/46/57. paragrafi 45.
- 31 Saul McLeod. Robbers Cave Experiment. SimplyPsychology. 2008. Gjendet në <https://www.simplypsychology.org/robbers-cave.html>
- 32 Shih, për shembull: Muzafer Sherif. In *Common Predicament: Social Psychology of Intergroup Conflict and Cooperation*. 1966.

si kafshë tufe.³³ Në jetën sociale, kjo veçori e njerëzimit bën të mundur bashkëpunimin altruist, marrëdhëniet produktive, bëhet shkak i solidaritetit dhe komunitetit.

Sipas teorisë së identitetit social, propozuar fillimisht nga Henri Tajfel,³⁴ “grupet të cilëve i përkasim janë burim i rëndësishëm krenarie dhe vetëvlerësimi. Mund të ndihemi mirë me veten duke rritur statusin e ndonjë nga grupeve që i përkasim. Grupmosha, ekipet sportive, pasionet (hobet), gjinia, feja, grupet e përkatësisë etnike dhe kombëtare janë të gjitha shembuj të grupeve që mund të na japin ndjenjën e identitetit social dhe përkatësisë. Për shembull, ne mund të besojmë se vendi ynë, ekipi ynë, shkolla jonë është më e mirë se të tjerat, dhe prandaj grupet e tjera dhe anëtarët e tyre janë inferiorë. Fatkeqësisht, identifikimi me “brenda grupit” specifik për të përmirësuar vetëvlerësimin tonë mund të shkaktojë konkurrencë dhe intolerancë kundrejt “jashtë grupit.”³⁵ Kjo ide është shumë produktive në shpjegimin e stereotipeve, ksenofobisë dhe paragjyqimeve.

Ndjenja e identitetit të grupit çon në mënyrë të pashmangshme në dallimin midis atyre që i përkasim grupit tuaj dhe atyre që nuk i përkasim. Këto të fundit kalojnë në “të tjerët”, që janë, së pakti, të çuditshëm, ose madje të rrezikshëm (studiuesit e quajnë këtë fenomen “tjetërsim”).³⁶ Van Dijk përshkruan se si “derogimi jashtë grupit” dhe “festimi brenda grupit” funksionojnë në shoqëri në nivel gjuhe dhe ofrojnë një kuadër për gjuhën e urrejtjes.³⁷ Van Dijk nënvizon “vetë-prezantimin pozitiv” (ose “favorizimin brenda grupit”) dhe “prezantimin tjetër negativ” si “makro strategji semantike”. Kjo kornizë mundëson logjikisht ndarjet brenda grupit/jashtë grupit sa i takon të mirës kundër të keqes, superiores kundër inferiores, “ne kundër atyre”.³⁸ Si e tillë, “Gjuha e urrejtjes shpesh shfaqet nga një kuadër konceptual “ne k. tyre, ku individët diferencojnë grupin që besojnë se i përkasim, ose “brenda grupit” nga “jashtë grupit.”³⁹

- 33 Shih, për shembull: Raymond F. Bellamy. The question of innate gregariousness or sociability. Quarterly Journal of the Florida Academy of Sciences. Vol. 16, No. 4. Dhjetor, 1953. fq. 223–232.
- 34 Shih, për shembull: Henri Tajfel. Social identity and intergroup behaviour. Social Science Information. No 13. 1974. P. 65–93; Henri Tajfel, Claud Flament, Michael Billig, and R. Bundy. Social categorization and intergroup behaviour. European Journal of Social Psychology. No 1, April/June 1971. pp. 149–178.
- 35 Social Identity Theory and Discrimination. Pamoja. Gjendet në <https://pamojaeducation.com/blog/social-identity-theory-and-discrimination>
- 36 John A. Powell and Stephen Menendian. The Problem of Othering: Towards Inclusiveness and Belonging. Othering and Belonging. Issue 1. <https://otheringandbelonging.org/the-problem-of-othering/>
- 37 Teun Van Dijk. Politics, Ideology and Discourse. Elsevier Encyclopedia of Language and Linguistics, Volume on Politics and Language. Elsevier, 2006. pp. 728–740. See also: Teun Van Dijk. Prejudice in Discourse: An Analysis of Ethnic Prejudice in Cognition and Conversation. John Benjamins Publishing, 1984;
- 38 Neslihan Kansu Yetkiner. A Critical Discourse Analysis Approach to Othering: Depiction of the Syrian Refugee Experience in Turkish Children's Literature. Sic. No 2 (11). 6/2021. Gjendet në <https://www.sic-journal.org/Article/Index/661>
- 39 Babak Bahador. Classifying and Identifying the Intensity of Hate Speech// Insights from the Social Sciences. 17 nëntor 2020. Gjendet në: <https://items.ssrc.org/disinformation-democracy-and-conflict->

Me fjalë të tjera, ksenofobia është në thelb atribut i natyrshëm i psikikës kolektive. Në kuadër të teorisë së identitetit social, përjetimi brenda grupit të ndjenjave të solidariteti, historisë së përbashkët, krenarisë për përkatësinë në një grup, njerëzit shpesh nuk mundën thjeshtë të trajtojnë personat e tjerë që nuk i përkasin grupit të tyre me të njëjtën dashamirësi që shfaqin për anëtarët e grupit.⁴⁰ Në vijim, gjuha e urrejtjes bëhet manifestim verbal i kësaj veçorie themelore të psikologjisë sociale. Si rezultat i kësaj logjike, për shembull, identiteti kombëtar lidhet në mënyrë empirike me ndjeshmërinë negative të individëve ndaj të huajve.⁴¹ Hulumtimet tregojnë se ky qëndrim shfaqet plotësisht edhe në median shqiptare.⁴²

[evention/classifying-and-identifying-the-intensity-of-hate-speech/](#)

- 40 Shih edhe: Margarita Sanchez-Mazas, Laurent Licata. Xenophobia: Social Psychological Aspects. International Encyclopedia of the Social & Behavioral Sciences. (Botimi i Dytë). 2015. fq. 802–807.
- 41 Noah Lewin-Epstein dhe Asaf Levanon. National Identity and Xenophobia in an Ethnically Divided Society// International Journal on Multicultural Societies. Vol. 7, Nr. 2, 2005. fq. 90. Gjetet në: https://www.researchgate.net/publication/26593865_National_Identity_and_Xenophobia_in_an_Ethnically_Divided_Society
- 42 Rapo Zguri. Albania: betëeën shadoës of the past and interest of the present. Në: Remzi Lani (ed.) Raportimi i Fqinjëve në Median Ballkanike.: Instituti Shqiptar i Medias, 2015. fq.7-28. Gjetet në <http://www.institutemedias.org/wp-content/uploads/2020/02/Raporting-neighbours-30-06-2015.pdf>

KUADRI LIGJOR

Standardet ndërkombëtare

Siç përmendet më lart, nuk ka ndonjë përkufizim uniform ndërkombëtar për gjuhën e urrejtjes. Por rregullimi i asaj që ne quajmë gjuhë të urrejtjes mund të gjendet në dokumente të ndryshme ndërkombëtare, si këshilluese edhe detyruese. Disa dokumente ndërkombëtare dhe legjislacione të shteteve të ndryshme përmbajnë një përkthim të gjuhës së urrejtjes (si vepër penale, në disa raste) pa e përdorur këtë term. Për shembull, në vend të saj mund të përdorin terma si “nxitje e armiqësisë” apo “avokim i urrejtjes”.

Neni III(c) i Konventës së OKB-së për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit (1948) e shpall krim “**nxitjen e drejtpërdrejtë dhe publike për kryerjen e gjenocidit**”.⁴³

Ndërsa neni 19 i **Paktit Ndërkombëtar të OKB-së për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)** përcakton se “Çdokush ka të drejtën e mendimit pa ndërhyrje. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes...”, Neni 20(2) i ICCPR-së përcakton se: “**Ndalohet me ligj çdo avokim i urrejtjes së krijuar mbi baza kombësie, race ose feje, që përbën nxitje të diskriminimit, armiqësisë ose dhunës.**”⁴⁴

Për të përcaktuar nëse mënyra e të shprehurit është gjuhë e urrejtjes dhe përmbush përkufizimin e Nenit 20(2) të ICCPR -së, Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut ofron testin e Rabatit bazuar në pragun prej gjashtë kriteresh.⁴⁵ Për këtë, është e nevojshme të merren parasysh: 1) **konteksti** social dhe politik; 2) **statusi** i folësit; 3) **qëllimi** për të nxitur publikun kundër një grupi të synuar; 4) **përmbajtja dhe forma** e shprehjes; 5) **përhapja** e gjuhës së urrejtjes; dhe 6) rreziku i dëmtimit, përfshirë **kërcënimin**.

Kuptohet në përgjithësi⁴⁶ se neni 20(2) kërkon që Shtetet Palë të miratojnë dispozita penale për atë që tashmë quhet “gjuhë e urrejtjes”. Çështja e kufizimeve ligjore të gjuhës së urrejtje përplasen në mënyrë të pashmangshme me problemin e respektimit

43 Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 260 A (III), dhjetor 1948. Gjendet në: <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CrimeOfGenocide.aspx>

44 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Gjendet në: <https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/ccpr.pdf>

45 Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Njëfaqëshi “Nxitja e urrejtjes”. Gjendet në: https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Opinion/SeminarRabat/Rabat_threshold_test.pdf

46 Shih, për shembull, rekomandimin e parë në lidhje me Legjislacionin në Planin e Veprimit të Rabatit për ndalimin e avokimit të urrejtjes së krijuar me bazë kombësie, race ose feje që përbëjnë nxitje të diskriminimit, armiqësisë dhe dhunës. Gjendet në: http://www.ohchr.org/Documents/Issues/Opinion/SeminarRabat/Rabat_draft_outcome.pdf Shih edhe: Komiteti për të Drejtat e Njeriut. Komenti i përgjithshëm nr. 34 për nenin 19, ICCPR. Gjendet në: <https://www2.ohchr.org/english/bodies/hrc/docs/gc34.pdf>

të parimeve të lirisë së fjalës dhe shprehjes.⁴⁷ Megjithatë, një nga organizatat më të respektuara të të drejtave të njeriut në fushën e lirisë së shprehjes dhe shtypit theksonte në nenin 19 “e drejta e lirisë së shprehjes nuk është një e drejtë”⁴⁸ Ekspertët e organizatës propozuan ndarjen e ‘gjuhës së urrejtjes’ në “gjuhë e urrejtjes që duhet të ndalohej” dhe “gjuhë e urrejtjes e ligjshme”.⁴⁹

Sipas analizës së Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias në lidhje me ICCPR-në,⁵⁰ “mund të ndalohen vetëm aktet shprehëse me synimin konkret për nxitjen e urrejtjes mund të ndalohen”. Gjithashtu, legjislacioni i miratuar sipas ICCPR-së mbulon vetëm përmbajtjen shprehëse që çon në dhunë, diskriminim ose urrejtje (armiqësi), si dhe vetëm gjuhën nxitëse drejt këtyre rezultateve. Së fundi, në veçorinë e mbrojtura të nenit 20(2) të Paktit përfshihen vetëm kombësia, raca dhe feja. Shumë legjislacione të brendshme, si ai shqiptar, kanë shtuar edhe gjuhën, gjininë, orientimin seksual, statusin social, etj.

Në lidhje me diskriminimin racor dhe etnik si dhe nxitjen e dhunës, neni 4 i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (1969) thotë:

Në rastet e regjistrimit të ankesave të drejtpërdrejta, verifikimi është elementi më sfidues. Zakonisht, viktimat mund të përsërisin vetëm gjuhën fyese që është përdorur. Jo gjithmonë mbajnë mend fjalët e sakta; jo gjithmonë e kuptojnë qartë çfarë është thënë (sidomos kur dhunuesi ka përdorur gjuhë të ndryshme nga gjuha amtare e viktimës). Paraqitja e çdo situatë konflikti në vetë të parë kalon nëpër filtra perceptimi dhe kujtese. Zakonisht, ju nuk keni ndonjë regjistrim të incidentit, edhe duhet të bazoheni vetëm te fjalët e viktimës. Metodologjikisht, ky burim informacioni është i dobët në kuadër të monitorimit. Metodologjia e intervistimit të viktimës paraqitet në shtojcë. Këtu theksojmë se ankesa e viktimës duhet marrë sa më seriozisht, përfshirë rastet e përdorimit të gjuhës së urrejtjes në komunikimin privat dhe jo në publik. Në komunikimin personal, përdorimi i gjuhës së urrejtjes shpesh mund t'i paraprijë kërcënimeve, dhunës ose veprimeve të tjera armiqësore.

Çështjet më poshtë duhen sqaruar me viktimën që denoncon apo ankohet për një ngjarje ku është përdorur gjuha e urrejtjes:

- ju duhet deklarata më e saktë e fyerjes, mundësisht citimi fjalë për fjalë;
 - citimi duhet analizuar më pas për përmbajtjen e gjuhës së urrejtjes – fyerjet për të cilat ankohen viktimat jo gjithmonë cilësohen si gjuhë urrejtjeje;
- nëse fyerja është bërë në korrespondencë, p.sh. në mesazh, mund t'i kërkonti viktimës të ruajë një screenshot;
- a e njihte viktimë dhunuesin? Kanë pasur ndonjë grindje më herët? A ishte përkatësia e viktimës në një grup vulnerabël e vetmja arsye për agresionin verbal?
- ishte fyerja vetëm një episod, apo agresion verbal i përsëritur?
- a është pasuar fyerja nga kërcënime apo veprime agresive?

Këshillohet që monitorimi i krimeve të urrejtjes të kryhet njëkohësisht. Dhuna e motivuar nga urrejtja mund të monitorohet për sulme fizike ksenofobike kundër personave, për shembull, atyre që u përkasin pakicave etnike, si dhe akte vandalizmi të motivuar nga urrejtja ndaj infrastrukturës së komunitetit, siç janë ndërtesat fetare. Përvoja ka treguar se shpesh nuk ekziston vetëm një korrelacion midis qëllimeve të gjuhës më të dhunshme të urrejtjes dhe grupeve të shënjestruara më shpesh nga sulmet fizike të motivuara nga urrejtja; korrespondimi i drejtpërdrejtë brenda dinamikës është zakonisht i dukshëm. “Valët” e propagandës së urrejtjes kanë korrelacion me rritjen e dhunës së motivuar nga urrejtja. Ky fakt bëhet argument i rëndësishëm për nxitjen e masave aktive që synojnë t'i kundërvihen gjuhës së urrejtjes. Megjithatë, për të bërë me siguri një pohim për një situatë të caktuar, së pari duhet mbledhur informacion i mjaftueshëm dhe i besueshëm si provë e incidentit të motivuar nga urrejtja.

PËRFUNDIM

Gjuha e urrejtjes është një kërcënim i rëndë për të drejtat e njeriut. Pa përgjigjen e duhur, ky fenomen në një situatë të caktuar mund të çojë në pasoja të rënda, duke përfshirë akte të dhunshme dhe krime ndërkombëtare të sponsorizuara nga shteti. Por edhe në një formë të moderuar, gjuha e urrejtjes krijon kushte për formimin dhe konsolidimin e pabarazisë në shoqëri, legjitimon praktikën diskriminuese dhe gërryen kohezionin social ndërmjet komuniteteve.

Për të dalluar efektivisht deklaratat që përmbajnë gjuhë urrejtje, është e nevojshme të kuptohet vendi që zë gjuha e urrejtjes në praktikën e përditshme gjuhësore dhe raporti i shprehjes së saj me rutinat/modelet e gjera të paragjykitimit dhe diskriminimit. Për këtë qëllim, legjislati shqiptar përmban një përkufizim gjithëpërfshirës të gjuhës së urrejtjes dhe ndalon shprehimisht manifestimet më të rënda të gjuhës së urrejtjes, kryesisht nxitjen e drejtpërdrejtë të dhunës, si vepër penale. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka mandatin t'i përgjigjet gjuhës së urrejtjes. Shpresohet që ky manual të ofrojë udhëzime dhe metodologji të dobishme për mbledhjen efektive të informacionit në lidhje me manifestimet e gjuhës së urrejtjes në vend, me qëllim vlerësimin e përhapjes së këtij fenomeni dhe informimin e mëtejshëm të avokimit dhe përpjekjeve për reforma legjislative, si dhe të përmirësimit mbrojtjen e viktimave dhe mekanizmat e parandalimit.

Monitorimi i gjuhës së urrejtjes është një proces thelbësor për të kuptuar dhe për të evidentuar intolerancën në një shoqëri. Hulumtimet mund të tregojnë se cilat grupe janë më të stigmatizuara dhe vulnerabël; cilat stereotipe negative rreth tyre janë më të zakonshme; dhe sa është intensiteti i intolerancës ndaj këtyre grupeve. Siç vërehet në të gjithë këtë manual, monitorimi i gjuhës së urrejtjes përfshin dy përfaqëse: monitorimin pasiv, siç është marrja dhe dokumentimi i ankesave; si dhe monitorimin proaktiv, i cili përfshin monitorimin sistematik të manifestimeve të gjuhës së urrejtjes në fusha të ndryshme dhe rritjen e përpjekjeve për raportimin dhe intervistimin e viktimave.

Pavarësisht metodologjisë së përdorur, burimet njerëzore dhe kapacitetet teknike të zhvilluara në mbledhjen e provave dhe raportimin e shkeljeve të të drejtave të viktimave ndihmon jo vetëm në zhvillimin e qëllimeve të avokimit në luftën kundër urrejtjes dhe diskriminimit, por shërben edhe për të mbrojtur të drejtat e personave vulnerabël dhe shpesh ato të grupeve të marxhinalizuara, duke rritur ndërgjegjësimin për përmasat e gjuhës së urrejtjes ndaj tyre dhe ndikimin shkatërrues që ajo ka për komunitetin dhe shoqërinë në tërësi.

SHTOJCA 1

MONITORIMI I GJUHËS SË URREJTJES

Metodologjia

Monitorimi i gjuhës së urrejtjes është pjesë e pandarë e adresimit të dhunimit të të drejtave të njeriut, me qëllim përmirësimin e mbrojtjes së personave dhe komuniteteve vulnerabël në vend. Monitorimi përfshin mbledhjen, verifikimin, analizën sistematike dhe përdorimin e informacionit për të avancuar mekanizmat e mbrojtjes dhe parandalimit. Monitorimi i gjuhës së urrejtjes kërkon kujdes në garantimin e konfidencialitetit të viktimave, paanshmëri në vlerësimin e situatës dhe ndjeshmëri gjinore në analizimin e shkaqeve të saj dhe informimin e përpjekjeve të mëtijshme avokuese.

Monitorimi i incidenteve të gjuhës së urrejtjes duhet të ketë ndjeshmëri kohore dhe përpikëri. Duhet të jetë transparent dhe i bazuar në metodologji të qartë. Këto udhëzime shërbejnë si metodologji orientuese për të kryer monitorim efektiv.

Mbi të gjitha, para se të kryhet monitorimi i gjuhës së urrejtjes, pikat më poshtë duhen pasur parasysh:

- Së pari, është e nevojshme të kontrollohen të gjitha burimet në dispozicion: raporte të organizatave të shoqërisë civile; rekomandimet e organizatave ndërkombëtare; mediat tradicionale dhe sociale; etj.
- Së dyti, është jashtëzakonisht e rëndësishme të forcohet mekanizmi i raportimit të viktimave, i cili shërben si burim kryesor i provave të drejtpërdrejta;
- Së treti, kapacitetet metodologjike për dokumentimin dhe burimet njerëzore për analizimin e të dhënave ekzistuese duhet të mbështeten për të siguruar qëndrueshmërinë e monitorimit.

Ekziston një dallim i hollë mes asaj që mund dhe nuk mund të konsiderohet gjuhë e urrejtjes. Për të përcaktuar nëse ngjarja/incidenti përbën gjuhë të urrejtjes, duhet të merren parasysh sa vijon:

- 1) **konteksti** social dhe politik; 2) **statusi** i folësit; 3) **qëllimi** për të nxitur publikun kundër një grupi të synuar; 4) **përmbajtja dhe forma** e shprehjes; 5) **përhapja** e gjuhës së urrejtjes; dhe 6) rreziku i dëmtimit, përfshirë **kërcënimin**.

Është e rëndësishme të mbahen parasysh edhe **llojet e gjuhës së urrejtjes** të cilat, në kontekstin shqiptar, prekin kryesisht grupet etnike dhe fetare, të klasifikuara në tri kategori sipas fortësisë:

E fortë:

- 1) Thirrje për dhunë (përfshirë thirrjet e kamufluara/të tërthorta);
- 2) Thirrje për diskriminim, përfshirë në formën e sloganeve të përgjithshme;
- 3) Thirrje për të parandaluar konsolidimin në rajon.

E moderuar:

- 4) Justifikimi i rasteve historike të dhunës dhe diskriminimit;
- 5) Publikime dhe deklarata që sfidojnë fakte historike botërisht të njohura të dhunës dhe diskriminimit (p.sh., mohimi i holokaustit);
- 6) Akuza për krime historike nga një grup etnik apo fetar si i tillë;
- 7) Akuza për kriminalitetin e një grupi të caktuar etnik apo fetar;
- 8) Argumente për epërsinë joproporcionale të një grupi të caktuar etnik apo fetar në pasuri materiale, përfaqësim në strukturat shtetërore, në shtyp, etj.;
- 9) Akuza për ndikim negativ të ndonjë grupi etnik apo fetar te shoqëria dhe Shteti;
- 10) Akuzimi i grupit se po tenton marrje pushteti me dhunë ose zgjerim territorial;
- 11) Mohimi i nënshtetësisë.

E butë:

- 12) Krijimi i imazhit negativ për një grup etnik apo fetar;
- 13) Deklarata për inferioritet të një tjetër grupi etnik apo fetar në vetvete;
- 14) Akuza për cene morale të një grupi të caktuar etnik apo fetar;
- 15) Përmendja e një grupi etnik apo fetar apo përfaqësuesve të tij në një kontekst përçmues ose fytes;
- 16) Citimi i deklaratave dhe tekstit qartësisht ksenofob pa komente.

Për të shfrytëzuar sa më mirë mjetet e monitorimit, është e nevojshme që fillimisht **të përcaktohet detyra parësore dhe objektivi i monitorimit**, pra, nëse synohet të kuptohet situata në hapësirën e informacionit të vendit në tërësi, të mbledhen prova për manifestimet më të dukshme dhe flagrante të gjuhës së urrejtjes, apo të vlerësohet ndikimi dhe të rritet informimi mbi mekanizmat mbrojtës për një grup veçanërisht vulnerabël që dihet se është në rrezik të lartë shënjestrimi nga gjuha e urrejtjes.

Tabela e mëposhtme shërben si mjet udhëzues për dokumentim dhe vlerësimin efektiv të raporteve të viktimave dhe dëshmitarëve, si dhe për analizën strategjike të tendecave online dhe offline. Duhet të kryhet periodikisht ose në baza ad-hoc kur ndodhin incidentet. Kjo duhet realizuar periodikisht apo rast pas rasti kur ndodh incidenti.

	Viktimat (grupet vulnerabël)	Dhunuesit (aktorët e përfshirë)	Lloji i gjuhës së urrejtjes	Motivet (etnike, fetare, me bazë gjinore, etj.)	Gradimi (e fortë, e moderuar, e butë)	Vendndodhja (online/ offline)	Ndikimi (bazuar në raportimin e viktimës)	Prova/ Evidenca (nëse ka)
Rasti/ Incidenti								

Në rastin e **monitorimit të gjuhës së urrejtjes në median tradicionale apo rrjetet sociale**, tabela më poshtë paraqet disa konsiderata kryesore:

	Karakteristikat e platformës (p.sh. rajoni, audienca, orientimi politik apo fetar)	Autori i artikullit, autori i deklaratës së gjuhës së urrejtjes (nëse ndryshojnë)	Citimi	Burimi (edhe URL)	Grupet e synuara (shkaqe etnike, fetare apo të tjera)	Lloji i gjuhës së urrejtjes	Prevalenca e gjuhës së urrejtjes (edhe gradimi)	Prirjet aktuale
Emri i platformës mediatike								

Të dhënat e mbledhura në tabelën më lart duhet të shërbejnë si **evidencë/provë për të gjetur zgjidhje dhe për të informuar punën avokuese për të drejtat e njeriut, ndryshimet legjislative apo praktikat e agjencive ligjzbatuese**. Prandaj, nevojitet të përcaktohen platforma mediatike specifike apo rrethana të tjera ku gjuha e urrejtjes ndodh më shpesh, në mënyrë që ato të studiohen në kuadrin e një projekti monitorimi në mënyrë sistematike, të imtësishme dhe për një periudhe të gjatë.

SHTOJCA 2

FORMULARI I RAPORTIMIT TË VIKTIMËS SË GJUHËS TË URREJTJES

Informacion i rëndësishëm

- **Qëllimi i pyetësorit është të mbledhë evidenca/prova** dhe të dhëna për incidentet e gjuhës së urrejtjes në mbarë Shqipërinë, që të informohen IKDNj-të në kuadrin e mandatit të tyre për monitorimin e prevalencës së fenomenit të gjuhës së urrejtjes në vend. Të dhënat e mbledhura përmes këtij vërtetimi përdoret vetëm për qëllimin e lartpërmendur.
- Kini parasysh se ky pyetësor përmban gjithsej **22 pyetje**. Vërtetimi ndahet në tri pjesë për të kuptuar më mirë natyrën e incidentit, palët e përfshira dhe motivet e dyshuara të incidentit. Jeni të lutur të merrni sa më shumë informacion.
- Nëse keni nevojë për mbështetje të viktimës apo ndërhyrje të agjencive ligjzbatuese në një rast të caktuar, lutemi klikoni kutizën më poshtë. Të dhënat e hedhura në këtë raport mund të transferohen pastaj te strukturat ligjzbatuese dhe/ose ofruesit e shërbimeve të mbrojtjes së viktimës.
- Në këtë formular, termat viktimë dhe i/e mbijetuar u referohen individëve që kanë qenë objekt i gjuhës së urrejtjes. Edhe pse këto dy terma përdoren si sinonime, ato mund të kenë implikime të ndryshme në kontekste të ndryshme. Në disa raste, fjala viktimë mund të përdoret për dikë që ende përjeton efektet e gjuhës së urrejtjes, ndërsa termi i/e mbijetuar i referohet dikujt që e ka marrë veten nga ngjarja/incidenti. Kini parasysh se **për raportimin e një incidenti, nuk duhet detyrimisht të jeni viktimë apo i/e mbijetuar e gjuhës së urrejtjes**.
- **Gjuha e urrejtjes është çdo formë e shprehjes publike përmes çfarëdo mjeti, e promovimit dhe nxitjes së denigrimit, urrejtjes apo përgojimit, çdo ngacmim, ofendim, stereotipizim negativ, stigmatizim apo kërcënim ndaj një personi apo grupi personash, si edhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes mbi bazën e një liste joshtruese të shkaqeve të parashtruara në nenin 1 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.**

 Duke klikuar këtë kutizë, unë konfirmoj se e kuptoj informacionin më lart dhe dëshiroj të dorëzoj këtë raport.

 Duke klikuar këtë kutizë, unë lejoj që të dhënat e hedhura në këtë formular të transferohen te strukturat përkatëse të mbështetjes së viktimës dhe/ose organet ligjzbatuese.

PJESA I: INFORMACION I PËRGJITHSHËM

1. Ti je:

- ☐ I/E mbijetuar
- ☐ Dëshmitar/e
- ☐ Organizatë e shoqërisë civile / organizatë mbështetëse
- ☐ Tjetër. Specifiko: Kliko ose shtyp këtu për të shkruar tekstin.

2. Të dhënat e kontaktit:

Të dhënat e tua personale nuk do t'i tregohen palëve të treta pa pëlqimin tënd.

Emri yt / emri i organizatës: Kliko ose shtyp këtu për të shkruar tekstin.

E-mail: Kliko ose shtyp këtu për të shkruar tekstin.

Numri i telefonit: Kliko ose shtyp këtu për të shkruar tekstin.

Adresa (fakultative): Kliko ose shtyp këtu për të shkruar tekstin.

3. Data e denoncimit

Kliko ose shtyp për të shënuar datën

4. Data e ngjarjes / incidentit:

- ☐ Vetëm një episod
- ☐ Ngjarje e përsëritur

5. Koha e ngjarjes / incidentit:

Zgjidhni kohën kur ndodhi.

- ☐ Mëngjes
- ☐ Pasdite

- ☐ Mbrëmje
- ☐ Natën
- ☐ S'e di

6. Vendi i ngjarjes / incidentit:

Zgjidhni ku ndodhi incidenti.

- ☐ Në publik
- ☐ Në sferën private
- ☐ Në media, internet ose në komunikim

PJESA II: I/E MBIJETUAR / DHUNUESI

7. Moshë e të mbijetuarit(ës):

- ☐ <18 vjeç
- ☐ 18 - 30
- ☐ 31 - 60
- ☐ 61+
- ☐ S'e di.

8. Gjinia e të mbijetuarit(ës):

- ☐ Femër
- ☐ Mashkull
- ☐ Tjetër
- ☐ S'e di

9. I/E mbijetuari(a) është... :

- ☐ Individ

- ☐ Grup (2 apo më shumë persona)
- ☐ Komunitet

Nëse dihet, lutemi përshkruani përkatësinë etnike të të mbijetuarit(ës): Kliko ose shtyp këtu për të shkruar tekstin

10.Mosha e dhunuesit:

- ☐ <18 vjeç
- ☐ 18 - 30
- ☐ 31 - 60
- ☐ 61+
- ☐ S'e di.

11.Gjinia e dhunuesit:

- ☐ Femër
- ☐ Mashkull
- ☐ Tjetër
- ☐ S'e di

12.Dhunuesi është...:

- ☐ Individ
- ☐ Grup (2 apo më shumë persona)
- ☐ Komunitet

Nëse dihet, lutemi përshkruani përkatësinë etnike të dhunuesit: Kliko ose shtyp këtu për të shkruar tekstin.

13. Marrëdhënia e dhunuesit me të mbijetuarin(ën):

- ☐ Dhunuesi dhe i/e mbijetuari(a) njihen personalisht
- ☐ Dhunuesi dhe i/e mbijetuari(a) njihen profesionalisht
- ☐ Dhunuesi dhe viktimi nuk njihen mes tyre
- ☐ Tjetër. Specifiko: Kliko ose shtyp këtu për të shkruar tekstin.
- ☐ S'e di.

14. Lutemi, shtoni ndonjë detaj tjetër për dhunuesin që doni ta raportoni. Për arsye ligjore, mos jepni identitetin e individit.

PJESA III: INCIDENTI

15. Specifikoni llojin e incidentit që po denonconi:

Zgjidhni të gjitha llojet e ndodhura.

- ☐ Dhunë verbale / abuzim verbal
- ☐ Nxitje e urrejtjes (poshtërim, ofendim, nxitje të dhunës, etj.)
- ☐ Kërcënimet / kanosjet (verbale ose me shkrim)
- ☐ Ngacmim / Ngacmim seksual
- ☐ Tjetër. Specifiko: Kliko ose shtyp këtu për të shkruar tekstin.

16. Nëse incidenti i ndodhi dikujt tjetër, si e morët vesh (fakultative)

- ☐ Pashë / dëgjova
- ☐ Ma tregoi një tjetër person
- ☐ E zbulova në internet
- ☐ Tjetër. Specifiko: Kliko ose shtyp këtu për të shkruar tekstin.

17. Sipas jush, cila ishte baza e incidentit me gjuhën e urrejtjes?

Gjuha e urrejtjes është **çdo formë e shprehjes publike përmes çfarëdo mjeti, e promovimit dhe nxitjes së denigrimit, urrejtjes apo përgojimit, çdo ngacmim, ofendim, stereotipizim negativ, stigmatizim apo kërcënim ndaj një personi apo grupi personash, si edhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes mbi bazën e një liste joshteruese të shkaqeve të parashtruara në nenin 1 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.**

Është e rëndësishme të nënvizohet se edhe pse ju apo personi tjetër i vënë në shënjestër mund të mos i përkisni domosdo një grupi të caktuar, dhunuesi ju ka konsideruar si pjesëtar i një grupi të caktuar.

Zgjidhni përgjigjet që qëndrojnë.

- ☐ Mosha
- ☐ Gjinia / Identiteti gjinor
- ☐ Orientimi seksual
- ☐ Aftësia e kufizuar
- ☐ Raca
- ☐ Përkatësia etnike
- ☐ Nënshitetësia / Kombësia
- ☐ Gjuha
- ☐ Statusi socio-ekonomik
- ☐ Përkatësia politike
- ☐ Besimi fetar
- ☐ Statusi shëndetësor

- ☐ Statusi civil/familjar/martesor
- ☐ Përkatësia në një grup të caktuar
- ☐ Tjetër. Specifiko: Kliko ose shtyp këtu për të shkruar tekstin.

18. Pse mendoni se ishte incident paragjykimi, anshmërie dhe gjuhe urrejtjeje ndaj një grupi të caktuar? Përshkruani incidentin hollësisht.

Jepni sa më shumë informacion për shprehjet e thëna, vendin e incidentit që mund të lidhet me një komunitet të caktuar, veshjet dalluese, apo rrethana të tjera që ju bindin se ky ishte një incident i gjuhës së urrejtjes.

19. Tregoni prova (p.sh. foto, screenshots, link online, etj.) të incidentit:

Nëse keni prova të forta, lutemi bashkëngjitini në këtë formular.

20. Çfarë pasojash pati incidenti te viktima/i(e) mbijetuari(a)?

Zgjidhni përgjigjet që qëndrojnë.

- ☐ Dhunim dhe dëmtime fizike
- ☐ Stres psikologjik (frikë, ankth, traumë, turp)
- ☐ Tjetër. Specifiko: Kliko ose shtyp këtu për të shkruar tekstin.

21.A është denoncuar incidenti në tjetër institucion / polici / OJF?

Kjo na ndihmon të kuptojmë nëse rasti juaj llogaritet edhe në statistika të tjera. Zgjidhni përgjigjet që qëndrojnë.

- ☐ Policia / Sistemi i Drejtësisë Penale
- ☐ OJF ose organizatë e shoqërisë civile. Specifiko: Kliko ose shtyp këtu për të shkruar tekstin.
- ☐ Tjetër
- ☐ Jo
- ☐ S'e di

22.Nëse incidenti nuk është denoncuar te organet ligjzbatuese apo shërbimet e mbështetjes së viktimës, lutemi jepni arsyen.

Zgjidhni përgjigjet që qëndrojnë.

- ☐ Më vinte turp / Ndihesha në siklet
- ☐ Kisha frikë të zbuloja identitetin tim
- ☐ Kisha frikë nga policia / organi ligjzbatues
- ☐ S'besoja se policia apo organi ligjzbatues do të merrte ndonjë masë
- ☐ I druhesha hakmarrjes së dhunuesit
- ☐ Mendova se denoncimi do të ishte shumë i vështirë
- ☐ Incidente të tilla ndodhin kaq shpesh sa që s'e mendova se duhen denoncuar
- ☐ Nuk m'u dukën veprime aq të rënda sa për t'u denoncuar te agjencitë ligjzbatuese
- ☐ S'dija si ta denoncoja
- ☐ Tjetër. Specifiko: Kliko ose shtyp këtu për të shkruar tekstin.
- ☐ **Deklaroj se informacioni më lart është i saktë.**

Emri:

Data:

Nënshkrimi:

SHTOJCA 3

VIKTIMA E GJUHËS SË URREJTJES

UDHËZIME PËR INTERVISTIMIN

Intervistimi i viktimave dhe dëshmitarëve, bashkë me mbledhjen e provave me shkrim përmes mekanizmave të raportimit, janë dy mënyrat më efektive për dokumentimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes në funksion të shqyrtimit të shtrirjes së fenomenit dhe vlerësimit të ndikimit që ka te grupet e marginalizuara. Informacioni i drejtpërdrejtë që japin viktimat dhe dëshmitarët shërben edhe si burimi më i besueshëm i provave që hedh themelet për angazhim të mëtijshëm në luftën kundër gjuhës së urrejtjes përmes mjeteve të ndryshme të ndërgjegjësimit dhe ngritjes së kapaciteteve, si trajnimet e ndjeshmërisë për agjencitë ligjzbatuese apo fushatat e ndërgjegjësimit publik mbi vulnerabilitetin e grupeve të caktuara ndaj gjuhës së urrejtjes.

Udhëzime metodologjike

Udhëzimet e mëposhtme duhet të ndiqen gjatë përgatitjes dhe kryerjes së intervistimit të viktimave dhe dëshmitarëve të gjuhës së urrejtjes.

HAPI 1

Intervista të ketë në qendër viktimën dhe të drejtat e njeriut

Ndërtimi i provave përmes intervistave me viktimat është një proces që kërkon ndjeshmëri gjinore dhe përjasje bazuar në të drejtat e njeriut, për të parandaluar viktimizimin e dyfishtë dhe traumatizimin dytësor të viktimave. Në shumë raste specifike, konsideratat e gjinisë dhe moshës duhet të merren parasysh. Një grua që është viktimë e diskriminimit, gjuhës seksiste të urrejtjes, ngacmimit ose veçanërisht dhunës me bazë gjinore duhet të intervistohet vetëm nga një grua. Gjatë intervistimit të një të mituri, mund të jenë të pranishëm prindërit ose kujdestarët e tij, si dhe një psikolog ose mësues, me pëlqimin e viktimës. Për më tepër, mund të duhet një përkthyes (ose, nëse koha nuk pret, të asistojë me përkthim një anëtar i familjes ose mik) që të përkthejë për një viktimë që nuk flet në një gjuhë që intervistuesi e kupton.

HAPI 2

Intervista të kryhet nga personeli me trajnim adekuat

Para kryerjes dhe gjatë vlerësimit të informacionit që viktimat ose dëshmitarët jepen në intervistë, është jashtëzakonisht e rëndësishme që personeli që kryen intervistat me viktimat të ketë marrë trajnim adekuat; pra, duhet ta njohin procedurën mjaftueshëm, të kenë mjete për të dokumentuar dhe - nëse është e nevojshme – të arrijnë të referojnë viktimat te organet ligjzbatuese ose te shërbimet për mbështetjen e viktimave. Edhe pse monitorimi nuk ka për qëllim ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve për viktimat, intervistuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se gjuha e urrejtjes mund të nxitë ose shoqërojë krimet e urrejtjes; të dy dukuritë janë të ndërlidhura dhe shpeshherë përforcojnë njëra-tjetrën. Prandaj, informacioni që viktimat jepen gjatë intervistës mund të shërbejë si provë për një krim të supozuar të urrejtjes ose krime të tjera që mund të ndiqen penalisht. Në këtë drejtim, intervistuesi duhet të jetë në gjendje t'i referojë viktimat te institucionet përkatëse. Megjithatë, duhet theksuar se intervistuesi duhet të ketë kujdes me pyetjet rreth nevojave që nuk mund të përmbushen për shkak të mungesës së ofruesve adekuatë të shërbimeve. Informacioni për shërbimet e disponueshme duhet t'u jepet viktimave në një format që e kuptojnë, që u mundëson të marrin vendime të informuara për mbështetjen që mund të kenë dhe dëshirojnë të kenë.

HAPI 3

Krijoni një hapësirë të sigurt për viktimën

Intervista duhet të kryhet në një atmosferë ku viktimat të ndiejë siguri, rehati dhe besim. Kjo ndonjëherë vështirë të arrihet, sidomos kur personi i përket një grupi të marxhinalizuar në rrezik më të lartë të gjuhës së urrejtjes. Megjithatë, intervistuesi duhet të bëjë gjithçka të mundur për t'i garantuar viktimës një hapësirë të sigurt.

Vendi ideal i intervistimit është zyra e Komisionerit, por kjo nuk është gjithmonë e mundur (p.sh., gjatë vizitave monitoruese në terren) apo e dëshirueshme (p.sh., viktimat nuk dëshirojnë ta shohin se po shkon te zyra e Komisionerit). Secila situatë është unike dhe ka sfidat e veta. Individët që janë të izoluar nga shoqëria dhe ndiejnë mungesën e mbështetjes, siç janë personat LGBTI, nuk janë gjithmonë gati t'u besojnë menjëherë përfaqësuesve të institucioneve shtetërore. Viktimat ose dëshmitarët mund të dojë të takohet me intervistuesin, por jo që të njohurit, fqinjët apo familjarët e tij të kenë dijeni për këtë kontakt.

Në çdo rast, është krejt e pakëshillueshme që intervista të bëhet në rrugë ose në vende publike, sepse nuk i shton as rehatinë apo sigurinë viktimës/ kërkuesit/ dëshmitarit. Takimi duhet të zhvillohet në një hapësirë të sigurt, të mbyllur që nxit besim si te ju, ashtu edhe te dëshmitari. Nëse intervistoni në një tjetër qytet, preferohet të gjeni një organizatë partnere e gatshme të japë një zyrë në kohë, në vend që ta kryeni

intervistën në hotel. Megjithatë, nëse nuk ka mundësi të tjera, hoteli preferohet para kafenesë. Ka raste kur viktimat mund të intervistohet në shtëpinë e vet. Është e rëndësishme që në dhomë të mos ketë ndërhyrje të palëve të treta, përfshirë kolegë që nuk kanë lidhje me intervistën. Ndjesia e rehatisë dhe sigurisë të intervistuarit është element thelbësor i dokumentimit cilësor të rastit.

HAPI 4

Dokumentim pa dyshim

Dallimi mes provës së drejtpërdrejtë nga viktimat/dëshmitarët dhe provës së tërthortë të marrë nga burime dytësore duhet të jetë i qartë. Edhe pse prova e drejtpërdrejtë është burimi më i besueshëm i informacionit, edhe prova e tërthortë (p.sh., Unë nuk isha aty, por më thanë...) mund të përfshihet në intervista dhe të pranohet gjatë procesit të dokumentimit, nëse është relevante me objektin e incidentit. Duhet theksuar se pretendimet dhe provat e ofruara nga viktimat nuk duhet të vlerësohen me dyshim. Intervistimi është faza e parë e mbledhjes së provave dhe viktimat nuk duhet të ndihet se pretendimet e veta po vihen në dyshim.

Protokolli i intervistës

- 1. Informacion prezantues.** Prezantohuni. Tregoni **qëllimin e intervistës** – pse po e bëni. Shpjegoni qartë pse kërkuesi ka nevojë të komunikojë me ju.
 - a. Informoni personin se ku dhe si do të përdoret **informacioni** i marrë dhe pasojat e përdorimit të tij.
 - b. Sigurohuni që personi të ndihet rehat me intervistën dhe me **vendin** ku zhvillohet intervista. Nëse jo, zhvendoseni bisedën në një tjetër vend tjetër ose në një tjetër moment.
 - c. Tregoni **kohën** e përafërt sa zgjat intervista dhe pyesni personin sa kohë ka.
- 2. Informacion reference.** Regjistroni të dhënat personale të kërkuesit. Zbuloni cila mënyrë komunikimi është më e përshtatshme për personin (në telefon, e-mail, skype, ballë përballë).

3. Informacioni për vetë shkeljen/incidentin. Kërkojini kërkuesit të përshkruajë shkeljen hollësisht sipas rendit kronologjik të ngjarjeve.

- a. Ju duhet të përcaktoni qartë dhe në mënyrë logjike **çfarë, kur, ku, si dhe pse ndodhi incidenti.**
- b. Kërkuesi duhet të japë informacion sa më të hollësishëm dhe të tregojë sa më shumë për vendngjarjen.
- c. **Regjistroni fjalë për fjalë deklaratimet** e kërkuesit lidhur me gjuhën e urrejtjes. Kërkojini kërkuesit t'i kujtojë dhe t'i citojë saktësisht deklaratat, mundësisht fjalë për fjalë, duke shmangur eufemizmat apo alegoritë. Citimi i saktë mund të luajë rol kyç në cilësimin ligjor të veprës. Rasti ideal është kur deklaratat cënuesen ka pasur dëshmitarë përveç viktimës. Është edhe më mirë kur ekziston regjistron video ose audio i deklaratës që të shërbejë si **provë.**
- d. Nëse gjatë intervistës, personi vë në dukje praninë e dëshmitarëve ose viktimave të tjera, intervistuesi duhet të flasë me ta nëse është e mundur të zhvillohet e njëjta bisedë. Përveç konfirmimit të mundshëm të fjalëve të viktimës, kjo vlen për të plotësuar çështjen dhe mundëson informacion më të hollësishëm për incidentin.
- e. Në këtë pjesë, kushtojini vëmendje të veçantë **gjendjes emocionale të viktimës:**
 - i. Tregoni merak për ndjenjat e viktimës duke i shprehur keqardhjen për krimin që i ka ndodhur.
 - ii. Tregojeni veten si burim sigurie dhe rehatie.
 - iii. Mos e zvogëloni ndikimin e incidentit.
 - iv. Lejojini viktimës mundësinë që të shfryhet.
 - v. Tregoni neutralitet.
 - vi. Jini proaktiv dhe mbështetës.
 - vii. Përshkruajeni gjendjen emocionale të viktimës në raport.
 - viii. Mos komentoni gjykimin e viktimës për sigurinë e vet.
- f. Mos lejoni që gjykimet tuaja personale për sjelljen, stilin e

jetesës apo kulturën e viktimës të ndërhyjë në profesionalizmin e intervistës suaj. Kini parasysh se nëse viktima ka prejardhje të ndryshme nga e juaja, mund të mos dini cilat sjellje janë të pranueshme në kulturën e tyre. **Përdorni terminologjinë e duhur** të përshkruani grupet e pakicave. Kini ndjeshmëri ndaj faktit se individë të caktuar mund të ofendohen nëse përshkruhen se u përkasin një grupi me të cilin nuk identifikohen.

4. Informacioni për dhunuesin e dyshuar. Kërkuesi duhet të japë sa më shumë informacion të hollësishëm për dhunuesin.

- a. Pyesni për gjatësinë, ngjyrën e flokëve, ngjyrën e syve, ndonjë veçori fizike të dhunuesit të dyshuar.
- b. Bëni pyetje për veshjen, etiketimet, theksin dhe hollësi të tjera. Disa veçori të veshjes apo simboleve që mbajnë mund të tregojnë orientimin ideologjik të dhunuesit të pretenduar ose përkatësinë në një grup. Ndonjëherë, kjo mund të jetë provë e tërthortë e dashjes në veprimet apo gjuhën e përdorur.

5. Përfundimi i intervistës. Në fund të intervistës, ri-lexoni shënimet me zë që të siguroheni se gjithçka është e saktë, ose lëreni dëshmitarin t'i lexojë.

- a. Diskutoni për një mënyrë të përshtatshme kontaktimi në të ardhmen, nëse do të jetë e nevojshme.
- b. Falënderoni kërkuesin për informacionin e dhënë. Nëse është e nevojshme, shprehni mbështetjen apo keqardhjen për incidentin e ndodhur.

REFERENCAT

Dokumentet ligjore dhe të politikave

- Vendim Kuadër për luftën kundër formave dhe shprehjeve të caktuara të racizmit dhe ksenofobisë përmes ligjit penal, Këshilli i Bashkimit Evropian, 28 nëntor 2008, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32008F0913> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Rezoluta 260 A (III), datë 9 dhjetor 1948 e Asamblesë së Përgjithshme, <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CrimeOfGenocide.aspx> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Rekomandimi nr. 15 i Politikës së Përgjithshme për Luftën kundër Gjuhës së Urrejtjes, Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës. 8 dhjetor 2015. <https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-15-on-combating-hate-speech/16808b5b01> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Komiteti i Të Drejtave të Njeriut. Koment i përgjithshëm nr. 34 për nenin 19, ICPPR. <https://www2.ohchr.org/english/bodies/hrc/docs/gc34.pdf> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial. Miratuar më 21 dhjetor 1965. <https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/cerd.pdf> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Rekomandimi nr. R (97) 20 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për “gjuhën e urrejtjes”. <https://rm.coe.int/1680505d5b> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Asambleja e Përgjithshme e Këshillit të Evropës. Rekomandimi 1805 (2007). Blasfemia, fyerje fetare dhe gjuha e urrejtjes ndaj personave për shkaqet e fesë së tyre. Miratuar më 29 qershor 2007. <http://www.assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-EN.asp?fileid=17569&lang=en> [aksesuar më 29 tetor 2021].

Udhëzuesit, Manualët dhe Raportet

- Raporti Vjetor për aktivitetet e ECRI-t për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2020. Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës, Këshilli i Evropës. Strasburg, mars 2021. <https://rm.coe.int/annual-report-on-ecri-s-activities-for-2020/1680a1cd59> [aksesuar më 29 tetor 2021].

- Udhëzues i Hollësishëm për Zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit të OKB-së për zyrat në terren të OKB-së. Shtator 2020. https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/UN%20Strategy%20and%20PoA%20on%20Hate%20Speech_Guidance%20on%20Addressing%20in%20field.pdf [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Udhëzues për nenin 10 të Konventës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut. Liria e shprehjes. Gjykata Evropiane e Të Drejtave të Njeriut. Përditësim – 30 prill 2021. https://www.echr.coe.int/documents/guide_art_10_eng.pdf [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Shpjegimi i “gjuhës së urrejtjes”: Manual. Neni 19. Botim i vitit 2015. <https://www.article19.org/data/files/medialibrary/38231/'Hate-Speech'-Explained---A-Toolkit-%282015-Edition%29.pdf> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Monitorimi i Të Drejtave të Njeriut: Hapat drejt Suksesit. OSBE/ODIHR. <https://www.osce.org/files/f/documents/7/6/312676.pdf> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Londo, Ilda. Gjuha e Urrejtjes, Propaganda dhe Dezinformimi në median shqiptare. Qëndresa: Për një media pa urrejtje dhe dezinformim. Ljubjanë, shtator 2020. <https://seenpm.org/wp-content/uploads/2020/10/Resilience-research-publication-1-ALB-ENG.pdf> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Manual për Gjuhën e Urrejtjes, Këshilli i Evropës. <https://rm.coe.int/168071e53e> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Studim analizues për projektet kundër gjuhës së urrejtjes në internet, Instituti Britanik i Të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës, 2012. <https://rm.coe.int/16807023b4> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Njëfaqësh për “nxitjen e urrejtjes”, Komisioneri i Lartë për të Drejta e Njeriut, OKB. https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Opinion/SeminarRabat/Rabat_threshold_test.pdf [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Parandalimi dhe përgjigjja ndaj krimeve të urrejtjes: Manual burimor për OJF-të në rajonin e OSBE-së. <https://www.osce.org/files/f/documents/8/a/39821.pdf> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Ramšak, Anita. Udhëzime për Raportimin me Ndjeshmëri Gjinore. Republika e Sllovenisë, Ministria e Punëve të Jashtme. http://www.ekvilib.org/wp-content/uploads/2017/06/en_GUIDELINES_FOR_GENDER_SENSITIVE_REPORTING.pdf [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Romët në Shqipëri. Qendra për Dokumentacionin dhe Informimin mbi Pakicat

- në Evropë. Gusht 2000. https://cadmus.eui.eu/bitstream/handle/1814/46231/Koinova_RomaofAlbania.pdf [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Manual Trajnimi për Të Drejtat e Njeriut. Zyra e Komisionerit të Lartë për Të Drejtat e Njeriut, Seria Profesionale nr. 7. 2001. <https://www.ohchr.org/Documents/Publications/OHCHRIntro-12pp.pdf> [aksesuar më 29 tetor 2021].
 - Çfarë është monitorimi i të drejtave të njeriut? UN Women. 21 dhjetor 2011. <https://www.endvawnow.org/en/articles/994-what-is-human-rights-monitoring.html> [aksesuar më 29 tetor 2021].
 - Këshilli i Të Drejtave të Njeriut, OKB. Sesioni i 46-të. Raport i Relatorit të Posaçëm për çështjet e pakicave. A/HRC/46/57 <https://undocs.org/A/HRC/46/57> [aksesuar më 29 tetor 2021].

Literatura

- Bahador, Babak. Classifying and Identifying the Intensity of Hate Speech// Insights from the Social Sciences. November 17, 2020. <https://items.ssrc.org/disinformation-democracy-and-conflict-prevention/classifying-and-identifying-the-intensity-of-hate-speech> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Bellamy, Raymond F. The question of innate gregariousness or sociability. Quarterly Journal of the Florida Academy of Sciences. Vol. 16, No. 4. December, 1953. p. 223-232.
- Berkowitz, Leonard. Frustration-aggression hypothesis: Examination and reformulation. Psychological Bulletin. 106 (1). 1989. p. 59–73.
- Buss, Arnold. Physical aggression in relation to different frustrations. The Journal of Abnormal and Social Psychology. 67 (1). 1963. p. 1–7.
- Castano-Pulgarín, Sergio Andres; Suarez-Betancur, Natalia; Vega, Luz Magnolia Tilano; Lopez, Harvey Mauricio Herrera. Internet, social media and online hate speech. Systematic review. Aggression and Violent Behavior. No 58. 2021. Retrieved from: <https://prohic.nl/wp-content/uploads/2021/05/213-17mei2021-InternetOnlineHateSpeechtSystematicReview.pdf> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Coliver, Sandra (ed.) Striking the Balance: Hate Speech, Freedom of Expression and Non-Discrimination. Article 19, International Center Against Censorship. Human Rights Center, University of Essex. 1992. <https://www.article19.org/data/files/pdfs/publications/striking-a-balance.pdf> [aksesuar më 29 tetor 2021].

- Désir, Harlem. Comparative Legal Analysis of Ukrainian Regulation of Hate Speech in the Media. Organization for Security and Co-operation in Europe, The Representative on Freedom of the Media. 2018. <https://www.osce.org/files/f/documents/7/e/384567.pdf> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Fukuyama, Francis. Identity: The Demand for Dignity and the Politics of Resentment. New York: Farrar, Straus and Giroux, 2018.
- Greene, A. R.; Simpson, R. M. Tolerating hate in the name of democracy. The Modern Law Review, 80(4), 2017. p. 746–765.
- Hysa, Dorentina. The challenge of hate speech in the Albanian media environment. Reporting Diversity Network 2.0. <https://www.reportingdiversity.org/the-challenge-of-hate-speech-in-the-albanian-media-environment/> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Ilić, Vujo. Etnički stereotipi u albanskim i srpskim udžbenicima istorije. In: Tepšić, Goran; Nakarada, Radmila; Vasović, Mirjana (Eds.) Etnički stereotipi i nacionalni mitovi kao prepreke pomirenju u srpsko-albanskim odnosima. Beograd: Fakultet političkih nauka. 2015. p. 177-212. https://www.academia.edu/6258496/Ethnic_Stereotypes_and_National_Myths_as_an_Obstacle_to_Reconciliation_Albanian_Serbian_Relations [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Jane, Emma Alice. “Back to the kitchen, cunt’: speaking the unspeakable about online misogyny”. Continuum: Journal of Media & Cultural Studies. 28 (4). 2014. p. 558–570.
- Klein, Gabriella B. Applied Linguistics to Identify and Contrast Racist ‘Hate Speech’: Cases from the English and Italian Language. Applied Linguistics Research Journal, 2 (3). https://jag.journalagent.com/alrj/pdfs/ALRJ_2_3_1_16.pdf [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Laaksonen, Salla-Maaria; Haapoja, Jesse; Kinnunen, Teemu; Nelimarkka, Matti; Pöyhtäri, Reeta. The Datafication of Hate: Expectations and Challenges in Automated Hate Speech Monitoring. Frontiers in Big Data. 05 February 2020. <https://www.frontiersin.org/articles/10.3389/fdata.2020.00003/full> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Lewin-Epstein, Noah; Levanon, Asaf. National Identity and Xenophobia in an Ethnically Divided Society// International Journal on Multicultural Societies. Vol. 7, No2, 2005. p. 90 https://www.researchgate.net/publication/26593865_National_Identity_and_Xenophobia_in_an_Ethnically_Divided_Society [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Matusitz, Jonathan. Relationship between Knowledge, Stereotyping, and Prejudice in Interethnic Communication// Pasos: Revista de Turismo y Patrimonio Cultural. Vol. 10, No 1, 2012.

- McLeod, Saul. Robbers Cave Experiment. SimplyPsychology. 2008. <https://www.simplypsychology.org/robbers-cave.html> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Neumann, Inga D.; Veenema, Alexa H.; Beiderbeck, Daniela I. Aggression and Anxiety: Social Context and Neurobiological Links. *Frontiers in Behavioral Neuroscience*. Vol.4. 2010. <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC2854527/pdf/fnbeh-04-00012.pdf> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Stephan, Walter; Stephan, Cookie. *An Integrated Threat Theory of Prejudice*. Psychology Press, 2000.
- Pandea, Anca-Ruxandra; Gremny, Dariusz; Keen, Ellie; Gender Matters. Manual on addressing gender-based violence affecting young people. Second edition – fully revised and updated. Council of Europe, 2015. p. 21. <https://rm.coe.int/gender-matters-a-manual-on-addressing-gender-based-violence-affecting-/16809e1c34> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Peng, Sheng-Yu. Impact of Stereotypes on Intercultural Communication: a Chinese Perspective// *Asia Pacific Educational Review*. 2010. No.11.
- Powell, John A.; Menendian, Stephen. The Problem of Othering: Towards Inclusiveness and Belonging. *Othering and Belonging*. Issue 1. <https://otheringandbelonging.org/the-problem-of-othering/> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Raypole, Crystal. Unpacking Xenophobia, or the Fear of Outsiders. *Healthline*. July 26, 2021. <https://www.healthline.com/health/xenophobia> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Rosenfeld, Michel. Hate Speech in Constitutional Jurisprudence: A Comparative Analysis. *24 Cardozo Law Review* (2003). p. 1525-1529.
- Sanchez-Mazas, Margarita; Licata, Laurent. Xenophobia: Social Psychological Aspects. *International Encyclopedia of the Social & Behavioral Sciences*. Second Edition. 2015. p. 802–807.
- Sherif, Muzafer. *In Common Predicament: Social Psychology of Intergroup Conflict and Cooperation*. 1966.
- Starr, Sandy. Hate speech: What is there to be worried about? <https://www.osce.org/files/f/documents/b/b/36098.pdf> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Tajfel, Henri. Social identity and intergroup behaviour. *Social Science Information*. No 13. 1974. p. 65–93.
- Tajfel, Henri; Flament, Claud; Billig, Michael; Bundy, R. Social categorization and intergroup behaviour. *European Journal of Social Psychology*. No 1, April/June 1971. p. 149–178.

- Van Dijk, Teun. Prejudice in Discourse: An Analysis of Ethnic Prejudice in Cognition and Conversation. John Benjamins Publishing, 1984.
- Van Dijk, Teun. Politics, Ideology and Discourse. Elsevier Encyclopedia of Language and Linguistics, Volume on Politics and Language. Elsevier, 2006. p. 728-740.
- Van Veen, Saskia; Cansfield, Bethan; Muir-Bouchard, Sandrine. 'Let's stop thinking it's normal. Identifying patterns in social norms contributing to violence against women and girls across Africa, Latin America and the Caribbean and the Pacific. Oxfam research report. November 2018. https://oi-files-d8-prod.s3.eu-west-2.amazonaws.com/s3fs-public/file_attachments/rr-lets-stop-thinking-normal-evaw-social-norms-251118-en.pdf [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Verkhovsky, Alexander. Criminal Law on Hate Crime, Incitement to Hatred and Hate Speech in OSCE Participating States. SOVA Center, 2016. <https://www.sova-center.ru/files/books/osce-laws-eng-16.pdf> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Vrysis, Lazaros; Vryzas, Nikolaos; Kotsakis, Rigas; Saridou, Theodora; Matsiola, Maria; Veglis, Andreas; Calderón, Carlos Arcila; Dimoulas, Charalampos. A Web Interface for Analyzing Hate Speech// Future Internet 2021, 13, 80. https://www.researchgate.net/publication/350299504_A_Web_Interface_for_Analyzing_Hate_Speech [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Walker, Julian. Hate Speech and Freedom of Expression: Legal Boundaries in Canada. Hate Speech and Freedom of Expression: Legal Boundaries in Canada. Library of Parliament. Background Paper. Publication No 2018-25-E. <https://lop.parl.ca/staticfiles/PublicWebsite/Home/ResearchPublications/BackgroundPapers/PDF/2018-25-E.pdf> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Yetkiner, Neslihan Kansu. A Critical Discourse Analysis Approach to Othering: Depiction of the Syrian Refugee Experience in Turkish Children's Literature. Sic. No 2 (11). 6/2021. <https://www.sic-journal.org/Article/Index/661> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Zguri, Rapo. Albania: between shadows of the past and interest of the present. In: Lani, Remzi (ed.) Reporting Neighbours in Balkan Media, Albanian Media Institute, 2015. p. 7-28. <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2020/02/Raporting-neighbours-30-06-2015.pdf> [aksesuar më 29 tetor 2021].
- Zhan, Jan; Ren, Jun; Fan, Jin; Luo, Jing. Distinctive effects of fear and sadness induction on anger and aggressive behavior. 6:725. <https://www.frontiersin.org/articles/10.3389/fpsyg.2015.00725/pdf> [aksesuar më 29 tetor 2021].

- Miles, T. U.N. investigators cite Facebook role in Myanmar crisis. Reuters. March 12, 2018. Retrieved from: [U.N. investigators cite Facebook role in Myanmar crisis | Reuters](#) [aksesuar më 29 tetor 2021].

PJESA 2:

MONITORIMI I DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE DHE DHUNA ME BAZË GJINORE

LISTA E SHKURTIMEVE

CEDAW	Konventa për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KDIMDHP	Komisioneri për Të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e Të Dhënave Personale
OShC	Organizatat e Shoqërisë Civile
DnG	Diskriminimi ndaj Grave
DhF	Dhuna në Familje
ENHRI	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të Të Drejtave të Njeriut
KEDNj	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
GjEDNj	Gjykata Evropiane e Të Drejtave të Njeriut
GANHRI	Aleanca Globale për Institucionet Kombëtare të Të Drejtave të Njeriut
DhBGj	Dhuna me bazë Gjinore
QSH	Qeveria e Shqipërisë
KLPK	Komisioneri i Lartë për Pakicat Kombëtare
KS	Konventa e Stambollit
LDhF	Ligji për Dhunën në Familje
M&V	Monitorim dhe Vlerësim
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
IKDNj	Institucione Kombëtare të Të Drejtave të Njeriut
SKBGj	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit i saj
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
AP	Avokati i Popullit
DhNG	Dhuna ndaj Grave

DISKRIMINIMI NDAJ GRAVE DHE DHUNA ME BAZË GJINORE

Kontesti i Vendit

SHqipëria ka bërë përparim të konsiderueshëm në krijimin e kuadrit institucional dhe politikave përkatëse, si edhe me marrjen përsipër të zotime të ndryshme ndërkombëtare për të garantuar barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin. Kuadri ligjor për barazinë dhe mosdiskriminimin rrjedh nga të drejtat dhe liritë themelore të mishëruara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë miratuar në vitin 1998, e cila përcakton se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe si gjinia, raca, feja, përkatësia etnike, gjuha, besimet politike, fetare apo filozofike, situata ekonomike, arsimimi, statusi social apo prejardhja.

Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri synon në mënyrë specifike garantimin e mbrojtjes nga diskriminimi gjinor dhe parashikon masa për praktikën diskriminuese, dispozita antidiskriminuese dhe rolin e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen nga antidiskriminimi në punë, arsim, proceset vendimmarrëse dhe media. Ligji përcakton masat që garantojnë mundësi të barabarta midis burrave dhe grave për të eliminuar diskriminimin me bazë gjinore në çdo formë të tij dhe përcakton përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore qendrore dhe vendore për hartimin dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave në mbështetje të barazisë gjinore në shoqëri.

Gjithsesi, Indeksi i Barazisë Gjinore për vitin 2020 në Republikën e Shqipërisë shënon 60.4 pikë dhe është shtatë pikë nën mesataren e BE-28. Ende duhen marrë hapa për të arritur barazi të plotë gjinore, që kërkojnë angazhime të të gjitha palëve të interesuara, përfshirë qeverinë, sektorin privat, shoqërinë civile dhe qytetarët.

Stereotipet diskriminuese gjinore dhe praktikën e dëmshme mbeten të përhapura dhe mes zonave të rurale, të largëta dhe komuniteteve të pakicave ende ekzistojnë praktika të dëmshme si martesat e fëmijëve, familjet që zgjedhin bashkëshortët dhe pagesa e çmimit të nuses ose prikës. Vitet e fundit është rishfaqur fenomeni i kanunit dhe kodet e sjelljes që tolerojnë vrasjen e grave dhe vajzave në emër të të ashtuquajturit “mbrojtje të nderit”.

Përveç kësaj, vajzat me aftësi të kufizuara dhe vajzat rome dhe egjiptiane, si dhe fëmijët që jetojnë në zona rurale dhe të largëta, kanë akses të kufizuar në arsim si rezultat i infrastrukturës së dobët shkollore dhe mungesës së mësuesve.

Ekziston një përqendrim i madh i grave në tregun informal të punës, veçanërisht në industrinë e tekstilit dhe të këpucëve, pa mbrojtje adekuatë sociale dhe në punë.

Hendeku gjinor i pagave mbetet i konsiderueshëm, veçanërisht në sektorin

privat; paga minimale mbetet jashtëzakonisht e ulët, diçka që prek në mënyrë disproporcionale gratë. Gratë që u përkasin pakicave etnike dhe gjuhësore dhe gratë me aftësi të kufizuara kanë akses të kufizuar në tregun formal të punës.

Diskriminimi i vazhdueshëm dhe mungesa e legjislacionit apo masave të duhura për mbrojtjen e grave dhe vajzave që u përkasin grupeve të pafavorizuara dhe të marginalizuara, si gratë e moshuara, gratë rome dhe egjiptiane, gratë me aftësi të kufizuara, gratë emigrante, gratë lezbike, biseksuale dhe transgjimore, gratë në paraburgim, gratë e izoluara dhe gratë azilkërkuese, veçanërisht për sa i përket aksesit të tyre në arsim, shërbime shëndetësore, punësim, strehim dhe pjesëmarrje në jetën publike dhe politike.

Në Shqipëri, dhuna me bazë gjinore njihet si një nga problematikat më të mprehta të barazisë gjinore në Shqipëri. Sipas raporteve dhe hulumtimeve, dhuna në familje është lloji më i përhapur i dhunës me bazë gjinore. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën e Stambollit, por ndryshimet përkatëse në kuadrin legjislativ dhe të politikave që synojnë të përmirësojnë reagimin dhe mbështetjen institucionale ende nuk janë harmonizuar me kërkesat e Konventës.

Në vitin 2017, Kuvendi i Shqipërisë miratoi rezolutën për dënimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave, e cila parashikon ngritjen e një nënkomisioni të përhershëm për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj grave, që funksionon nën Komisionin parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Detyra kryesore e nënkomisionit është hartimi i një plani veprimi për të adresuar rekomandimet si nga CEDAW ashtu edhe nga GREVIO. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) (2016-2020) ka funksionuar si dokument udhëzues për parimet e barazisë gjinore në shoqëri dhe ka përfshirë angazhimet që rrjedhin nga Konventa e Stambollit. Strategjia ka si objektiv të tretë strategjik luftën kundër DhBGj-së dhe DhF-së, por nuk përkufizon asnjërin term. Në analizën e situatës, Strategjia njeh nevojën për të luftuar DhNG-në, veçanërisht në mesin e grupeve më vulnerabël. Megjithatë, nuk arriti të analizonte siç duhet mendësinë patriarkale që ende mbizotëron në shumë pjesë të vendit, i cili i bën gratë të preken në mënyrë disproporcionale nga dhuna dhe diskriminimi i shumëfishtë pikërisht për shkak të statusit të tyre si gra.

Për më tepër, barazia gjinore dhe reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje janë ndër prioritetet dhe drejtimet zhvillimore kryesore të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020 dhe në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2016-2020.

Ndërkohë që është bërë përparim në krijimin e kuadrit ligjor, zbatimi i tij dhe barazia de facto mbeten shumë prapa, duke prekur në mënyrë disproporcionale veçanërisht gratë. Siç thuhet edhe në raportin e fundit të Komisionit Evropian,⁷⁷ zbatimi dhe monitorimi i mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut mbeten për t'u forcuar. Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe

77 Komisioni Evropian, Raporti 2018 për Shqipërinë, prill 2018. Gjetet në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>

adresimin e dhunës me bazë gjinore mbeten të dobëta.

Dhuna në familje ndaj grave në Shqipëri ka rrënjë kulturore, të ngulura thellë në tradita dhe zakone si p.sh. identitetet dhe rolet gjinore, autoriteti patriarkal, respektimi i sistemit të nderit dhe turpit, si edhe zakonet e hierarkisë brenda familjes. Një vërtetim kombëtar konstatoi se 52.9% e grave në vend kanë

përjetuar një formë të dhunës në familje gjatë jetës së tyre.⁷⁸ Në 48,7% të rasteve të denoncuar të dhunës në familje, autori ishte ose prindi, ose një tjetër pjesëtar i familjes (vëllai, kushëriri, etj.). Një studim i OSBE-së i publikuar në vitin 2019 që maste mirëqenien e grave në Shqipëri, zbuloi se dhuna ndaj grave konsiderohet e zakonshme dhe fare pak gra denoncojnë këto përvoja apo kërkojnë mbështetje. Turpi, frika nga dhunuesi, mosbesimi te institucionet dhe mungesa e mbështetjes financiare janë barrierë që pengojnë denoncimin e grave. Normat kulturore se gruaja duhet t'i bindet burrit dhe për dhunën seksuale në marrëdhëniet intime kontribuojnë më tej në një mjedis që toleron dhunën ndaj grave dhe vajzave. Legjislacioni dhe zbatimi i tij vazhdon të ketë boshllëqe.

Dhuna në familje/dhuna me bazë gjinore mbetet e përhapur anembanë vendit dhe në të gjitha shtresat e shoqërisë. Teksa numri i grave që denoncojnë dhunën po rritet, numri i atyre që nuk guxojnë të bëjnë kallëzim dhe përjetojnë dhunë çdo ditë është shumë më i lartë. Viktimat e dhunës në familje janë pjesë e grupeve vulnerabël në Shqipëri dhe statistikat⁷⁹ tregojnë shifra në rritje për përmasat e kësaj problematike në Shqipëri.

78 INSTAT. Dhuna në Familje në Shqipëri, Vërtetim kombëtar me bazë popullatën, nëntor 2013. fq. 9, 55, 56. Gjendet në: http://www.instat.gov.al/media/2618/dhuna_ne_familje_ne_shqiperi_2013.pdf

79 Lëviz Albania, Monitorimi i mekanizmit të referimit për rastet e dhunës në familje në nivel lokal, prill 2018. Gjendet në: <https://portavendore.al/wp-content/uploads/2018/05/“Monitorim-i-Mekanizmit-të-Referimit-për-rastet-e-Dhunës-në-Familje-në-nivel-lokal-aktivizëm-qytetar-për-përmirësimin-e-tij”.pdf>

KUADRI LIGJOR

Kuadri i brendshëm ligjor

Kuadri i Brendshëm Ligjor për Diskriminimin Gjinator në Shqipëri

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi miratuar në vitin 2010 dhe ndryshuar me Ligjin nr. 124/2020 parashikon forma të reja diskriminimi dhe pritet të formalizojë praktikën e Komisionerit për format e diskriminimit, të zgjerojë shkaqet e mbrojtura dhe të krijojë mundësi për ngritjen e problematikave nga OJF-të dhe Komisioneri lidhur me diskriminimin e strukturuar. Ligji shton përgjegjësinë e subjekteve publike dhe private jo vetëm lidhur me mosdiskriminimin, por edhe për promovimin e barazisë. Ligji përcakton themele ligjore të forta që garantojnë të drejtat e barazisë dhe mosdiskriminimit.

Ligji për Barazinë Gjimore u miratua në vitin 2008. Ky ligj rregullon çështjet themelore të problemeve të barazisë gjimore, duke kërkuar trajtim të barabartë të grave dhe burrave dhe mundësi dhe shanse të barabarta në ushtrimin e të drejtave të tyre në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Ligji e përkufizon “barazinë gjimore” si: pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në të gjitha fushat e jetës, status të barabartë midis grave dhe burrave, mundësi dhe shanse të barabarta për të gëzuar të drejta dhe për të përmbushur detyrimet në shoqëri dhe për të marrë përfitime të barabarta nga arritjet dhe zhvillimet e saj. Ligji e përkufizon “diskriminimin me bazë gjimore” (neni 4/3) si çdo dallim, përjashtim ose kufizim mbi baza gjimore, që ka për qëllim ose për pasojë dëmtimin, mosnjohjen, mosgëzimin dhe mosushtrimin, në mënyrë të barabartë, nga secila gjini, të të drejtave të njeriut dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje, në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile.

Kuadri i Brendshëm Ligjor për Dhunën në Familje, përfshirë Dhunën me bazë Gjimore

Ligji për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare u miratua nga Kuvendi në dhjetor 2016 dhe hyri në fuqi në qershor 2017. Ky ligj erdhi si nismë e organizatave të shoqërisë civile, të cilat mbledhën 20 mijë firma, çka e detyroi parlamentin ta marrë në shqyrtim dhe ta miratojë.

Qëllimi kryesor i ligjit është parandalimi dhe reduktimi i dhunës në familje në të gjitha format e saj, përmes masave të përshtatshme ligjore, si edhe garantimi i mbrojtjes për pjesëtarët e familjes që janë objekt i dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Objektivat kryesorë të ligjit janë:

- krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;
- orientimin e punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje;
- fuqizimin e sistemit gjyqësor për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje;
- sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit.

Ligji u ndryshua në vitin 2010, me qëllim përfshirjen e zotimit për ngritjen e një qendre kombëtare për shërbimet e kujdesit social ndaj viktimave të dhunës në familje. Gjithashtu, u vu theksi te konfidencialiteti i të dhënave personale dhe të informacionit të viktimës, duke rritur koordinimin dhe mekanizmat referues për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, si edhe përforcimin e urdhrave të mbrojtjes.

Ligji u ndryshua sërish në vitin 2018. Ndryshimet më të rëndësishme përfshijnë mënyrën se si organet ligjzbatuese dhe gjykatat duhet t'u përgjigjen denoncimeve për dhunë në familje. Ndryshimet legjislative kanë rritur rolin e strukturave vendore në drejtim të monitorimit dhe zbatimit të vendimeve gjyqësore. Pas këtyre ndryshimeve në ligj, oficerët e policisë duhet të kryejnë vlerësim risku pas identifikimit të viktimës, të raportojnë rastet e dhunës në familje në sistemin e mekanizmit të referimit pranë pushtetit vendor (bashki) dhe të lëshojnë urdhër paraprak mbrojtës. Këto urdhra paraprakë mbrojtës lejojnë policinë të largojë autorin e dhunës nga banesa para se gjykata të lëshojë urdhër mbrojtjeje. Ky është një mjet thelbësor që mundëson mbrojtje të përfortuar të viktimës gjatë intervalit kohor ndërmjet momentit të denoncimit dhe urdhrat të mbrojtjes që gjykata e lëshon më pas. Ndryshimi tjetër i rëndësishëm në këtë ligj është ndalimi i procedurës së pajtimit në gjykatë bazuar në rekomandimet e vlerësimit fillestar të Shqipërisë të realizuar nga GREVIO80 në vitin 2016. Ndryshimet e vitit 2018, kanë parashikuar se “familjarët” përfshijnë edhe personat në marrëdhënie intime. Megjithatë, këto ndryshime nuk përfshijnë mbrojtje për çiftet homoseksuale.

Ndryshimet ligjore që u miratuan në vitin 2020 përcaktojnë se gjykata mund të urdhërojë si masë mbrojtëse ndaj dhunës në familje largimin e menjëhershëm të autorit nga ambienti ku jeton, për një periudhë të caktuar kohore. Kjo risi e legjislacionit

80 Raport Fillestar Vlerësimi: Shqipëria: Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO). Këshilli i Evropës. 2016. Gjetendet në <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7>

shqiptar është në përputhje me nenin 52 të Konventës së Stambollit, i cili përcakton detyrimin për pajisjen e autoriteteve kompetente me kompetencën për të urdhëruar autorin e dhunës në familje të largohet nga vendbanimi i viktimës/personit në rrezik dhe t'i ndalojë autorit hyrjen në banesë ose kontaktimin e viktimës apo personit në rrezik, në rast se këtij të fundit i kanoset rrezik i menjëhershëm.

Në vitin 2012, **Kodi Penal** u ndryshua për të njohur dhunën në familje si vepër penale dhe ndëshkimin e saj me deri pesë vjet burg.⁸¹ Kodi Penal i ndryshuar parashikon se “Dhuna në familje, përfshirë rrahjen, kanosjen dhe plagosjen me dashje, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.”⁸²

Dhuna seksuale, e cila bie në kuadrin e dhunës në familje siç përcaktohet nga **Konventa e Stambollit**, nuk përfshihet në nenin 130/a dhe kriminalizohet në një dispozitë të veçantë të **nenit 102 të Kodit Penal për marrëdhëniet seksuale me dhunë**. Kjo dispozitë i referohet vetëm “kryerjes së marrëdhënieve seksuale me dhunë ... ndërmjet bashkëshortëve apo bashkëjetuesve” që dënohet me të njëjtin dënim si dhuna seksuale jashtë marrëdhënieve të partnerëve intimë. Aktet e dhunshme seksuale në sferën familjare janë objekt i procedimit privat njësoj si të gjitha aktet e dhunës seksuale.

Në vitin 2013, u miratua **Ligji nr. 144 datë 02.05.2013 që shtoi nenin 108/a në Kodin Penal** lidhur me ngacmimin seksual si “kryerje e sjelljeve me natyrë seksuale, që cenon dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet”.

Edhe **Përndjekja** u fut si vepër penale në Kodin Penal në vitin 2012.

Sipas **raportit të GREVIO⁸³ për Shqipërinë**, forma të tjera të dhunës ndaj grave, si martesë e detyruar, ngacmimi seksual dhe dhuna seksuale, kanë marrë pak vëmendje legislative dhe politike. Të dhënat e disponueshme në lidhje me këto forma të tjera të dhunës ndaj grave, sado të kufizuara, vërtetojnë nevojën për t'i trajtuar ato në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Kodi Penal ka disa nene për përdhunimin. Neni 102 përcakton dënim me 3-10 vjet për marrëdhëniet seksuale kundër dëshirës me gratë e rritura. Nëse kjo rezulton në pasoja të rënda për shëndetin e viktimës, dënimi rritet në 5-15 vjet burgim. Nëse vepra penale çon në vdekjen apo vetëvrasjen e viktimës, dënimi rritet në 10-20 vjet burgim. Neni 284 parashikon se pala e dëmtuar sipas pikës së parë të nenit 102 duhet

81 Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”. Gjetet në: <https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation/send/10-criminal-code/11-criminal-code-en>

82 Neni 130/a – Dhuna në familje, Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

83 GREVIO është organi i pavarur ekspert përgjegjës për monitorimin e zbatimit nga Palët të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

të depozitojë padi që të fillojë procedimi penal.

Nenet 100 dhe 101 kanë të bëjnë me marrëdhëniet me të mitur. Sipas nenit 100, marrëdhëniet me fëmijë të mitur që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç, ose më të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga 7 në 15 vjet. Sipas nenit 101, marrëdhënia seksuale me dhunë me një të mitur të moshës 14-18 vjeç dënohet me 5-10 vjet burgim. Kur marrëdhënia seksuale kryhet me dhunë në bashkëpunim me të tjerë apo më shumë se një herë, ose kur fëmijës së dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga 10 në 20 vjet. Kur vepra shkakton vdekjen apo vetëvrasjen e fëmijës së mitur, dënohet me burgim jo më pak se 20 vjet.

Në vitin 2013, një ndryshim në Kodin Penal futi si vepër penale përdhunimin bashkëshortor dhe dhunën seksuale bashkëshortore. Për përdhunimin e një të rrituri, dënimi me burg është nga tre deri në 10 vjet; për përdhunimin e një adoleshenti të moshës 14-18 vjeç, dënimi është nga pesë deri në 15 vjet; dhe për përdhunimin e një fëmije nën 14 vjeç, dënimi është shtatë deri në 15 vjet. Kodi Penal përfshin dispozita për sulmin seksual dhe ngacmimin seksual dhe e bën të qartë kriminalizimin e përdhunimit bashkëshortor.

Kodi i Familjes i Shqipërisë përmban disa nene për dhunën në familje ndaj bashkëshortes(it) dhe fëmijëve. Kodi i Familjes adreson detyrimet prindërore dhe të drejtat e fëmijëve në jetën familjare, si edhe abuzimin dhe neglizhimin e fëmijëve. Neni 62 parashikon se “largimin e bashkëshortit që ushtron dhunë nga banesa bashkëshortore”.

Ligji “Për shëndetin riprodhues” përcakton se çdo grua duhet të vendosë vetë - me vullnet të lirë dhe pa asnjë formë diskriminimi, presioni apo dhune – për të gjitha çështjet që lidhen me seksualitetin e saj dhe me shëndetin seksual dhe riprodhues.

Standardet Ndërkombëtare për Të Drejtat e Grave dhe DhBGj

Këshilli Ministror i OSBE-së miratoi Vendimin nr. 4/18 për “Parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave” (Shqipëria u bë vend pjesëmarrës i OSBE-së gjatë punimeve të Këshillit Ministror të Berlinit në qershor 1991).

Duke njohur progresin dhe boshllëqet ekzistuese në fushën e parandalimit dhe luftës kundër dhunës ndaj grave dhe rëndësinë e garantimit të gëzimit të plotë dhe të barabartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga gratë dhe vajzat, vendimi u kërkon shteteve të marrin masa për çështjet e mëposhtme:

- aksesin në drejtësi
- edukimin për barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut

- trajtimi i formave specifike të dhunës me të cilat përballen gratë dhe vajzat, përfshirë teknologjitë dixhitale
- lufta kundër ngacmimit seksual në ambientet publike dhe private
- akses i barabartë në arsim cilësor për të gjitha vajzat
- përfshirja e shoqërisë civile në parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave.

Pakti për Të Drejtat Civile dhe Politike të OKB-së (ICCPR) është traktat ndërkombëtar për të të drejtat e njeriut miratuar nga Kombet e Bashkuara (OKB) në vitin 1966. Shqipëria mban status aderimi që nga 4 tetori 1991. Ky është një prej dy traktateve që i jep fuqi juridike **Deklaratës Universale për Të Drejtat e Njeriut** (tjetra është Pakti Ndërkombëtar për Të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore - ICESCR). Gazetarët që lexojnë këtë udhëzues mund ta dinë që të drejtat e ICCPR-së janë thelbësore që qytetarët të gëzojnë një sërë të drejtash të njeriut, përfshirë ato që lidhen me:

- liria kundër torturës dhe trajtimeve dhe ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore apo poshtëruese
- liria kundër skllavërisë dhe punës së detyruar
- trajtimi në proces gjyqësor
- jeta private, shtëpia dhe jeta familjare
- martesë dhe të drejtat e fëmijëve
- barazia dhe mosdiskriminimi, etj.

Pakti Ndërkombëtar për Të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore i OKB-së (ICESCR) është një prej traktateve më të rëndësishme për të drejtat e njeriut të OKB-së. Shqipëria mban status aderimi që nga 4 tetori 1991. Ky është një prej dy traktateve që i jep fuqi juridike Deklaratës Universale për Të Drejtat e Njeriut (tjetra është Pakti Ndërkombëtar për Të Drejtat Civile dhe Politike – ICCPR).

Konventa e OKB-së për Të Drejtat e Fëmijës (KDF) është traktat ndërkombëtar që përcakton të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të të gjithë fëmijëve. Me ratifikimin e saj më 27 shkurt 1992, Shqipëria ra dakord që organet publike duhet të marrin parasysh interesin më të lartë të fëmijës kur bëjnë çdo gjë që prek fëmijët. KDF mbron të drejtat e fëmijëve në të gjitha fushat e jetës së tyre, duke përfshirë të drejtat më poshtë:

- e drejta e shprehjes së lirë të mendimeve dhe e dëgjimit në procese ligjore që i prekin
- jeta private
- liria kundër dhunës, abuzimit dhe neglizhimit
- shëndeti

- standard jetese adekuat
- arsimim
- liria kundër shfrytëzimit ekonomik dhe seksual, si edhe trajtimi me dinjitet dhe respekt brenda sistemit gjyqësor penal.

Shqipëria mban status aderimi në **Konventën e OKB-së kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Poshtëruese** (KKT) që nga 11 maji 1994. Konventa e bën të qartë se tortura nuk justifikohet në asnjë rrethanë. Shtetet që nënshkruajnë traktatin duhet të veprojnë për të parandaluar dhe hetuar torturën dhe për të ndëshkuar këdo që e kryen atë. Shtetet duhet edhe të sigurojnë që çdo viktimë e torturës (ose familjarët e ngushtë nëse viktima vdes) të marrë kompensim adekuat, duke përfshirë mbështetjen për rehabilitim. Me ratifikimin e Konventës, Shqipëria pranon të parandalojë aktet e torturës në lidhje me aktivitetet që përfshijnë:

- kthimin, dëbimin apo ekstradimin e dikujt në një tjetër shtet ku ekzistojnë baza reale për të besuar se ai/ajo do të përballet me torturë
- arrestimin, ndalimin dhe burgimin
- marrjen në pyetje, si dhe lidhur me trajnimin e policisë (civile apo ushtarake), personelit mjekësor, zyrtarëve publike dhe kujtdo që mund të përfshihet në arrestimin, ndalimin dhe marrjen në pyetje të një personi.

Konventa e OKB-së për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) është traktati ndërkombëtar i të drejtave të njeriut që fokusohet veçanërisht te barazia midis grave dhe burrave në të gjitha fushat e jetës. Shqipëria ka status aderimi që nga 11 maji 1994. Shpesh quhet edhe “karta e të drejtave të grave”. CEDAW ofron bazën për ta bërë realitet barazinë midis grave dhe burrave. Ratifikimi i konventës tregoi përkushtimin e shtetit shqiptar për të promovuar tërësisht të drejtat e grave dhe të burrave.⁸⁴ Komiteti rekomandoi që Shqipëria të promovojë barazi thelbësore për pozicionet në jetën politike dhe publike, duke monitoruar zbatimin e masave të veçanta të përkohshme të parashikuara në ligjin “Për barazinë gjinore” në lidhje me pjesëmarrjen e grave në organet vendimmarrëse në nivel qendror dhe vendor, si në sektorin publik edhe atë privat, për të përmbushur objektivat e përcaktuara në ligj.

Shqipëria e ratifikoi **Konventën Evropiane për Mbrojtjen e Të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore** më 2 tetor 1996, si edhe Protokollet e kësaj Konvente⁸⁵

84 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, *Konventa për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave*, 18 dhjetor 1979, Kombet e Bashkuara, Serbia e Traktateve, vëll. 1249, fq. 13, Preambulë. Gjetet në: <https://www.refworld.org/docid/3ae6b3970.html>

85 Këshilli i Evropës, *Konventa për Mbrojtjen e Të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore*, 4 nëntor 1950, Europ.T.S. No. 5; 213 U.N.T.S.221. Gjetet në: https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list//conventions/treaty/005/declarations?p_auth=13Q66ql5&coeconventions_WAR_coeconventionsportlet_enVigueur=false&coeconventions_WAR_coeconventionsportlet_searchBy=state&coeconventions_WAR

(ratifikuar me deklarata, rezerva dhe/ose derogime).

Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (KKT), të cilën Shqipëria e ratifikoi më 2 tetor 1996, e bën të qartë se tortura është e pajustifikueshme në çfarëdo rrethane.

Shtetet që nënshkruajnë traktatin duhet të veprojnë për të parandaluar dhe hetuar torturën dhe për të ndëshkuar këdo që e kryen atë. Shtetet duhet edhe të sigurojnë që çdo viktimë e torturës (ose familjarët e ngushtë nëse viktima vdes) të marrë kompensim adekuat, duke përfshirë mbështetjen për rehabilitimin.

Me ratifikimin e Konventës, Shqipëria pranon të parandalojë aktet e torturës në lidhje me aktivitetet që përfshijnë:

- kthimin, dëbimin apo ekstradimin e dikujt në një tjetër shtet ku ekzistojnë baza reale për të besuar se ai/ajo do të përballet me torturë
- arrestimin, ndalimin dhe burgimin
- marrjen në pyetje, si dhe lidhur me trajnimin e policisë (civile apo ushtarake), personelit mjekësor, zyrtarëve publike dhe kujtdo që mund të përfshihet në arrestimin, ndalimin dhe marrjen në pyetje të një personi.

Shqipëria e ratifikoi **Konventën Evropiane për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje** më 4 shkurt 2013. **Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)** është një konventë e Këshillit të Evropës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e cila u hap për nënshkrim më 11 maj 2011, në Stamboll të Turqisë. Konventa synon parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimës dhe “dhënien fund të pandëshkueshmërisë së dhunuesve”. Shqipëria ishte vendi i dytë që e ratifikoi Konventën, më 4 shkurt 2013. Konventa hyri në fuqi më 1 gusht 2014.

Një prej veçorive dalluese të Konventës është këmbëngulja e saj në një përjasje tërësore shumëdimensionale që përfshin parandalimin, përkrahjen, procedimin dhe politikën e integruara (4 P-të), me qëllim që të garantohet çrrënjësia e suksesshme e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe premisën e saj të shprehur qartë se dhuna ndaj grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabartë të fuqisë ndërmjet grave dhe burrave. Konventa vendos format e shumta të dhunës ndaj grave që variojnë nga gjymtimi femëror gjenital deri te dhuna në familje, nën parullën e “dhunës me bazë gjinore ndaj grave” që thekson pabarazinë gjinore si shkakun e përbashkët strukturor të këtyre formave, si edhe u kërkon shteteve përgjigje tërësore në luftën kundër të gjitha këtyre formave të manifestimit të fuqisë së pabarabartë mes grave dhe burrave.⁸⁶

[coeconventionsportlet_codePays=ALB&_coeconventions_WAR_coeconventionsportlet_codeNature=10](#)

86 Këshilli i Evropës, Raporti i parë i Përgjithshëm për Aktivitetet e GREVIO-s për periudhën qershor 2015 – maj 2019. Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), 2019. Gjetendet në: <https://rm.coe.int/1st-general-report-on-grevio-s-activities/16809cd382>

Neni 6 i Konventës së Stambollit të cilën Shqipëria e ratifikoi në vitin 2014 kërkon integrimin e perspektivës gjinore në hartimin e masave për zbatimin e Konventës dhe në vlerësimin e ndikimit të saj. Nga ana tjetër, ky nen u bën thirrje shteteve palë të promovojnë dhe të zbatojnë politika që synojnë barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.⁸⁷ Politikat me ndjeshmëri gjinore duhet të synojnë barazinë si de jure ashtu edhe de facto mes grave dhe burrave. Këto politika bazohen në parimin se pabarazia gjinore është sa pasojë aq edhe shkak rrënjësor i dhunës ndaj grave. Detyrimet e përcaktuara në nenin 6 të Konventës përforcojnë nenin 4, pika 2 që dënon dhe ndalon diskriminimin. “Palët dënojnë të gjitha format e diskriminimit ndaj grave dhe marrin pa vonesa masat e nevojshme legislative dhe të tjera për ta parandaluar, në veçanti:

- mishërimin e parimit të barazisë mes grave dhe burrave në kushtetutat kombëtare apo në legjislacion tjetër të përshtatshëm, si edhe garantimin e realizimit në praktikë të këtij parimi;
- ndalimin e diskriminimit ndaj grave, përfshirë përmes përdorimit të sanksioneve sipas rastit;
- shfuqizimin e ligjeve dhe praktikave që diskriminojnë gratë.⁸⁸

Neni 2, pika 3 garanton të drejtat e viktimave pa diskriminim mbi baza seksi, gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, opinionin politik apo tjetër, prejardhjes kombëtare apo shoqërore, përkatësisë në një pakicë kombëtare, prone, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetëore, aftësie të kufizuar, statusi martesor, statusi emigranti apo statusi refugjati, apo status tjetër.

Neni 2, pika 2 e Konventës së Stambollit inkurajon palët ta zbatojnë Konventën edhe për dhunën në familje të kryer ndaj burrave dhe fëmijëve. Prandaj, u takon palëve të vendosin nëse do ta shtrijnë zbatueshmërinë e Konventës edhe për këto viktima. Megjithatë, Konventa u kërkon qartë palëve t'u kushtojnë vëmendje të veçantë grave viktimave të kësaj forme dhune, sepse ato preken në mënyrë joproporcionale. Konventa e Stambollit shprehimisht njëse se dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave duhet të kuptohen si fenomen gjinor, kjo sepse marrëdhëniet historikisht të pabarabarta midis grave dhe burrave kanë çuar në dominimin e burrave mbi gratë dhe janë ndër shkaqet kryesore të dhunës ndaj grave.

Axhenda për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm e Shteteve Anëtare të OKB-së u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë më 4 dhjetor 2017. Në këtë Rezolutë, Kuvendi nënvizoi se paqja dhe siguria, demokracia dhe shteti i së drejtës, eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit, fuqizimi i grave, angazhimi i brezave të rinj dhe e fundit por jo nga rëndësia, qeverisja e mirë, janë parakushte thelbësore për të garantuar evoluimin e pakthyeshëm drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

87 Këshilli i Evropës, Konventa për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (CETS, nr. 2010). Relacioni Shpjegues, pikat 61-62.

88 Këshilli i Evropës, Konventa për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje. Stamboll, 11.05.2011. Gjendet në: <https://rm.coe.int/168008482e>

Praktikat më të mira të IKDNj-ve në monitorimin e të drejtave të grave dhe DhBGj

Viti 2020 ka qenë një vit i vështirë, ku u deshën planifikime dhe përshtatje nga të gjitha shtresat e shoqërisë, përfshirë Avokatin e Popullit (AP) dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD). Puna e institucioneve u prek nga mungesa e personelit për shkak të COVID-19, problematikat teknike për shkak të kombinimit të punës në zyrë dhe online, si dhe masat kufizuese dhe vështirësitë praktike për të respektuar kërkesat administrative. Pavarësisht këtyre sfidave, në të gjitha nismat dhe aktivitetet ndjekëse, AP dhe KMD kanë vazhduar të punojnë drejt garantimit të standardeve më të larta të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe krijimit të kushteve të duhura për gëzimin real të tyre. Ndërkohë, Institucioni reflektoi thellësisht mbi domosdoshmërinë e ruajtjes së ekuilibrit të duhur mes dy interesave të larta: respektimit të të drejtave të qytetarëve nga njëra anë dhe mbrojtjes së shëndetit publik nga ana tjetër.

Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (IKDNj) dhe institucionet shtetërore do të arrijnë të ofrojnë raportim bazuar në evidenca, avokim dhe dialog politikash të mbështetur në të dhëna me fokus të drejtat e njeriut, falë nënshkrimit në shtator 2020 të një Memorandumi Mirëkuptimi ndërmjet Avokatit të Popullit dhe Instituti i Statistikave (INSTAT), i lehtësuar nga Fondi i OKB-së për Popullsinë (UNFPA) në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), me qëllimin për të përmirësuar sistemin e mbledhjes së të dhënave DocuLive.

Në vitin 2020, nëpërmjet kontributit në arritjen e synimeve 10.3, 16.3 dhe 16.a të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), Programi për Zhvillim i OKB-s (UNDP) dhe Fondi Ndërkombëtar i Emergjencave për Fëmijët i OKB-së (UNICEF) hodhën bazat e forta për një bashkëpunim efektiv institucional me Avokatin e Popullit dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të përmirësuar aksesin në drejtësi për grupet e vulnerabël dhe të marginalizuara, përmes sa vijon:

- KMD ka rritur shtrirjen e vet ndaj grupeve vulnerabël, si klientë të shërbimeve të ofruara sipas ligjeve të brendshme, veçanërisht në zonat e largëta, për të trajtuar sfidat ndaj aksesit të barabartë dhe të papenguar në shërbimet bazë.
- AP është mbështetur në ofrimin e mjeteve juridike dhe respektimin e standardeve të të drejtave të njeriut dhe konsideratat gjinore përmes hartimit dhe zbatimit të një plani pune për të mbështetur: (i) forcimin e dialogut me administratën publike në garantimin e zbatimit të rekomandimeve të AP; (ii) arritjen te komunitetet vulnerabël, me fokus të posaçëm te gratë, personat me aftësi të kufizuara, romët dhe egjiptianët dhe LGBTI që të inkurajohen t'i drejtohen Avokatit të Popullit për të rivendosur të drejtat e shkelura të njeriut të grave dhe burrave; (iii) dhe forcimin e kuadrit të politikave në luftimin e të gjitha formave të ngacmimit seksual dhe joseksual në administratën publike.

Sipas Raportit të gjashtë të ECRI-t për Shqipërinë, është krijuar një marrëdhënie shumë efektive dhe kolegjinale mes dy institucioneve (AP dhe KMD), të cilat përforcojnë mandatin, kapacitetet dhe ekspertizën e njëra-tjetrës. Janë hapur 10 zyra vendore/

rajonale (7 nga AP dhe 3 nga KMD) dhe të gjitha mund të shfrytëzohen për të depozituar ankesa me secilin institucion, me qëllim promovimin e aksesit më të mirë në të dy autoritetet e pavarura.⁸⁹

Institucioni i Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit është një nga institucionet më të rëndësishme të të drejtave të njeriut i krijuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Krijimi i këtij institucioni u arrit përmes dispozitës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, miratuar me referendum në vitin 1998. Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin organik “Për Avokatin e Popullit” në vitin 1999, duke e afirmuar institucionin e Avokatit të Popullit si një garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave legjitime të individit, shtetasve shqiptarë, të huajve, rezidentëve të rregullt ose të parregullt në Shqipëri, refugjatëve si dhe personave pa shtetësi që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike.

Në pajtim me Parimet e Parisit,⁹⁰ Avokatit të Popullit iu caktua një mandat i gjerë, bazuar në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, për promovimin, parandalimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Gjatë vitit 2018, Avokati i Popullit i ka drejtuar 14 rekomandime Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nga të cilat 50% (7 rekomandime) u refuzuan nga ky institucion, 6 u pranuan dhe u zbatuan ndërsa 1 ende nuk është zbatuar.

Raporti Vjetor 2019 konstaton se Ministria e Drejtësisë ende nuk ka miratuar krijimin e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Mbetet domosdoshmëri ngritja e këtyre qendrave në disa qytete të vendit, duke mbajtur parasysh zgjerimin sipas shpërndarjes gjeografike për ofrimin e shërbimeve sa më afër komunitetit.

Lidhur me ankesat e regjistruara nga AP në vitin 2019, janë paraqitur 40 të tilla nga qytetarët për ndërprerjen e asistencës ekonomike, mospërfitimin dhe përjashtimin e qytetarëve nga skemat e asistencës ekonomike dhe vlerën e ulët të saj. Sipas raportit, ndihma ekonomike është e pamjaftueshme për të përballuar nevojat e grupeve në nevojë në tërësi dhe veçanërisht ato të grave kryefamiljare, grave rome apo atyre nga grupe të tjera vulnerabël, si dhe sidomos të viktimave të dhunës në familje apo viktima të trafikimit të qenieve njerëzore. Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson

89 Këshilli i Evropës, Rekomandimi nr. 2 i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t, Organet e Barazisë në luftën kundër racizmit dhe intolerancës në nivel kombëtar, shkurt 2018, pika 40 a-b. Gjetet në: 16808b5a23 (coe.int)

90 Angazhimi i OKB-së për ngritjen e institucioneve kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut e ka filluesën në vitin 1946 dhe vlerësoi si shumë të rëndësishëm seminarin e organizuar nga Asambleja e Përgjithshme të OKB-së në tetor 1991, në Paris. Në këtë aktivitet u përcaktuan disa parime për rritjen e efektivitetit të punës së institucioneve kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, njohur ndryshe edhe si Parimet e Parisit. Parimet shërbejnë si model (i pranuar prej Shteteve Anëtare) për ngritjen dhe funksionimin e këtyre institucioneve.

se gjendja aktuale (2019) e të drejtave dhe lirive të grave dhe vajzave në Shqipëri, karakterizohet nga problematika të mprehta, sidomos në drejtim të përdorimit të gjuhës misogjene të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, aksesit në drejtësi, punësimit dhe ofrimit të shërbimeve sociale. Nga perspektiva e institucionit të Avokatit të Popullit, konstatohet se problematikën më të spikatura të shprehura në përmbajtjen e ankesave të depozituara dhe të shqyrtuara për vitin 2019 për gratë, konsistojnë në pretendime për punësim, ndihmë ekonomike, pension, akses në drejtësi, mosekzekutim të detyrimeve ushqimore të vendosura në vendimet e gjykatave, etj.

Një problem lehtësisht i evidentueshëm është përdorimi i gjuhës misogjene nga deputetët apo në biseda në studio televizive ose në shkrime të botuara në shtypin shqiptar dhe në mediat sociale. Misogjenia është më e evidente ndaj grave në karrierë.

Për sa i përket tematikës, gjatë periudhës 2016-2019, AP ka trajtuar 17 ankesa nga gratë për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për detyrimet ushqimore nga ish-bashkëshortët; 11 ankesa për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për kryerjen e një veprimi; 3 ankesa për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për kujdestarinë e fëmijës; 10 ankesa për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për përgjegjësinë monetare të Shtetit apo subjekteve private; 2 ankesa për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për pjesëtim pasurie; si dhe 8 ankesa ndaj veprimeve të përmbaruesve gjyqësorë për ekzekutimin e përmbushjes së detyrimeve në favor të grave apo vajzave.

Në “Raportin Alternativ mbi Zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri për periudhën 2016-2020”, AP i rekomandon Ministrisë së Drejtësisë që të alokojë fonde të mjaftueshme për organizatat jofitimprurëse (OJF) që ofrojnë ndihmë juridike parësore. Në këtë raport, AP shpreh shqetësimin e për numrin e ulët të denoncimeve të fenomenit të dhunës me bazë gjinore (DhBGj) në dëm të grave në zona të largëta apo rurale, për shkak të mentalitetit dhe zhvillimit kulturor në këto zona, mungesës së informacionit në lidhje me shërbimet ku mund të drejtohen, mungesës së shërbimeve ligjore falas apo mungesës së mekanizmave të referimit të dhunës në këto zona.

Niveli i ulët i denoncimeve vjen edhe për shkak se një pjesë e kërkesave të viktimave të DhBGj-së nuk trajtohen me respekt dhe profesionalizëm nga ana e nëpunësve përgjegjës në nivel lokal dhe qendror dhe mungon sanksionimi civil dhe/ose penal i tyre në rast të mostrajtitimit sipas ligjit të kërkesave të viktimave. Gjithashtu, strukturat e policisë në një pjesë të rasteve vazhdojnë ta trajtojnë DhBGj-në si çështje të domenit privat, duke shmangur ndërhyrjen efektive të tyre në rastet e denoncuar dhe orientuar zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjes mes anëtarëve të familjes. Lidhur me gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, Komiteti për Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar e cilëson shqetësuese mungesën e mjeteve efektive për rivendosjen e të drejtave të tyre si kompensimi, rehabilitimi apo ri-integrimi social.⁹¹

91 Shih: Vëzhgimet Përmblyëse për raportin fillestar të Shqipërisë, Komitetit për Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, 14 tetor 2019, pika 31. Gjendet në: <http://docstore.ohchr.org/SelfServices/FilesHandler>.

Veçanërisht në dy vitet e fundit, Avokati i Popullit e ka bërë gjuhën e urrejtjes një tematikë të spikatur në raportin vjetor të fundit.

E fundit por jo nga rëndësia, personi i Avokatit të Popullit po harton një raport paralel për viktimat e dhunës në familje që të gëzojnë urdhrat e mbrojtjes dhe ndihmën ekonomike.

Sipas përgjigjeve të mbledhura nga pyetësi i vlerësimit të nevojave për rsonelin e Avokatit të Popullit⁹², ata u shprehën se vizitat në terren janë instrumenti kryesor për mbledhjen e të dhënave, monitorimin dhe raportimin, pasuar nga ankesat individuale dhe raportimet në media. Shumica e të anketuarve besojnë se nevojiten modele intervistash të përshtatura sipas kategorisë së personit të intervistuar si dhe pyetësorë të përshtatur sipas problematikave të të drejtave të njeriut / diskriminimit.

Bazuar në të dhënat statistikore të përgjigjeve, gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi i grave dhe DhBGj shihen si fusha prioritare që kërkojnë më shumë ndërhyrje dhe monitorim. Gjithashtu, personeli i Avokatit të Popullit vlerëson se trajnimet për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e statistikave janë shumë të dobishme me qëllim mbledhjen dhe raportimin e statistikave të sakta.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Bazuar në Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) është autoriteti përgjegjës që garanton mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo lloj forme sjelljeje që nxit diskriminimin.

Gjatë vitit 2018, KMD inicioi 8 raste kryesisht pas marrjes së informacioneve të besueshme nga organizatat që punojnë në fushën e diskriminimit duke u dhënë ndihmë juridike falas personave në nevojë në fushën e shërbimeve, ofrimin e shërbimeve dhe mbrojtjes për personat me aftësi të kufizuara, si edhe nga organizatat që mbrojnë të drejtat e fëmijëve për arsimim.

KMD ka trajtuar mjaft ankesa për gjuhën e urrejtjes në vitet e fundit, me 112 raste të tilla në total gjatë periudhës 2015-2018. Në 4 raste, KMD konkludoi se gjuha e përdorur tejkalohte masën e mbrojtur nga liria e shprehjes dhe konstatoi se është përdorur gjuha e urrejtjes.

Me qëllim forcimin e përgjigjes së ligjit penal ndaj gjuhës së urrejtjes, autoritetet bashkërisht me KMD dhe në bashkëpunim me Policinë e Shtetit organizuan trajnime për efektivet në nivel rrethi, konkretisht 19 trajnime në 12 qarqe të Shqipërisë ku morën pjesë 471 efektive nga drejtoritë e policisë vendore. Trajnimet trajtuan jo

ashx?enc= 6QkG1d%2FPPrICAqhKb7yhs pdJq2SN0F ynLS%2BUiEUa qofjmf0rHJ5MLËvzpC5ePiublk65eO Kd%2FNGE6rLëV%2B8UH2qH Aë2phpnAZHHFM FuZ bruUZnIN muu8vËËy5fRM tguz

92 Prezenca e OSBE-së në Shqipëri: Vlerësimi i Nevojave për Institucionet Kombëtare të Të Drejtave të Njeriut në Shqipëri, Mauro Puzzo dhe Albana Gërxi, qershor 2021.

vetëm gjuhën e urrejtjes, por edhe masat kundër diskriminimit në përgjithësi, përfshirë punën e KMD-së dhe aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, posaçërisht për situatën e komunitetit LGBTIQ.⁹³

Në vitin 2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori gjithsej 239 vendime dhe paraqiti 2 rekomandime për raste kryesisht (fokusuar në një grup specifik) nga të cilat 232 vendime ishin për ankesa individuale dhe 7 vendime me gjobë.

Në vitin 2019, KMD trajtoi 225 raste (215 ankesa dhe 10 raste kryesisht), nga të cilat 2015 raste bazuar në ankesa. Këto ankesa u depozituan më së shumti nga organizatat me interes të ligjshëm në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, komunitetit rom/egjiptian, aftësisë së kufizuar, etj. Në disa raste, informacionet e dhëna nga organizatat e shoqërisë civile dhe media kanë shërbyer si indicie apo informacion për Komisionerin që të fillojë shqyrtimin e rasteve.

Gjatë këtij viti, KMD trajtoi 14 raste (12 ankesa dhe 2 raste kryesisht) për gjuhën e urrejtje, shumica e të cilave lidheshin me përkatësinë LGBTI dhe komunitetin rom dhe egjiptian.

Në fund të procesit të shqyrtimit të rasteve më lart, në 3 raste Komisioneri konstatoi diskriminim të ankuesve.

Në 6-mujorin e parë të vitit 2021, KMD trajtoi 200 raste (180 ankesa dhe 20 raste kryesisht). Gjatë kësaj periudhe, Komisioneri është shprehur me 1 vendim për arritjen e efektivitetit. Objekti i ankesës në fjalë lidhej me faktin se një studente nuk ishte pranuar në shkollë për shkak se mbante perçe. Pas ndërmjetësimit me KMD, u krijuan kushtet që vajza të ndiqte mësimin si të gjithë studentët e tjerë.

Në 6-mujorin e parë të vitit 2021, Komisioni miratoi 10 vendime bazë për ankesat /rastet kryesisht ku pretendohet diskriminim me bazë gjinore, si edhe ka trajtuar 9 ankesa dhe 3 raste kryesisht që kishin të bënin me gjuhën e urrejtjes. 5 ankesa trajtonin gjuhën e urrejtjes me bazë racore, ndërsa 7 ankesa lidheshin me gjuhën e urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI.

Në kontekstin e fushatës zgjedhore të prillit 2021, KMD në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nxori një rekomandim të përbashkët që theksonte nevojën dhe detyrimin e partive politike dhe medias që të respektonin parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit. Më konkretisht, rekomandohet që: partitë politike dhe media të shqyrtojnë mundësinë e miratimit ose të bazohen te Kodet e Sjelljes gjatë Fushatës Zgjedhore që përmbajnë rregulla për diskriminimin, ngacmimin dhe gjuhën e urrejtjes; partitë politike, kandidatët si edhe personat që punojnë për ta, të refuzojnë ndër të tjera edhe përdorimin e gjuhës diskriminuese në programet politike dhe fushatat zgjedhore, të mos mbështetin dhe të dënojnë shprehimisht idetë apo teoritë e superioritetit të një grupi njerëzish mbi baza racore, përkatësie etnike, feje, gjinie, moshe, orientimi seksual, identiteti gjinor, aftësie të kufizuar dhe veçorive të tjera të mbrojtura apo kombinim të tyre; media të refuzojë

93 Këshilli i Evropës, Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (cikli i gjashtë monitorues). Miratuar më 7 prill 2020.

Gjendet në: <https://rm.coe.int/report-on-albania-6th-monitoring-cycle-/16809e8241>

përdorimin apo mbështetjen e gjuhës së urrejtjes, gjatë përcjelljes së fushatave zgjedhore; përbërja e listës së kandidatëve të partive politike të pasqyrojë diversitetin e njerëzve në shoqëri, etj.

Gjatë vitit 2021, KMD bëri disa rekomandime lidhur me matricën e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030.

KMD ka bërë propozime lidhur me masa si “Informimi veçanërisht i grave dhe vajzave nga zonat urbane dhe rurale, mbi legjislacionin e përmirësuar në lidhje me të drejtat pronësore të tyre, me fokus të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore”.

Lidhur me masën “Shtimi i kurseve që ofrohen në Qendrat e Formimit Profesional të përshtatura me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës”, KMD propozoi shtimin e një moduli specifik që trajton pjesën e diskriminimit gjinor dhe mbrojtjen ligjore të garantuar me ligj, në mënyrë që gratë dhe vajzat të informohen paraprakisht lidhur me to, pra, ende pa hyrë në tregun e punës.

KMD dhe UN Women realizuan një studim për përfaqësimin e grave në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore. Qëllimi i studimit ishte të paraqiste panormaën e konfigurimit gjinor në përbërjen e organeve të zgjedhura të qeverisjes vendore.

Sipas përgjigjeve të mbledhura nga pyetësi i vlerësimit të nevojave për personelin e KMD-së se me cilat burime të mëposhtme duhet të përmirësojë bashkëpunimin institucioni i tyre për të forcuar monitorimin, mbledhjen e të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit, pjesa më e madhe e përgjigjeve shkojnë tek organet e qeverisjes vendore. Personeli thekson se ka mungesë trajnimi mbi teknikat e intervistimit dhe sfidat në përshtatjen e intervistës sipas karakteristikave personale të të intervistuarit (p.sh. gjinia, moshë, feja, raca, përkatësia etnike).

Bazuar në të njëjtat përgjigje, personeli ka identifikuar se modelet e intervistave të përshtatura për kategorinë e personave që intervistohen janë të dobishme për të kryer më mirë mbledhjen e të dhënave dhe raportimin mbi çështjet e diskriminimit, si edhe që kanë nevojë për trajnim mbi konsideratat etike (p.sh. mosdëmtimi, pëlqimi i informuar, konfidencialiteti). Shumica e personelit rekomandon se diskriminimi ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore është një prej problematikave që meriton monitorim të shtuar nga KMD dhe evidenton nevojën për trajnim mbi çështjet e krimeve të urrejtjes dhe të gjuhës së urrejtjes.

Sipas përgjigjeve të mbledhura nga pyetësi, dy burimet kryesore nga të cilat KMD mbështetet për monitorimin, mbledhjen e të dhënave dhe raportimin e rasteve të diskriminimit janë ankesat apo peticionet drejtuar institucionit, si edhe ankesat, deklaratat apo raportet monitoruese të organizatave të shoqërisë civile.

Personeli i KMD-së evidentoi disa shembujt dhe praktika të mira që institucioni përdor për monitorimin dhe raportimin e rasteve të diskriminimit. Këtu përmendim monitorimin e situatës lidhur me barazinë gjinore, personat me aftësi të kufizuara, përfshirë modifikimin e arsyeshëm të infrastrukturës fizike, rastin e monitorimit të përdorimit të gjuhës së urrejtjes në fushatë zgjedhore, llojin e fjalorit që mund të

përdoret nga forcat politike që konkurrojnë me njëra-tjetrën dhe bashkëpunimet me institucione të tjera, përfshirë raportimin mbi bazë evidencash që është monitoruar nga KMD dhe OJF të ndryshme.

Monitorimi i Diskriminimit ndaj Grave dhe DhBGj

Si Avokati i Popullit edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Shqipëri kanë kapacitetet që monitorimin e diskriminimit të grave dhe dhunës me bazë gjinore (DhBGj) ta mbështetin në një përjasje bazuar në të drejtat e njeriut, sipas roleve dhe përgjegjësiwe ekzistuese të përcaktuar tashmë. Këto dy institucione i kanë kapacitetet të ofrojnë një panoramë të qartë se çfarë po ndodh, bazuar në evidenca reale.

Qëllimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut është para së gjithash të sigurojë krijimin ose forcimin e një kuadri mbrojtës, të identifikojë dhe të hetojë abuzimet e të drejtave të njeriut, të sjellë para drejtësisë përgjegjësit për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të sigurojë mjete juridike dhe dëshmipërblime efektive për viktimat, brenda një kuadri strukturor politikash, ligjesh dhe programesh që siguron parandalimin dhe zbatimin.

Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë dy institucione që punojnë drejtpërdrejt me të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Roli i tyre është thelbësor në promovimin e të drejtave të njeriut dhe në forcimin e shtetit të së drejtës.

Të dyja këto institucione munden të garantojnë zbatimin e normave ndërkombëtare dhe të brendshme lidhur me të drejtat e njeriut. Mekanizmat administrativë në dispozicion të të dy institucioneve synojnë t'i japin efekt detyrimit të përgjithshëm për hetimin e shkeljeve të pretenduara në mënyrë të shpejtë, të plotë dhe efektive, bazuar në faktin se janë organe të pavarura dhe të paanshme.

Për këtë qëllim, Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) ka paraqitur një rekomandim për autoritetet shqiptare që të krijojnë një proces monitorimi tërësor për incidentet e gjuhës së urrejtjes dhe të punojnë ngushtësisht me AP, KMD, prokurorinë, policinë dhe OJF-të përkatëse.

Me monitorim nënkuptojnë mbledhjen, verifikimin dhe përdorimin e informacionit për të adresuar çështjet e të drejtave të njeriut. Monitorimi i të drejtave të njeriut përfshin mbledhjen e informacionit rreth incidenteve, vëzhgimin e ngjarjeve, vizita në terren, diskutimet me autoritetet kombëtare për të marrë informacion dhe për të realizuar mjetet juridike dhe masa të tjera ndjekëse të menjëhershme. Monitorimi zakonisht kryhet gjatë një periudhe kohore.

Ekziston një korpus i konsiderueshëm dhe në rritje i detyrimeve, ligjeve dhe normave të Shtetit që lidhen me të drejtat e barazisë së grave dhe vajzave. Megjithëse burimet kryesore ligjore të këtyre të drejtave janë Konventa e Stambollit dhe CEDAW, ka edhe instrumente të tjera që përmbajnë garanci bazë të barazisë, si Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) dhe një sërë instrumentesh të Organizatës Ndërkombëtare të Punës

(ILO) që përcaktojnë të drejtat e grave dhe vajzave.

Për IKDNj-të, të drejtat e njeriut të grave përfshin jo vetëm standardet ligjore, por edhe monitorimin e efektit që u jepet dispozitave ligjore të cilat përmbajnë treguesit e progresit.

Institucioni mund të hartojë një instrument vlerësimi në mënyrë që të identifikojë nëse janë përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve në zbatimin e barazisë gjinore dhe integritetit gjinor.

Sipas Parimeve të Parisit,⁹⁴ institucioni i Avokatit të Popullit ka përgjegjësinë që të këshillojë Qeverinë, Parlamentin dhe çdo organ tjetër përgjegjës mbi të gjitha problematikat e të drejtave të njeriut.

Në shumë kontekste, me “gjini” shpesh nënkuptohen “gratë”; kjo vlen veçanërisht për Shqipërinë. Sidoqoftë, nuk duhet të harrohen shkeljet me bazë gjinore të të drejtave të personave LGBTI apo shkeljet gjinore në dëm të burrave. Shumica e këtyre sfidave janë mjaft të mprehta kur monitorohen shkeljet lidhur me dhunën ndaj grave apo formave të veçanta të diskriminimit.

Prandaj, gjatë proceseve të monitorimit, AP dhe KMD duhet:

- Të zbatojnë parimin e “mosdëmtimit”;
- Të vlerësojnë risqet e mundshme të sigurisë;
- Të ndjekin rekomandimet për sjelljen, gjatë ndërveprimit me të mbijetuarit e traumave;
- Të mbajnë parasysh rekomandimet e OJF-ve të specializuara që punojnë me to (nëse bashkëpunojnë me subjekte të tilla);
- Të shmangin supozimet e gabuara, p.sh.
 - të evidentojnë të gjitha gratë si viktime;
 - të etiketojnë të gjitha gratë si grup që janë qenësisht të marginalizuara apo vulnerabël.

AP dhe KMD duhet të analizojnë objektivisht vetë stereotipet e tyre dhe duhet të veprojnë në një mënyrë që i fuqizon gratë si titullare të të drejtave, duke mos i ulur ato në rolin e viktimës që ka nevojë për empati dhe ndihmë.

Disa mënyra për të arritur këtë janë:

- Përdorimi, në ndërveprim dhe raportim, i gjuhës me ndjeshmëri gjinore dhe fuqizuese;
- Monitorimi i diapazonit më të gjerë të shkeljeve të të drejtave të grave (përtej

94 Parimet lidhur me Statusin e Institucioneve Kombëtare (Parimet e Parisit). Miratuar me Rezolutën 48/134 datë 20 dhjetor 1993 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Gjetet në: <https://www.un.org/ruleoflaw/files/PRINCI-5.PDF>

dhunës ndaj tyre) si edhe integrimi i plotë i perspektivës gjinore përgjatë monitorimit dhe raportimit;

- Konsultimi, partnerizimi dhe angazhimi aktiv me OJF-të për mbrojtjen e grave dhe të të drejtave të tyre;
- Përpjekjet dhe nismat që kundërshtojnë stereotipet gjinore të dëmshme.

Metodologjia për monitorimin e diskriminimit gjinor duke përdorur përqasjen bazuar në të drejtat e njeriut

Analiza gjinore është thelbësore për të kuptuar se si gjinia ndikon te të drejtat e njeriut dhe për të planifikuar ndërhyrje të përshtatshme.

Gjinia ndikon në dy mënyra te të drejtat e njeriut:

- Shkelje gjinore specifike përbën çdo formë diskriminimi ndaj grave që i cenon në gëzimin e të gjitha të drejtave të njeriut. Sanksionimi i tyre ligjor parashikohet në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave dhe në traktate të tjera thelbësore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
- Shkelje të tjera të të drejtave të njeriut nuk janë haptazi apo drejtpërdrejt diskriminuese, por kanë tjetër ndikim te burrat krahasuar me gratë. Për shembull, gratë refugjate kanë të tjera nevoja dhe probleme sigurie dhe shëndetësore krahasuar me burrat refugjatë; edhe aksesit në arsim mund të jetë ndryshëm mes djemve dhe vajzave, në varësi të zgjedhjeve që bëjnë prindërit e tyre.

Analiza gjinore përdoret për të identifikuar të dyja llojet e shkeljeve: si aspektet specifike gjinore të shkeljes së të drejtave të njeriut, ashtu edhe shkeljen e të drejtave të njeriut të grave. Analiza gjinore e bën më të plotë vlerësimin e situatës dhe rezulton në masa korrigjuese më të shënjestruara, në mënyrë që gratë dhe burrat të përfitojnë njësoj dhe pabarazia të ndalojë. Ajo përfshin edhe përdorimin e gjuhës me ndjeshmëri gjinore.

Figura më poshtë ilustron ciklin e monitorimit dhe përshkruan hapat dhe aspektet e monitorimit të të drejtave të njeriut. Ky kapitull shërben për të kuptuar se si integrohet dimensionit gjinor në të gjitha aspektet e ciklit.




Figura 1

Cikli i monitorimit për diskriminimin gjinor. Marrë nga “Manuali për monitorimin e të drejtave të njeriut”, Komisioneri i Lartë i OKB-së për Të Drejtat e Njeriut (2001).

1. Mbledhja e informacionit

Kur mblidhet informacion kontekstual dhe rreth shkeljeve specifike të të drejtave të njeriut, të dhënat e mbledhura duhet të ndahen sipas gjinisë dhe moshës, por mundësisht edhe sipas parametrave të tjerë të rëndësishëm për identifikimin e

praktikave të mundshme diskriminuese (p.sh., përkatësia etnike, feja, përkatësia politike, aftësia e kufizuar). Është e rëndësishme të kuptohen lidhjet ndërmjet gjinisë dhe identiteteve të tjera shoqërore. Ndarja vetëm sipas gjinisë ose moshës është shpesh e pamjaftueshme për të zbuluar të gjitha format e diskriminimit. Kur mungon informacioni për gjininë, ky boshllëk duhet të pranohet shprehimisht. Informacioni për gjininë duhet të integrohet në të gjithë procesin e mbledhjes së informacionit. Ndërsa shqetësimet gjinore specifike mund të përmbliken nën titullin “gratë”, është e rëndësishme të kujtojmë se gratë si në vetvete nuk përbëjnë “grup vulnerabël”, por janë gjysma e popullsisë dhe prania (ose mungesa) e tyre në të gjitha sferat e jetës duhet të pranohet dhe të analizohet në mënyrë që të bëhet një analizë kontekstuale plotë e situatës.

2. Analiza

Për të kuptuar problemet me të drejtat e njeriut, propozohet një analizë trifazëshe ku përdoren një sërë mjeteve: (a) sfondi i problemit me të drejtat e njeriut; (b) ekuacioni i riskut që u kanoset të drejtave të njeriut; dhe (c) hartëzimi i aktorëve.

Sfondi i problemit me të drejtat e njeriut

Analiza fillon me një panoramë të përgjithshme të problemit me të drejtat e njeriut që po studiohet, që përfshin shkaqet, rrethanat, pasojat dhe pengesat ndaj mjeteve juridike. Analiza e këtyre elementëve ndihmon në identifikimin e problemeve sistemike dhe strukturore që prekin problemin e të drejtave të njeriut që po monitorohet. Kjo është veçanërisht e rëndësishme gjatë punës me aspektet gjinore, sepse mjaft apo shumica e shkeljeve gjinore apo e aspekteve gjinore të shkeljes së të drejtave të njeriut lidhen me diskriminimin sistematik dhe strukturor ndaj grave.

Kur bëjmë analizën, duhet të kemi parasysh marrëdhënien mes kulturës dhe të drejtave të njeriut, si edhe kryqëzimin mes diskriminimit ndaj grave dhe formave të tjera të diskriminimit (diskriminimi i shumëfishtë). Argumentet kulturore nuk duhet kurrë të tolerojnë diskriminimin apo dhunën ndaj grave.

Ekuacioni i riskut që u kanoset të drejtave të njeriut

Ky mjet ndihmon në analizimin e problemit me të drejtat e njeriut, duke e zbërthyer në katër komponentë: kërcënimet, vulnerabilitetet, zotimet dhe kapacitetet.

Për integrimin e gjinisë në këtë analizë, mund të përdoren “pyetjet gjinore” më poshtë:

Kërcënimi

- A bazohet sjellja e autorit të kërcënimit në ligje, politika, qëndrime, praktika apo pozicione që lejojnë diskriminimin gjinor?
- Cilat janë qëndrimet e autorit të kërcënimit përkundër barazisë gjinore?

Vulnerabiliteti

- A prekin kërcënimet ndryshe gratë dhe ndryshe burrat? Nëse po, si?
- A ka kërcënime që shënjestrojnë specifikisht burrat ose gratë? Nëse po, a është për shkak të gjinisë?
- A janë burrat dhe gratë vulnerabël në mënyra të ndryshme ndaj kërcënimit(eve)? Nëse po, si?

Zotimi

- A prekin zotimet e marra nga subjektet përgjegjëse për t'iu përgjigjur kërcënimeve ndryshe gratë e ndryshe burrat?
- Cilat janë zotimet e tyre formale dhe reale ndaj barazisë gjinore?
- A monitorojnë dhe veprojnë subjektet përgjegjëse me vigjilencën e duhur në mbrojtje të grave dhe/ose burrave nga shkeljet me bazë gjinore?
- A ndikojnë këto zotime (apo mungesa e tyre) te situata që po analizohet?

Kapaciteti

- A ekzistojnë dallime mes mënyrës se si burrat dhe gratë u përgjigjen kërcënimeve?
- A ndikojnë kapacitetet e kufizuara të Shtetit për t'iu përgjigjur kërcënimeve ndryshe te gratë e ndryshe te burrat?

Hartëzimi i aktorëve

Hartëzimi i aktorëve është një mjet analitik për të identifikuar aktorët kryesorë lidhur me një problem të të drejtave të njeriut, si edhe marrëdhëniet e pushtetit dhe kanalet e influencës mes tyre.

Gjinia mund të integrohet në këtë mjet me disa mënyra:

- a) duke analizuar aktorët sipas gjinisë;
- b) duke integruar perspektivën gjinore lidhur me problemin me të drejtat e njeriut, në kuadrin e një aktori.

Si përdoret gjuha me ndjeshmëri gjinore dhe fuqizuese?

SH mangni përdorimin e termave mashkull dhe femër, sepse kjo i redukton njerëzit në rolin e tyre riprodhues.

Nga ana tjetër, gjinia është një nocion i ndërtuar prej shoqërisë, prandaj duhen përdorur terma si burrë dhe grua si edhe termat asnjans.

Fjalët e përgjithshme me ngarkesë gjinie si etërit, vëllazëror duhet të zëvendësohen me terma neutralë si paraardhësit, miqësor.

Titujt e vendit të punës nuk duhen ndarë sipas gjinisë. Gjinia nuk është përcaktuese në rendimentin apo mënyrën se si i përmbushin rolet. Për shembull, termi kryeplak apo Komiteti i të Mënçurve mund të zëvendësohet me një term si Kryetar fshati dhe Komiteti Këshillues.

Jo	Po
Mashkull	Burrë
Femër	Grua
Etërit	Paraardhësit
Vëllazëror	Miqësor
Kryeplak	Drejtues fshati
Komiteti i të Mënçurve	Komiteti Këshillues

Diskriminimi ndaj Grave

Neni 1 i Konventës për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave⁹⁵ e përcakton këtë diskriminim si “çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e seksit, e që ka për pasojë ose për qëllim të komprometojë ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër”. Edhe plot instrumente të tjera ndërkombëtare e ndalojnë diskriminimin mbi bazën e seksit.⁹⁶

Mosdiskriminimi është parim thelbësor i të drejtave të njeriut që përshkon të gjitha të drejtat e tjera. Disa shembuj mund të jenë:

- Pjesëmarrja e pabarabartë e grave në jetën politike dhe publike;

95 Konventa për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave. Nju Jork, 18 dhjetor 1979. Versionin anglisht e gjeni në: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cedač.aspx>

96 Neni 2 i Deklaratës Universale të Të Drejtave të Njeriut; neni 2 i Paktit Ndërkombëtar për Të Drejtat Civile dhe Politike; neni 2 i Paktit Ndërkombëtar për Të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore; neni 1 i Paktit Ndërkombëtar për Mbrotjen e Të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Emigrantë dhe Familjarëve të tyre; neni 2 i Konventës për Të Drejtat e Fëmijës; neni 6 i Konventës për Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

- Paga e pabarabartë e grave për punë me të njëjtën vlerë;
- Diskriminimi ndaj vajzave në hyrjen në arsimin fillor dhe dytësor;
- Mohimi i informacionit dhe shërbimeve të shëndetit seksual dhe riprodhues për vajzat;
- Stereotipe gjinore që rezultojnë në përgjegjësi familjare dhe kujdesi familjar të papaguar për gratë dhe vajzat;
- Ligje që u kufizojnë mundësinë grave të përcjellin apo të përfitojnë shtetësinë, krahasuar me burrat.

Diskriminimi pengon gëzimin e të gjitha të drejtave të njeriut të grave. Identifikimi dhe pastaj **evidentimi/kapja e diskriminimit** në të gjitha pjesët e tij është një aspekt kyç i monitorimit, nga e drejta për arsimim cilësor deri te pjesëmarrja e qenësishme në jetën politike, ekonomike, publike, sociale dhe kulturore, aksesit në drejtësi, aksesit në shërbime shëndetësore e kështu me radhë. Diskriminimi mund të identifikohet dhe të dokumentohet vetëm duke mbledhur dhe analizuar sistematikisht informacionin dhe të dhënat e ndara.

PA dhe KMD mund të mbledhin **informacion të ndarë** drejtpërdrejtë – sidomos kur intervistojnë viktimat dhe dëshmitarët e shkeljeve të të drejtave të njeriut – përmes formularëve dhe hedhjes së informacionit në databaza që kapin elementë si seksi, gjinia, mosha, përkatësia etnike dhe feja e viktimave potenciale, dëshmitarëve dhe autorëve të dyshuar. Analiza sistematike e këtij informacioni të thjeshtë i jep që në fillim ekipeve në terren kuptueshmëri më të mirë se si po kryhet monitorimi si edhe për drejtimin dhe ndikimin e tij.

Referimi duhet të jetë pjesë e monitorimit të të drejtave të grave. Me pëlqimin e informuar të individëve përkatës, sipas rastit, AP dhe KMD duhet të lehtësojnë aksesin e tyre te strukturat dhe organizatat që ofrojnë mbështetje psikosociale, ndihmë juridike, strehim, mbrojtje fizike, shërbime të kujdesit shëndetësor, etj. Kjo përfshin skanimin/hartëzimin e modaliteteve apo rrjetit të referimit, si edhe vendosjen e kontakteve paraprake me këto organizata dhe shërbime, me qëllim që të jenë në pozitën për t'i këshilluar se si të aksesojnë këto shërbime dhe të lehtësojnë kontaktin kur nevojitet.

Koordinimi me aktorët e tjerë është thelbësor për të garantuar disponueshmëri të gjerë të shërbimeve, por edhe që referimi të respektojë konfidencialitetin dhe të mbrojë sigurinë e individëve të asistuar. Për shembull, AP dhe KMP mund të vendosin lidhje të mira me njësitë policore përgjegjëse për rastet e dhunës ndaj grave, si edhe të verifikojnë nëse kanë dhe përdorin Procedura Standarde për referimin e viktimave të shërbimet e duhura.

Llojet e diskriminimit ndaj grave

Llojet e diskriminimit ndaj grave	Çfarë është	Këshilla monitorimi
Diskriminimi i drejtpërdrejtë	Trajtim i diferencuar i grave dhe burrave bazuar në shkaqet e seksit dhe jo arsye të justifikueshme (poligamia, mosha të ndryshme ligjore për martesë për djemtë dhe vajzat).	Mund të zbulohet duke monitoruar legjislacionin dhe llojet e ndryshme të akteve normative dhe protokolleve. Shpesh është i përcaktuar në ligje, akte normative dhe politika.
Diskriminimi i tërthortë	Një kusht neutral në dukje, por që rezulton në trajtim të pabarabartë të grave (p.sh. kur gratë diferencohen në skemën e pensionit që përjashton punëtorët me kohë të pjesshme, shumica e të cilëve janë gra).	Bëhet i qartë kur konceptet e bazuara në stereotipe mishërohen në ligje dhe politika. Kur vëreni diferencim mes grave dhe burrave lidhur me të drejtat e tyre, analizoni për të parë nëse ndonjë stereotip gjinor i caktuar pengon gratë të përfitojnë prej ligjeve dhe politikave përkatëse (p.sh. shikoni aludimet se kush sjell bukë në shtëpi, kush është kryetari i familjes dhe kush kujdeset për fëmijët. Në situatën që vëzhgoni, gjithmonë vëreni përvojat e diferencuara, pikëpamjet dhe nevojat e grave dhe vajzave. Me cilat sfida përballen krahasuar me burrat dhe djemtë? A vijnë këto diferencime prej diskriminimit, pabarazisë apo stereotipeve gjinore?
Diskriminimi në ligj (de jure)	Diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe diskriminimi i tërthortë të përcaktuar në ligje, sidomos ligjet me efekt dëmtues ndaj grave	Ligjet diskriminuese mund të gjenden në të gjitha fushat. Legjislacioni që mund të monitorohet: kushtetuta, e drejta penale, e drejta e punës, e drejta e shëndetit, e drejta civile, e drejta zgjedhore, etj.

Diskriminimi në praktikë (de facto)	Mundësi dhe rezultate të pabarabarta. Mundësi për burrat dhe gratë që të gëzojnë të drejtat e njeriut për të arritur rezultate të barabarta. Në fushat e strehimit dhe pronës, ligjet parashikojnë bashkëpronësi me pëlqimin e të dy bashkëshortëve. Por, në realitet, vetëm personat e arsimuar apo në zonat rurale bëjnë përpjekje të regjistrohen si bashkëpronarë. Në shumë raste kur gratë marrin apo e kanë titullin, rrallë fitojnë kontroll mbi të.	Verifikoni çfarë ndodh në praktikë. Për shembull: a përfundojnë gjimnazin vajzat në rajone të caktuara në numra të njëjtë me djemtë? A kanë gratë kandidate në fushatë zgjedhore të njëjtat mundësi si kandidatët burra? A favorizohen gratë po aq sa burrat që të gjejnë punë? A përjashtohen gratë nga mundësia e pronësisë?
Format e kryqëzuara të diskriminimit	Disa shtresa të diskriminimit të kryqëzuar paralel (mungesa e mundësisë së një gruaje me aftësi të kufizuar që të marrë titullin e pronësisë). Rritja e diskriminimit për më shumë se një shkak (mosha, raca, identiteti gjinor, aftësia e kufizuar, orientimi seksual, përkatësia etnike, feja, etj.)	Mblidhni të dhënat dhe informacionin mbi bazën e disa shkaqeve (mosha, raca, identiteti gjinor, aftësia e kufizuar, orientimi seksual, përkatësia etnike, feja, etj.) dhe analizoni ndërveprimin mes shkaqeve të ndryshme të diskriminimit. Ndonjë diskriminim mund të shënjestrojë vetëm grupe specifike të grave.

Rasti i diskriminimit ndaj grave dhe vajzave refugjate

Sfidat me të cilat përballen gratë anembanë globit që kanë të bëjnë me diskriminimin, theksohen më tej për gratë dhe vajzat refugjate. Gratë refugjate mund të përjetojnë dhunë dhe diskriminim në faza të ndryshme të udhëtimit të tyre, qoftë në vendin e origjinës teksa largohen për të gjetur një strehë, apo në vendin ku gjejnë strehim.

Diskriminimi ndaj grave dhe vajzave refugjate ndodh në shumë sfera dhe prek shëndetin, arsimin, aksesin në burime dhe mundësitë ekonomike të tyre.

Aksesi në arsim

Në vendet e prekura nga konflikti, vajzat kanë 2.5 herë më shumë gjasa sesa djemtë që të ngelen pa shkollë. Martesa e hershme, varfëria, pasiguria dhe rolet gjinore pengojnë gratë të ndjekin shkollën. Zhvendosja shpesh i detyron gratë dhe vajzat të marrin role dhe përgjegjësi përkujdesëse shtesë për të mbështetur familjen dhe komunitetin e tyre, gjë që shpesh rezulton në shifër të lartë të braktisjes së shkollës.

Aksesi në kujdes shëndetësor

Gratë refugjate shpesh kanë akses të kufizuar në sistemet e shëndetit publik, shërbimet e shëndetit riprodhues, produktet higjienike dhe metodat kontraceptive. Aksesi i kufizuar në shërbimet adekuate të shëndetit mëmësor mund të ketë pasoja të rënda shëndetësore. 60% e vdekjeve të parandalueshme të nënave ndodhin në situata të zhvendosjes ose konfliktit. Edhe mungesa e produkteve sanitare mund të pengojë gratë dhe vajzat të ndjekin shkollën, të shkojnë në punë apo të kryejnë aktivitete të tjera.

Aksesi në burime dhe mundësi ekonomike

Gratë refugjate shpesh përballen me pengesa në aksesin në punë dhe shërbime financiare, gjë që i bën ato më të prirura të pësojnë dhunë, abuzim dhe shfrytëzim. Për më tepër, paga e diferencuar sipas gjinisë që favorizon burrat ndaj grave është e zakonshme në shtetet pritëse të refugjatëve.

Monitorimi i Dhunës ndaj Grave

DHuna ndaj grave” kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi ndaj grave që përfshin çdo akt dhune me bazë gjinore që rezulton apo ka gjasa të rezultojë në dëmtim fizik, seksual, psikologjik apo ekonomik ose vuajtje të grave, ashtu si edhe kërcënimet për kryerjen e akteve të tilla, shtrëngimin apo heqjen arbitrare të lirisë, qoftë në jetën publike apo atë private;⁹⁷ Konventa e Stambollit flet për të gjitha format e dhunës ndaj grave, si martesa e detyruar, dhuna psikologjike, përndjekja, dhuna fizike, dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin, gjymtimi gjenital femëror, aborti i detyruar dhe sterilizimi i detyruar si dhe ngacmimi seksual.

Gratë, burrat, djemtë dhe vajzat mund të jenë viktimat e dhunës me bazë gjinore, por shumica e viktimave në mbarë botën janë gra dhe vajza. Dhuna shënjestron gratë në mënyrë joproporcionale, thjesht sepse ato janë gra. Po kështu, edhe dhuna ndaj komunitetit LGBTI shpesh bazohet në gjini.

PA dhe KMD, si institucione për të drejtat e njeriut në Shqipëri, duhet të jenë të

97 Këshilli i Evropës, Konventa për parandalimin dhe luftën ndaj kundër ndaj grave dhe dhunës në familje. Stamboll, 11.5.2011. Gjetet në: <https://rm.coe.int/168008482e>

vetëdijshme për format dhe kryqëzimet e dhunës dhe diskriminimit ndaj grave që mund të ndodhë në një shoqëri, si në jetën publike edhe në atë private.

Monitorimi i dhunës ndaj grave mund të kërkojë mbledhjen e informacionit për këto aspekte:

- Legjislacioni, aktet normative dhe procedurat në fuqi (ose mungesa e tyre) që mbrojnë gratë nga të gjitha format e dhunës;
- Masat dhe politikat e miratuara për të siguruar hetime në kohë, të paanshme dhe objektive për rastet e dhunës ndaj grave dhe për të promovuar aksesin e të mbijetuarve në drejtësi;
- Zakonet, traditat dhe vlerat fetare që ekzistojnë në shoqërinë shqiptare dhe që rregullojnë si sjelljen ashtu edhe seksualitetin e grave dhe vajzave;
- Konteksti politik, social, kulturor dhe ekonomik në të cilin ndodh dhuna ndaj grave, si dhe reagimet politike, ligjore dhe shoqërore ndaj dhunës së tillë;
- Strukturat dhe mekanizmat që reagojnë dhe trajtojnë dhunën ndaj grave;
- Ekzistenca e shërbimeve mbështetëse për gratë viktime të dhunës (p.sh. linja këshillimi për gra dhe vajza 116-117, shërbime të specializuara policore, kujdes shëndetësor, ndihmë psikosociale, ndihmë juridike, strehëza, etj.);
- Statistika të ndara mbi incidencën e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe ndaj grave viktime të dhunës, duke përfshirë moshën, racën, fenë, aftësinë e kufizuar, përkatësinë etnike, arsimin, statusin e emigrantit, orientimin seksual, identitetin gjinor, kushtet ekonomike dhe elementë të tjerë, sipas rastit;
- Boshllëqet në mbrojtjen e grave prej formave të kryqëzuara të diskriminimit dhe dhunës në fusha si përjashtimi social, varfëria, arsimi, shëndetësia, etj.

Dhuna seksuale

DHuna seksuale përfshin detyrimin, shtrëngimin ose tentativën për të imponuar kontakt ose sjellje seksuale kundër dëshirës. Dhuna seksuale përfshin ndër të tjera përdhunimin martesor, dhunimet në pjesët seksuale të trupit, detyrimin për të kryer seks pas dhunës fizike, ose trajtimin e dikujt në mënyrë nënçmuese seksuale. Kjo lloj dhune mund të kryhet nga partnerët intimë dhe anëtarët e familjes në kontekstin e martesës, takimeve për njohje dhe familjes. Gjithashtu përfshin akte të tilla si prekja e pjesëve të trupit, lakuriqësia e detyruar, ekzaminimet mjekësore poshtëruese, lëndimet e qëllimshme në gjoks dhe zonën gjenitale, infeksioni i qëllimshëm me sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe kërcënimet e natyrës seksuale.

Në rastet e rutinave të diskriminimit duke përfshirë dhunën ndaj grave, **konfliktet ose emergjencat shëndetësore si pandemia e Covid-19** kanë gjasa t'i përforcojnë

dhe t'i përkeqësojë ato.

Kuptimi i këtyre dinamikave që ndodhin në situata emergjence, ndihmon AP dhe KMD të identifikojnë më mirë format e dhunës seksuale që vërehen në një shoqëri të caktuar, cilat janë shkaqet dhe pasojat e tyre dhe cilët janë individët/grupet më në rrezik dëmtimi.

Trafikimi i grave dhe vajzave 3

Trafikim i qenieve njerëzore” nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose marrjen e personave, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, gënjimit, abuzimit me pushtetin ose të një pozite dobësie, si edhe dhënia apo marrja e pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi të këtij të fundit. Shfrytëzimi përfshin minimalisht shfrytëzimin e të tjerëve për prostitucion apo për forma të tjera shfrytëzimi seksual, punë apo shërbime të detyruara, skllavërinë apo praktika të ngjashme me të, robërinë dhe heqjen e organeve.⁹⁸

Kur kryejmë monitorim mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe vajzave, monitoruesi mund të fokusohet në çështjet më poshtë:

- Cilat forma të trafikimit ekzistojnë në Shqipëri?
- A është Shqipëria vend transiti apo destinacioni?
- Cilat janë viktimat dhe kush është në rrezik viktimizimi?
- Kush përfshihet në kryerjen e krimit?
- A është legjislacioni adekuat? A zbatohet?
- Si ecën zbatimi i planit kombëtar për luftën kundër trafikimit në Shqipëri?
- Çfarë masash merren për parandalimin e trafikimit, sidomos duke u ofruar informacion dhe mundësi personave të rrezikuar?
- A ekziston mbrojtje dhe mbështetje për të mbijetuarit e trafikimit? A ofrohet asistencë ligjore dhe leje qëndrimi të përkohshme?
- A kushtëzohet ndihma dhe mbështetja me gatishmërinë e viktimës për të bashkëpunuar?
- A ka ndonjë masë të veçantë për fëmijët e mbijetuar të trafikimit?
- Cilat janë garancitë për riatdhesimin e sigurt të të mbijetuarve të trafikimit?

98 Këshilli i Evropës, Konventa për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 16 maj 2005, CETS 197.
Gjendet në: https://ec.europa.eu/anti-trafficking/council-europe-convention-action-against-trafficking-human-beings_en

Monitorimi i Legjislacionit

Monitorimi i legjislacionit dhe të drejtave të njeriut ndahet në dy kategori kryesore:

1. Monitorimi i kuadrit ligjor për të siguruar që është i përafuar me standardet dhe normat ndërkombëtare për të drejtat e grave (konventa të nënshkruara dhe të ratifikuara nga Shqipëria).
2. Monitorimi i zbatimit të legjislacionit për të drejtat e grave.

AP ka hartuar një raport alternativ për zbatimin e Konventës CEDAW (2016-2020), dhe sugjerohet të bëhet e njëjta gjë me Konventën e Stambollit, meqë raporti i monitorimit i GREVIO-s ofron ekspertizë teknike dhe analizë të thelluar mbi legjislacionin dhe politikat për dhunën ndaj grave - një fushë kjo e pambuluar nga instrumente të tjera.

Lista e plotë e problemeve të përsëritura jepet në vlerësimin bazë të GREVIO-s për Shqipërinë dhe në raportin alternativ të AP për Konventën CEDAW.

Në tërësi, ligjet e miratuara në Shqipëri janë në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar dhe ajo që mungon është zbatimi i duhur. Kjo është një prej detyrave monitoruese që duhet të kryhen nga AP dhe KMD.

Pyetjet kryesore për këtë monitorim renditen më poshtë:

- A janë ngritur strukturat dhe mekanizmat e parashikuara në ligj?
- A funksionojnë?
- A u drejtohen atyre titullarët e të drejtave?
- A po përmbush ligji objektivat e vet?
- A duhet të ndryshohet ligji për të arritur më shumë, apo për t'iu përshtatur rrethanave të reja?
- A alokon Shteti burime adekuate për zbatimin e ligjit?
- A përdoret instrumenti i buxhetimit gjinor?

Monitorimi i Stereotipizimit Gjinor

Monitorimi i **stereotipizimit gjinor** është shumë i rëndësishëm, sepse janë stereotipet ato që pengojnë gratë të lulëzojnë. Janë disa konventa dhe ligje ndërkombëtare që e bëjnë këtë. Për shembull, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara detyron Shtetet të luftojnë stereotipet dhe stereotipizimin, duke përfshirë stereotipet e përbëra dhe stereotipizimin mbi bazat e

seksit, moshës apo aftësisë së kufizuar.

Stereotipet gjinore mund ta shtojnë ndikimin e dëmshëm kur shoqërohen me supozime të tjera negative për grupe të tjera, si gratë me aftësi të kufizuara, gratë në konflikt me ligjin, gratë me status më të ulët ekonomik, apo gratë që u përkasin pakicave, etj.

Disa shembuj stereotipesh që pengojnë gratë në gëzimin e të drejtave të njeriut janë:

- Ideja që “gratë janë të lindura për t’u kujdesur për fëmijët dhe familjen” përforcon nocionin se gratë duhet të jenë përgjegjëse për shumicën e punëve të shtëpisë dhe kujdesin e papaguar. Edhe kjo mund të çojë në shkelje të të drejtave të njeriut të grave kur reflektohet në ligje dhe praktika që i privojnë gratë nga mundësitë arsimore dhe profesionale.
- Stereotipet, qëndrimet patriarkale dhe disa besime dhe praktika fetare kontribuojnë në vazhdimin e dhunës ndaj grave dhe në praktikatat e dëmshme, duke përfshirë martesën e fëmijëve dhe martesën e detyruar.
- Edhe pasqyrimi stereotipizues dhe objektivikimi i grave në media, veçanërisht në reklama, përforcon idenë se gratë janë nën varësi të burrave, gjë që çon në shkelje të të drejtave të grave në shumë fusha të jetës.

Monitorimi i të drejtave të njeriut të grave kërkon edhe identifikimin dhe analizimin e stereotipeve gjinore, veçanërisht se si ato ndikojnë në të drejtat e grave. Monitorimi mund të kryhet në këto fusha kryesore për shkak se mund të intensifikojnë stereotipet gjinore:

- Media, industria e argëtimit dhe reklammat (p.sh., a ka reklama seksiste?
- Si portretizohen gratë dhe burrat në media?
- Si portretizohen gratë që merren me politikë?
- Arsimi, tekstet shkollore dhe universitare, kurrikulat dhe metodat e mësimdhënies (p.sh., a ndryshojnë apo përjetësojnë ato stereotipe të dëmshme gjinore?)
- Qëndrimet dhe sjelljet e udhëheqësve dhe vendimmarrësve (p.sh., cili është diskursi i udhëheqësve politikë mbi pjesëmarrjen e grave në jetën politike ose, më gjerë, për rolin e gruas në shoqëri?);
- Ligjet dhe praktikatat tradicionale ose zakonore në lidhje me rolin e gruas në shoqëri;
- Gjyqësori dhe administrimi i drejtësisë dhe zbatimi i ligjit;
- Vendi i punës (a përfaqësohen gratë në mënyrë të barabartë në sektorë profesionalë të vlerësuar? A përfaqësohen gratë në pozita udhëheqëse? A ka

ngacmim seksual? Nëse po, a trajtohet apo tolerohet?);

- Hapësira dhe teknologjia dixhitale (p.sh. monitorimi i të dhënave që nxisin bullizmin kibernetik dhe misogjeninë në internet, etj.
- Sfera private.

Jeta private

Familja dhe shkolla janë ato që mund të promovojnë të drejtat e njeriut. Madje, pikërisht aty formohen stereotipet e para dhe më pas riprodhohen në shkallë më të gjerë. Shumë shpesh, shumica e rasteve të diskriminimit fillon këtu, në sferën private.

Më poshtë jepen disa shembuj të shkeljeve që ndodhin në sferën private:

- Dhuna në familje që përfshin dhunë psikologjike, fizike dhe seksuale
- Aborti i detyruar
- Abuzimi dhe shfrytëzimi seksual i fëmijëve
- Puna e fëmijëve
- Vendimet e familjes për të ndërprerë shkollimin e vajzave
- Vendimet e familjes se si gratë dhe vajzat duhet të jetojnë, me kë të martohen, etj.
- Martesat e hershme dhe martesat e detyruara
- “Dhuna për nder”
- Stereotipet e dëmshme gjinore
- Praktikat diskriminuese ndaj grave dhe vajzave lidhur me identitetin gjinor dhe orientimin seksual
- Përdhunimi martesor

Disa nga individët që mund të inkurajojnë format e shkeljeve më lart janë:

Familjarët dhe të afërmit, udhëheqësit fetarë, udhëheqësit e komunitetit, personat e njohur të viktimës, punëdhënësit (në ekonominë formale dhe informale).

Ndërkohë që këto shkelje ndodhin në sferën private, CEDAW dhe Konventa e Stambollit përcaktojnë se Shteti është përgjegjës për mbrojtjen e grave dhe vajzave nga rreziku i dhunës. Masat mbrojtëse mund të jenë lëshimi i urdhrave të largimit (të dhunuesit) nga banesa apo ndalimin e autorëve të mundshëm.

Mbrojtësit e të drejtave të njeriut të grave

Mbrojtësit e të drejtave të njeriut të grave (MDNJG) janë kryesisht gra që punojnë për çdo problematikë të të drejtave të njeriut, por edhe kushdo që merret me çështjet e të drejtave të njeriut në lidhje me barazinë gjinore.

MDNJG-të ekspozohen ndaj të njëjtave rreziqe ashtu si mbrojtësit e të drejtave të njeriut, por në rastin kur janë gra, bëhen shënjestër e më shumë abuzimeve me të drejtat e njeriut – si online ashtu edhe offline. Puna e MDNJG-ve mund të perceptohet si sfidim i nocioneve tradicionale që shoqëria ka për familjen dhe rolet gjinore, çka mund të provokojë armiqësi te popullata e gjerë dhe autoritetet. Gjithashtu, MDNJG-të mund të stigmatizohen prej udhëheqësve të komunitetit, grupeve fetare, familjeve dhe komuniteteve që e perceptojnë punën e tyre si kërcënim për fenë, nderin apo kulturën. Kjo situatë rrit rrezikun që ata të vihen në shënjestër të sulmeve.

Disa shembuj të sulmeve dhe kërcënimeve në drejtim të MDNJG-ve janë:

- MDNJG-të janë shpesh objekt i kërcënimeve dhe dhunës ndaj tyre apo familjarëve të tyre. Kjo vlen edhe për rastet kur flasin në publik, japin intervista, bëjnë prezantime në forume, etj.;
- Dhuna me bazë gjinore është tipari i përbashkët i sulmeve ndaj MDNJG-ve;
- Sulmet në media dhe rrjetet sociale ndaj MDNJG-ve shpesh bazohen në të njëjtat stereotipe që ata përpiqen të kundërshtojnë: stereotipet për rolin e grave në shoqëri dhe për seksualitetin e tyre (p.sh. ato portretizohen si nëna të këqija ose gra të këqija, lezbike (sulumuesit e konsiderojnë si fjalë nënçmuese) apo prostituta).
- Kufizimet ndaj lirisë së mendimit dhe të shprehjes së MDNJG-ve, lirisë së lëvizjes, grumbullimit dhe organizimit, shpesh justifikohen në emër të moralit publik.

Për të garantuar monitorim të drejtë dhe të balancuar, IKDNJ-të duhet të sigurojnë si vijon:

- Të punojnë me MDNJG-të si pjesë e aktiviteteve monitoruese të tyre: mbrojtësit janë burim i çmuar informacioni dhe mund të ndihmohen që të arrijnë te gratë;
- Duke mbajtur parasysh sfidat dhe shkeljet specifike gjinore me të cilat përballen MDNJG-të, IKDNJ-të duhet të monitorojnë dhe të raportojnë mbi situatën e të drejtave të njeriut të MDNJG-ve;
- Puna e MDNJG-ve duhet të fitojë njohje dhe mbështetje publike. Ky është një ndër hapat e parë në parandalimin apo reduktimin e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj MDNJG-ve;
- Masat që parandalojnë, japin mbrojtje apo përgjigjen ndaj kërcënimeve dhe sulmeve në drejtim të MDNJG-ve, duhet të mbështeten. Këto masa janë të tilla që mbajnë parasysh përvojat, pikëpamjet dhe nevojat e mbrojtësve të të drejtave të njeriut të grave.

Shëndeti seksual dhe riprodhues dhe të drejtat lidhur me të

SHëndeti është e drejtë themelore e njeriut dhe e domosdoshme për ushtrimin e të drejtave të tjera të njeriut. Mes të tjerash, e drejta e grave për shëndet përfshin edhe shëndetin e tyre seksual dhe riprodhues. E drejta për shëndetin seksual dhe riprodhues kontribuon si pjesë e pandarë e të drejtës së përgjithshme për shëndet, që është e lidhur pazgjidhshmërisht me gëzimin e të drejtave të tjera të njeriut, si e drejta për arsim, punë dhe barazi, si edhe të drejtat për jetën dhe jetën private.

Shëndeti seksual dhe riprodhues (ShSR) dhe të drejtat lidhur me të brendësojnë jo vetëm lirinë për të pasur kontroll mbvi shëndetin dhe trupin e tyre, por edhe të drejtën për të gëzuar një larmi facilitetesh, të mirash, shërbimesh dhe kushtet të nevojshme për realizimin e standardit më të lartë të shëndetin seksual dhe riprodhues. Shëndet seksual dhe riprodhues nënkupton edhe të drejtën për të pasur jetë seksuale të sigurt dhe përmbushëse. Gratë kanë të drejtë të vendosin për numrin e fëmijëve dhe periodhat mes shtatzënive, si edhe të kenë informacion dhe shërbime ku përfshihen edhe shërbimet e kontrceptimit të nevojshme për të marrë vendime të tilla.

Në kontekstin shqiptar, shëndeti seksual dhe riprodhues trajtohet fare pak dhe rrallë monitorohet apo kryhen kërkime shkencore për të. Neglizhimi i këtij aspekti të shëndetit krijon pengesa të ndryshme në aksesimin e shërbimeve dhe edukimit lidhur me ShSR. Kjo kërcënon shëndetin e grave, konkretisht duke rritur mundësinë e shtatzënive të paplanifinuara dhe aborteve të pasigurta, çka shton rrezikun e infektimit seksualisht të transmetueshme dhe, mbi të gjitha, shton rrezikun e vdekjes të nënat dhe sapolindurit.

Disa kategori grash janë më të prirura të mos ushtrojnë të drejtat e tyre për ShSR. Gratë me aftësi të kufizuara kërkojnë vëmendje dhe ndjeshmëri të shtuar ndaj situatës së tyre. Edhe adoleshentët nuk duhet të kenë frikë të shkojnë te gjinekologu ngaqë supozohet se nuk duhet të kenë kontakte seksuale. Kjo është e vështirë pasi në shumë vende, përfshirë Shqipërinë, ekzistojnë tabu rreth seksit dhe seksualitetit. Po kështu, kjo ndikon edhe në aftësinë e grave beqare për të aksesuar shërbimet.

Gratë dhe infektimet seksualisht të transmetueshme (IST) dhe HIV/AIDS

Gratë dhe adoleshentët janë veçanërisht të rrezikuara nga HIV/AIDS dhe infeksionet e tjera seksualisht të transmetueshme. Kjo nuk vjen vetëm prej funksionit të lindur riprodhues, por edhe për shkak të pabarazive ekonomike dhe sociale. Për më tepër, stereotipet gjinore të rrënjësura në kulturë, i vënë gratë dhe vajzat në pozita vartëse në raport me burrat dhe djemtë kur bëhet fjalë për marrëdhëniet seksuale.

Ndodh shpesh që dhuna ndaj grave (DhNG) të jetë njëkohësisht shkak dhe pasojë e një IST apo HIV/AIDS. DhNG mund të kontribuojë më tej në transmetimin e IST-ve

dhe/ose HIV/AIDS. Gratë e prekura nga HIV zakonisht stigmatizohen, çka shkakton edhe më shumë diskriminim e dhunë. Në shumë vende, këtyre grave u kanoset edhe rreziku në rritje që t'i nënshtrohet sterilizimit kundër dëshirës. Organizatat dhe autoritetet shtetërore duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të analizojnë ndërveprimin mes diskriminimit me bazë gjinore, pabarazisë, dhunës ndaj grave, IST-ve dhe HIV/AIDS, edhe se si ky ndërveprim ndikon te aksesit i grave në kujdesin shëndetësor.

Shkeljet e të drejtave seksuale dhe riprodhuese të grave janë të shpeshta, pavarësisht se është një e drejtë themelore e njeriut. Këto shkelje janë të shumë formave, si p.sh. barriera të shumta ligjore, procedurale, praktike dhe sociale ndaj aksesit në kujdesin dhe informacionin shëndetësor seksual dhe riprodhues, mohimin e aksesit në shërbimet që kërkojnë vetëm gratë, shërbimet dhe procedurat jocilësore në lidhje me riprodhimin dhe shëndetin seksual, përfshirë ekzaminimet e detyruara të virgjërisë dhe abortin e detyruar, të kryera pa pëlqimin e tyre të informuar. 52

Këto shkelje janë të rrënjosura thellë në vlera shoqërore lidhur me seksualitetin e grave. Traditat patriarkale për rolet e gruas brenda familjes e reduktojnë vlerën e gruas në aftësinë e saj riprodhuese. Martesa dhe shtatzënia e hershme, ose shtatzënitë shumë afër njëra-tjetrës - shpesh si rezultat i përpjekjeve për të lindur pasardhës meshkuj për shkak të preferencës për djem – kanë ndikim shkatërrues te shëndeti i grave, e ndonjëherë me pasoja fatale. Po kështu, shumë gra fajësohen shpesh për infertilitet; si rezultat, ato bëhen objekt i shkeljeve të ndryshme të të drejtave të njeriut.

Gjatë monitorimit të së drejtës së grave për shëndet, IKDNj-të duhet të marrin parasysh aspektet e mëposhtme në lidhje me IST-të dhe HIV-in:

- Aktet normative, politikat ose planet që parashikojnë nevojat e veçanta të kujdesit shëndetësor të grave, duke pasur parasysh praktikat etnike dhe rajonale, apo ato të bazuara në fe dhe traditë;
- Politikat, strategjitë apo planet për të luftuar HIV/AIDS dhe për të mbrojtur nga diskriminimi gratë që jetojnë me HIV/AIDS;
- Politikat ose strategjitë për përgjigje mjekësore ndaj dhunës ndaj grave dhe disponueshmëria e shërbimeve shëndetësore të pajisura me personel të specializuar apo të trajnuar mbi problematikat e dhunës ndaj grave;
- Aktet normative, politikat apo planet për kujdesin shëndetësor seksual dhe riprodhues, siç janë shërbimet dhe mallrat kontraceptive;
- Ligjet dhe politikat për abortin ose ndërprerjen e shtatzënisë, nëse shërbimet e abortit janë të aksesueshme sipas kërkesës, si dhe ekzistenca e politikave për parandalimin e abortit të pasigurt dhe për ofrimin e kujdesit pas abortit;
- Ligjet që kriminalizojnë moszbulimin e infektimit me HIV, ekspozimin dhe transmetimin e HIV-it, aktivitetet seksuale konsensuale ndërmjet të rriturve, si dhe identitetin ose shprehjen transgjinore;
- Rastet dhe rutinat e ekzaminimeve të detyruara të virgjërisë dhe abortit të

detyruar (Kush janë viktimat dhe autorët? Çfarë po bën qeveria për këtë? etj.);

- Ndikimi që kanë krizat shëndetësore si virusi Covid-19 në të drejtat e grave, veçanërisht në shëndetin dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese, si edhe reagimi i Shtetit ndaj kësaj situate;
- Disponueshmëria dhe aksesueshmëria e shërbimeve publike të kujdesit shëndetësor për parandalimin, zbulimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe kushteve specifike për gratë, përfshirë edhe shëndetin seksual dhe riprodhues. Aty ku këto shërbime nuk financohen prej Shtetit, duhet që për gratë në nevojë të ketë përjashtime nga çdo skemë shërbimi 'paguaj ta kesh', ose mekanizma të tjerë për të siguruar që gratë në nevojë të kenë akses dhe të përdorin shërbimet e kujdesit shëndetësor
- Shkalla në të cilën shërbimet e kujdesit shëndetësor ofrohen dhe aksesohen nga gratë në situata në nevojë, të marginalizuara ose të pafavorizuara (p.sh., gra të moshuara, adoleshente, gra me aftësi të kufizuara, gra që jetojnë në zona rurale, etj.).
- Roli i punonjësve shëndetësorë si mbrojtës të të drejtave të njeriut të angazhuar në mbrojtjen e shëndetit dhe të të drejtave seksuale dhe riprodhuese, si dhe sulmet ndaj tyre për aktivitetet e tyre;
- Nëse e drejta për shëndet, duke përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues, është e kërkueshme në gjykatë, si dhe nëse gratë dhe vajzat kanë akses në mjete juridike efektive, transparente dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, duke përfshirë ato administrative dhe gjyqësore.

Vdekshmëria mëmësore dhe sëmundshmëria

Vdekje mëmësore quhet vdekja e një gruaje shtatzënë ose brenda 42 ditësh nga ndërprerja e shtatzënisë, nga shkaqe që lidhen me shtatzëninë apo përkeqësimin e saj, por jo shkaqe aksidentale apo incidentale.

Mbi 250 000 gra dhe vajza shtatzënë vdesin çdo vit. Jo pak por 98% e këtyre vdekjeve vlerësohen si të parandalueshme.

Arsyet për të cilat gratë dhe vajzat vdesin ose pësojnë dëmtim gjatë shtatzënisë dhe lindjes shpesh klasifikohen si "tri vonesat":

1. vonesa në kërkimin e kujdesit mjekësor të përshtatshëm;
2. vonesa për të arritur në një qendër shëndetësore të përshtatshme;
3. vonesa në marrjen e kujdesit të përshtatshëm me mbërritjen në qendër shëndetësore.

Këto vonesa shkaktohen nga faktorë të shumtë që janë shqetësues nga perspektiva e të drejtave të njeriut.

Këta faktorë janë:

- Gratë dhe vajzat kanë më pak burime dhe më pak arsim që të arrijnë aksesin në shërbimet e kujdesit shëndetësor. Gratë që përjetojnë dhunë në shtëpi mund të priren më pak të kërkojnë shërbime shëndetësore për shtatzëninë ose për lëndimet e pësura si rezultat i dhunës në familje;
- Vajzat dhe adoleshentet, grupi me riskun më të lartë për vdekshmëri mëmësore dhe sëmundshmëri, përballen me sfida të veçanta kur bëhet fjalë për marrjen e informacionit, përfshirë edukimin gjithëpërfshirës seksual dhe aksesin në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues;
- Martesa e hershme, e cila prek në mënyrë joproporcionale vajzat, rrit gjasat që ato të mbeten shtatzënë para se të jenë gati;
- Disa grupe grash – si gratë që jetojnë në zona rurale, gratë e zhvendosura ose refugjate – janë objekt formave të shumëfishta ose të kryqëzuara të diskriminimit, duke ndikuar jo vetëm në aksesin e tyre në qendra shëndetësore, por edhe në mënyrën se si trajtohen atje, çka në vetvete ndikon në gatishmërinë e tyre për t'u kthyer në qendrën shëndetësore;
- Mungesa e shërbimeve të kujdesit obstetrik urgjent, ose mohimi i abortit, shpesh çon në sëmundshmëri dhe vdekshmëri mëmësore.

Çfarë mund të monitorojnë institucionet përgjegjëse kur vjen puna te të drejtat ShSR të grave, sidomos lidhur me mëmësinë?

- A janë shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues cilësore, të disponueshme, të aksesueshme, të përballueshme dhe të pranueshme për gratë dhe vajzat? Këto shërbime përfshijnë shërbimet kontraceptive, zbulimin dhe trajtimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme, zbulimin e dhunës në familje, menaxhimin e shtatzënieve të padëshiruara, ndjekjen e kualifikuar të gruas shtatzënë para dhe pas lindjes, kujdesin obstetrik urgjent dhe kujdesin e duhur pas lindjes?
- Si është situata e adoleshentëve dhe grave të pamartuara apo beqare me këto problematika?
- A përballen ato me sfida dhe stigma specifike?
- A marrin pjesë në mënyrë domethënëse gratë e vajzat dhe organizatat e shoqërisë civile në hartimin e ligjeve, politikave dhe programeve që kanë të bëjnë me shëndetin e tyre seksual dhe riprodhues?
- A munden gratë dhe vajzat të kenë akses në shërbime aborti të sigurt, me kujdes ligjor dhe shëndetësor edhe pas abortit?
- A kanë gratë dhe vajzat akses në mallra, shërbime dhe informacione për kontraktivët, që u mundëson të vendosin për numrin e fëmijëve, momentin e ngjjes shtatzënë dhe periudhat mes shtatzënieve? Çfarë barrierash ka ndaj

aksesit në këto mallra, shërbime dhe informacione, si dhe çfarë bën Shteti për t'i hequr ato?

Puna dhe punësimi

Të drejtat dhe mundësitë për punësim të grave duhet të jenë të njëjta me ato të burrave. IKDNj-të duhet të monitorojnë në çfarë mase autoritetet marrin të gjitha masat e nevojshme për eliminimin e diskriminimit ndaj grave në fushën e punësimit, përfshirë masat që gratë të gëzojnë - në masë të barabartë me burrat - këto të drejta:

- Për punë;
- Për mundësi punësimi;
- Për zgjedhje të lirë të profesionit dhe punësimit;
- Për shpërblim të barabartë dhe trajtim të barabartë për punë me vlerë të njëjtë;
- Për ngritje në detyrë, sigurinë e vendit të punës dhe të gjitha përfitimet dhe kushtet e shërbimit;
- Për sigurime shoqërore dhe leje të paguar;
- Për mbrojtjen e shëndetit të tyre dhe për kushte pune të sigurta.

Gjatë monitorimit të gëzimit të të drejtave të grave punëtore, IKDNj-të duhet të mbajnë parasysh aspekte të tilla si:

- Qëndrimet shoqërore dhe kulturore ndaj pranisë së grave në fusha të ndryshme të punës;
- Mundësia e grave që të zgjedhin një profesion lirisht, qoftë edhe jashtë fushave tradicionale të punës së grave;
- Statistika të ndara për gratë në punë (p.sh. shkalla e punësimit sipas sektorit, pozicionit, punësimit formal apo informal, nivelit të të ardhurave);
- Transparenca në proceset e rekrutimit, si edhe dallimet që mund të jenë në kriteret e marrjes në punë për gratë dhe burrat;
- Aksesit i grave në sigurimet shoqërore, përfshirë përfitimet e papunësisë, sëmundjes apo pensionit të pleqërisë;
- Mbrojtja e grave – me ligj dhe në praktikë – nga diskriminimi në punë bazuar në statusin martesor apo mëmësor, përfshirë edhe praktikatat e punëdhënësve që përdorin shtatzëninë apo statusin martesor si kriter për marrjen në punë apo largimin nga puna të punonjësve femra;
- Aktet normative dhe politikat që u lejojnë prindërve të kombinojnë detyrimet familjare me përgjegjësitë e punës, përfshirë aksesin në leje barrë-lindjeje të paguar, leje prindërore të paguar dhe qendra shëndetësore për kujdesin ndaj

fëmijës;

- Mbrojtja e grave – me ligj dhe në praktikë – nga të gjitha format e dhunës në vendin e punës, përfshirë ngacmimin seksual, si edhe aftësinë e grave për të vënë në vend të drejtat e tyre përmes proceseve të përshtatshme administrative dhe gjyqësore.

Strehimi, toka dhe prona

Akcesi në strehim adekuat njihet në instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut si për burrat edhe gratë, mbi baza barazie. Prona dhe toka janë çështje ndërsektoriale që prekin drejtpërdrejtë gëzimin e një sërë të drejtash të njeriut nga gratë.

Gjatë monitorimit të të drejtave të grave në fushën e strehimit, tokës dhe pronës, IKDNj-të mund të mbajnë parasysh aspektet e mëposhtme:

- Rregullat dhe praktikat zakonore që e bëjnë aksesin e grave në strehim, tokë apo pronë të varur nga një person i tretë, shpesh një i afërm mashkull. Për shembull, tradita sipas të cilës bashkëshorti është kryefamiljar dhe ka kontroll mbi pronën martesore gjatë martesës dhe pas ndarjes apo divorcit;
- Në kontekstin e aksesit, përdorimit dhe kontrollit mbi tokën për qëllime jetese, IKDNj-të mund të duhet të analizojnë nëse gratë kanë akses të barabartë në shërbimet e nevojshme për to që të përdorin dhe të kenë kontroll efektiv mbi tokën, të tilla si stimujt bujqësorë dhe kreditë financiare;
- Aksesin e grave në forma të ndryshme të pronës formale dhe informale, si edhe faktorët që kufizojnë apo rrisin këtë akses;
- Korrelacionin potencial ndërmjet incidencës së dhunës në familje dhe llojit të strehimit. Studimet kanë treguar se dhuna ndaj grave mund të rezultojë prej kushteve joadequate të strehimit. Kjo ndodh sepse gratë që nuk gëzojnë sigurinë e pronës e kanë më të vështirë të lënë një marrëdhënie abuzive. Nëse aksesin e tyre në tokë njihet thjesht përmes martesës, gratë mund të dëbohen forcërisht nga toka e tyre pas divorcit. Për këtë arsye, shumë gra viktimë ngurrojnë të ndahen nga dhunuesit dhe të denoncojnë dhunën.

Arsimi

Neni 10 i Konventës për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave u bën thirrje palëve përgjegjëse të marrin masa me qëllim që gratë të gëzojnë të drejtat të barabarta në fushën e arsimit. Në veçanti, ky nen kërkon që gratë të kenë të njëjtat kushte si burrat për aksesin në arsim në të gjitha nivelet, përfshirë arsimin e vazhdueshëm, arsimin fillor, programet mësimore bazë për të rritur, orientimin profesional dhe drejt karrierës, si edhe mundësi të njëjta për të përfituar prej bursave

dhe granteve. Shtetet duhet të eliminojnë konceptet stereotipike për rullet e burrave dhe grave në të gjitha nivelet dhe në të gjitha format e arsimit. Kjo bëhet përmes rishikimit periodik të teksteve mësimore, kurrikulave dhe programeve shkollore dhe përshtatjes së metodave mësimdhënëse, në mënyrë që të reflektojnë norma gjinore më moderne dhe progresive. Shtetet duhet të reduktojnë braktisjen e shkollës prej grave dhe vajzave dhe të miratojnë masa që u mundësojnë kthimin në shkollë, si edhe të ofrojnë mundësi shkollimi për ato që e kanë lënë shkollën para kohe. Gjatë monitorimit të gëzimit të së drejtës për arsimim prej grave dhe vajzave, IKDNj-të duhet të vlerësojnë një sërë aspektesh si:

- Kornizat ligjore dhe të politikave për arsimin dhe barazinë gjinore. A janë buxhetet me ndjeshmëri gjinore dhe adekuate? A reflektohet në kuadrin ligjor e drejta për arsimim?;
- Gëzimi i të drejtës për arsimim cilësor dhe përfshirës nga çdo vajzë, me fokus të veçantë te vajzat më në rrezik marxhinalizimi, përjashtimi dhe lënieje pas (vajzat me aftësi të kufizuara, vajzat që i përkasin një pakice, etj.);
- Diferencimet në mundësitë për arsimim dhe bursa që u ofrohen grave dhe vajzave nga njëra anë, dhe meshkujve e djemve nga ana tjetër;
- Statistikat e ndara (sipas seksit, moshës, përkatësisë etnike, zonës gjeografike, etj.) për arsimimin e grave dhe vajzave në të gjitha nivelet (regjistrimi, ndjekja, ecuria gjatë viteve);
- Disponueshmëria e orientimit dhe mentorimit profesional dhe për karrierë për gratë dhe vajzat studente;
- Dhuna ndaj grave dhe vajzave në aksesin dhe gëzimin e të drejtës së tyre të barabartë për arsimim, përfshirë kontekstin e ekstremizmit të dhunshëm (nga mësuesit, moshatarët studentë, online, etj.);
- Shkalla në të cilën tekstet shkollore, programet shkollore dhe metodat e mësimdhënies kanë ndjeshmëri gjinore që të mos nxitin stereotipet e dëmshme gjinore që minojnë barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave;
- Shkalla e braktisjes së shkollës nga gratë/vajzat studente dhe shkaqet e lidhura me të, duke përfshirë diskriminimin, dhunën me bazë gjinore dhe përjashtimin e grave dhe vajzave që kanë të bëjnë, për shembull, me menstruacionet, shtatzëninë, lindjen e fëmijëve, praktikatat e dëmshme si martesat e fëmijëve, orientimi seksual apo identiteti gjinor;
- Largësia nga shkolla dhe sigurimi i mjeteve të transportit të sigurta, të përballueshme, të ndjeshme ndaj gjinisë dhe të aksesueshme për dhe nga shkolla;
- Aktet normative, politikat apo planet për t'iu dhënë mundësinë grave të rritura mundësinë e kthimit në shkollë apo të ndjekjes së kurseve profesionale;
- Pengesa të tjera që mund të pengojnë aksesin në arsim për gratë dhe vajzat, si

përgjegjësitë joproporcionale familjare apo përkujdesëse, puna e fëmijëve dhe shfrytëzimi apo abuzimi seksual. Mbrojtja e vajzave (apo mungesa e mbrojtjes) ndaj përjashtimit prej palëve të treta në arsim cilësor, përfshirë arsimin e ofruar prej subjekteve private dhe organizatave joshitetërore siç janë shkollat fetare apo komunitare ose shkollat e administruara nga organizatat jofitimprurëse.

Akresi në drejtësi

Akresi në drejtësi është një e drejtë që përfshin të gjitha ndërveprimet e grave me sistemin e drejtësisë. Gjatë monitorimit të aksesit të grave në drejtësi, IKDNj-të duhet të jenë të vetëdijshme se parimi i barazisë para ligjit, siç sanksionohet në Konventën e Stambollit, nënkupton që statusi i barabartë i grave para ligjit duhet të mbrohet. Shtetet duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të garantuar barazinë thelbësore të burrave dhe grave në të gjitha fushat e jetës, përfshirë sistemin e drejtësisë.

Megjithatë, gratë përballen me barriera ligjore, institucionale, sociale dhe të tjera gjatë aksesit në drejtësi.

Monitorimi i aksesit të grave në drejtësi do të thotë të identifikosh vendimet novatore gjyqësore që avancojnë të drejtat e grave dhe të kuptosh faktorët që mundësojnë zhvillime pozitive gjyqësore. Në të njëjtën kohë, duhet të identifikohen dhe analizohen pengesat që i frenojnë gratë të kenë akses dhe të marrin drejtësi.

Shembuj të jurisprudencës novatore lidhur me të drejtën e grave për akses në drejtësi janë:

- Përdhunimi bashkëshortor është krim (bashkëshorti përdhunon bashkëshorten);
- Gratë kanë të drejtë të mos ngacmohen seksualisht në vendin e punës;
- Gratë kanë të drejtë për abort në rrethana të caktuara;
- Ligjet zakonore të trashëgimisë duhet të respektojnë garancitë e barazisë;
- Dhuna seksuale është taktikë lufte dhe krim lufte.

Disa pengesa që nuk lejojnë apo frenojnë aksesin e grave në drejtësi apo që të marrin drejtësi janë:

- Diskriminimi faktik ose konkret, paragjykimet ndaj grave mes profesionistëve – nga oficerët ligjzbatues deri te prokurorët, gjyqtarët dhe avokatët. Kjo mund të vijë nga mosnjohja e ligjeve mbi të drejtat e grave, apo mungesa e ekspertizës në trajtimin e traumave dhe të procedurave për dëgjimin e viktimave që rezultojnë në riviktimizimin.
- Ligjet dhe procedurat që rregullojnë procedurat gjyqësore që diskriminojnë

gratë. Proceset gjyqësore mund të jenë diskriminuese edhe kur ua vështirësojnë grave denoncimin e rasteve dhe arritjen e rezultateve pozitive (p.sh., për shkak të standardeve ose barrës së provës për rastet e dhunës seksuale ose ngacmimeve seksuale në proceset jopenale).

- Barrierat sociale, kulturore dhe institucione – apo mungesa e aksesit – në mjete juridike efektive dhe me ndjeshmëri gjinore, si p.sh. mungesa (totale apo e pjesshme) e njohurive ligjore, kostot, distanca, barrierat lidhur me gjuhën apo provat, apo kërcënimi i sanksionit shoqëror apo stigmës nëse gruaja denoncon shkeljen dhe i drejtohet sistemit të drejtësisë.
- Stereotipizimi gjinor në gjyqësor, kur gjyqtarët dhe profesionistët e tjerë ligjorë nxjerrin përfundime bazuar në besime/supozime të ngulitura, sesa bazuar në faktet e çështjes (p.sh., një grua dhunohet seksualisht sepse ishte “provokuese”). Kjo vlen edhe për situatat ku gjyqtarët nuk adresojnë apo kundërshtojnë stereotipet gjinore të dëmshme në një çështje të caktuar, që nxiten nga një ligj, politikë, argument ligjor apo vendim i një gjykate më të ulët.
- Standardet e barrës së provës që e bëjnë vërtetimin e pretendimeve për dhunë seksuale të vështirë dhe zor të suksesshëm.
- Funksionimi tërësor i gjyqësorit dhe besimi (apo mungesa e tij) te gratë titullare të të drejtave dhe te popullsia në përgjithësi.
- Pengesat për shkelësit, mjetet për të mbrojtur interesat dhe pozitën e tyre në gjykatë dhe jashtë saj, si edhe llogaridhënia (apo mungesa e saj) për sjelljet e kaluara.

Në rastet e shkeljes së të drejtave të grave, këto pengesa që shpesh akumulohen, rezultojnë në nivel të lartë frenues: së pari, rastet nuk denoncohen, ndërsa ato pak raste që denoncohen rrëzohen në zinxhirin e drejtësisë (ndonjëherë me ndërhyrjen e burrave të familja e denoncueses); kështu, një pakicë e vogël rastesh rezultojnë në dënime. Gratë që përballen me forma shumëfishe apo të kryqëzuara diskriminimi shpesh gjenden para pengesave shtesë në aksesin në drejtësi apo kur kërkojnë rivendosjen e të drejtave të njeriut të shkelura.

Stereotipizimi gjyqësor

“Kërkesa e grave për pagë të barabartë për aftësi të barabarta nuk është e justifikuar, sepse gratë pastaj mund të lënë punën për të bërë fëmijë”.

“Është e natyrshme për një burrë që t’i përgjigjet me dhunë një partnereje gërnjare”.

“Burri që vret të shoqen mund të marrë dënim më të butë nëse ajo e ka tradhtuar”.

Këto janë vetëm disa komente të gjyqtarëve ndaj grave. Këto çështje gjyqësore janë cenuar nga nocione të ngulitura thellë të cilat kufizojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave. Drejtësia u është mohuar grave në këto raste dhe kjo

ndodh çdo ditë në gjykata në mbarë botën.

Pavarësisht përpjekjeve prej shumë dekadash për të drejtën e grave për barazi, proceset gjyqësore në mbarë botën shpesh çënohen nga stereotipe gjinore diskriminuese. Kjo mund të arrijë deri në mohimin e të drejtës së grave për drejtësi pikërisht nga sistemi juridik që supozohet të mbrojë të drejtat themelore të njeriut për të gjithë.

Stereotipizimi në sistemin juridik minon drejtësinë për gratë, sidomos në çështjet që kanë të bëjnë me dhunën me bazë gjinore dhe të drejtat dhe shëndetin seksual dhe riprodhues.

Kjo mund të ndodhë në disa mënyrë si më poshtë:

- Paanësia e gjyqtarit komprometohet;
- Stereotipet ndikojnë te bindja e gjyqtarit për besueshmërinë dhe kapacitetin juridik të dëshmitarit. Kjo ndodh kur gjyqtari nuk i jep besueshmëri viktimave që nuk sillen në një mënyrë stereotipike;
- Mënyra se si gjyqtari e kupton veprën penale dhe si interpreton ligjet që disiplinojnë atë vepër penale mund të ndryshojë. E njëjta gjë ndodh me perceptimin e tyre nëse ka ndodhur dhunë apo jo në raste si përdhunimi i punonjëseve të seksit apo i grave të martuara prej bashkëshortëve të tyre, ose rastet e dhunës në marrëdhëniet në çift të të njëjtit seks.
- Stereotipizimi mund të shtyjë gjyqtarin që të mos kërkojë përgjegjësinë të shkelësi, por madje edhe të fajësojë viktimën.
- Stereotipet ndikojnë te bindja e gjyqtarëve për besueshmërinë dhe kapacitetin ligjor të dëshmitarit, për shembull kur krijojnë përshtypje negative për besueshmërinë e viktimës që nuk sillet në një mënyrë stereotipike.
- Mund të pengojë aksesin në të drejtat juridike dhe mbrojtjen për gratë viktime. Si pjesë e monitorimit të aksesit të grave në drejtësi, ekipet në terren mund të ndërmarrin studime/kërkime dhe të raportojnë për stereotipizimin gjyqësor (p.sh., duke analizuar se si hetohen dhe disponohen çështjet e krimeve seksuale, si edhe çështjet lidhur me të drejtat dhe shëndetin seksual dhe riprodhues, si ato për abortin, punën e seksit, transmetimin e HIV-it, marrëdhëniet jashtëmartesore, kontrceptimin, sjellje seksuale kundrejt të njëjtit seks, si edhe identitetin gjinor).

IKDNj-të duhet të avokojnë për masa që të kapërcehen pengesat që privojnë apo kufizojnë aksesin e grave në drejtësi, si edhe duhet të monitorojnë ndikimin e masave të tilla. Këto mund të jenë:

- Për paditësit gra, ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike që janë me ndjeshmëri gjinore, të aksesueshme dhe të qëndrueshme.
- Krijimi i gjykatave të specializuara si p.sh. salla të posaçme gjyqi me video, që ndihmojnë për ta sjellë drejtësinë në zonat e largëta rurale.

- Punësimi i grave në pozicionet ligjzbatuese. Statistikat tregojnë se ekziston korrelacion pozitiv ndërmjet pranisë së efektive policore femra dhe denoncimit të dhunës seksuale. Përvoja tregon se thjesht punësimi i grave nuk mjafton: nevojiten edhe investime adekuate në burime dhe ekspertizë.
- Ngritja e rrjeteve referuese të shërbimeve mbështetëse të cilat ofrojnë trajtim mjekësor urgjent (përfshirë ekzaminimin mjekoligjor), kujdes të shëndetit seksual dhe riprodhues, mbështetje psikosociale, strehim dhe këshillim ligjor për gratë, në një mënyrë holistike, konfidenciale, me ndjeshmëri gjinore dhe miqësore ndaj të mbijetuarës. Kjo ka rezultuar në ulje të konsiderueshme të fërkimeve dhe rritje të numrit të dënimeve.
- Edukimi i gjyqtarëve, avokatëve dhe policisë mbi standardet dhe parimet e të drejtave të grave, çfarë kuptimi kanë dhe si zbatohen, si edhe sensibilizimi ndaj stereotipizimit gjinor.

Sistemet gjyqësore formale janë vetëm një rrugë përmes të cilës gratë mund të kenë akses në drejtësi. Nga nevoja apo zgjedhja e tyre e lirë, shumë gra, sidomos ato që jetojnë në zona të varfra urbane apo rurale, e kërkojnë drejtësinë përmes **sistemeve informale të drejtësisë**. Këto sisteme shpesh zbatojnë praktika për ushtrimin e autoritetit bazuar në koncepte të perceptuara kulturore, zakonore apo fetare, si dhe prirën të vënë theksin te harmonia komunitare sesa te të drejtat individuale. Zakonisht, këto sisteme dominohen prej burrave dhe favorizojnë disponimet patriarkale që shpesh përforcojnë praktikat diskriminuese ndaj grave.

Ku të referohen Viktimat për Ndihmë

Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza - (Linja Komëtare për Viktimat e DhBGj, DhNG dhe Dhunës Seksuale) Adresa: Rr “Muhamet Gjollësia”, Pall 122, Ap. 8 Tiranë, 1023 Linja telefonike falas: 116 117 Tel: +355 422 33408 E-mail: linjakeshillimit@gmail.com info@clwg.al Ueb: www.hotlinealbania.org - Aktivitetet: Ofron këshillim në telefon për viktimat e dhunës në familje dhe seksuale përmes një linje falas; këshilli ballë përballë dhe në grup; asistencë ligjore dhe referim të viktimave të shërbimet e tjera. Ofron ndërtim kapacitetesh për palët e interesuara, aktivitete sensibilizuese, lobim dhe avokim për të drejtat e grave, etj.	Linja e Këshillimit për Burra e Djem Adresa: Rr “Vllazën Huta”, Shk 1, Kati 8, Ap. 39, Tiranë, 1010 Tel: (04) 2363712 E-mail: linjakeshillimit@gmail.com Ueb: www.clmb.al - Aktivitetet: Ofron shërbime këshillimi për burra dhe djem nën urdhër gjykatë, në shërbim prove, sistem penitenciar dhe me vetëreferim. Trajnim i të rinjve dhe krijim rrjetesh rinore, trajnime në shkolla dhe fushata sensibilizimi. Lobim dhe avokim për të rinjtë. Mbështetje për fushatat e baballarëve dhe ndërtim kapacitetesh për punonjësit edukues në burgje dhe shërbim prove.
Qendra për Nisma Ligjore Qytetare Adresa: Rr. “Vaso Pasha” Pall 12, Shk 1, Ap 1. Tiranë Tel: 00355 4 2 259 795 E-mail: avokatore@albmail.com Ueb: www.qag-al.org Aktivitete: Funksionin si qendër shërbimesh ligjore për gratë e dhunuara dhe të varfra.	Shoqata “Refleksione” Adresa: Rr.Elbasanit, P.Fratari, Tërshana, Tiranë Tel: E-mail: info@refleksione.org Web: www.refleksione.org Aktivitetet: Mbron të drejtat e grave dhe lufton kundër diskriminimit të grave në të gjitha llojet dhe format. Projektet e saj synojnë nxitjen e pjesëmarrjes së grave në jetë sociale, politike dhe ekonomike të vendit, si edhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në hartim politikash dhe vendimmarrje.

Strehëza për Gratë e Dhunuara Aktivitetet: Asiston dhe mbështet gratë dhe vajzat që kanë rënë viktimë e dhunës gjinore (fizike, emocionale, seksuale, ekonomike dhe të tjera). Ofron edhe kujdes dhe mbështetje për fëmijët e nënave të dhunuara. Gratë, vajzat dhe fëmijët e dhunuar gjejnë strehim, mbështetje emocionale dhe këshillim.	Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” Adresa: Rr. “Abdyl Frashëri”, P.10/1, Ap.3, Shk.1, Tirana, Tel: +355 42 255 514 E-mail: gadc@gadc.org.al Ueb: www.gadc.org.al Aktivitetet: QAGjZh punon kryesisht në fushat e integritetit gjinor, integritetit në BE, fuqizimit ekonomik, qeverisjes, buxhetimit gjinor, dhunës ndaj grave, arsimit dhe media.
Shoqata “Unë Gruaja” Adresa: Rr. Kajo Karafili, Pogradec Tel: 083222140 E-mail: une_gruaja@yahoo.com; Ueb: www.unegruaja.com Aktivitetet: Shërbime këshillimi, ndërgjegjësim publik, informim, inkurajim i grave që të marrin pjesë aktivisht në vendimmarrje, monitorim të vendimeve të qeverisjes vendore nga perspektiva gjinore dhe drejtim i fushatave të avokimit dhe lobimit në nivel vendor dhe kombëtar.	Gruaja te Gruaja Adresa: Lagjia “Vasil Shanto”, Rruga “Marin Barleti”, Nr. 161, Shkodër Tel: 0682079112 E-mail: gruajatekgruaja@gmail.com Ueb: www.gruajatekgruaja.com Aktivitetet: Shërbime drejtpërdrejtë për fëmijët, gratë dhe vajzat që janë viktime të dhunës në familje – si këshillin, strehim 48-orësh dhe ndihmë juridike.

Shoqata e Grave me Probleme Sociale Adresa: L.2, Rruga “Sefer Efendiu”, prapa Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës Tel: 052234600 E-mail: shoqatagrave@yahoo.com ; gendraekeshillimit@yahoo.com ; Ueb: www.drejttesisociale.com Aktivitetet: Ofron shërbime psikosociale, ligjore dhe mjekësore, si edhe informim dhe fushata sensibilizuese.	Qendra Psikosociale “Vatra” Adresa: “Nermin Vlora Falaski” Pallati 13, Shkalla I, Kati i tretë Vlorë, Shqipëri Tel: +355 33 22 40 78 E-mail: info@qendravatra.org.al Ueb: www.qendravatra.org.al Aktivitetet: Ofron strehim për viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje. Informim dhe sensibilizim të opinionit publik mbi rreziqet e fenomeneve të trafikimit të personave dhe dhunës në familje si edhe të problemeve të tjera që ato shkaktjnë; Përmirësim i statusit social të një numri të madh viktimash të trafikimit dhe dhunës në familje;
Forumi i Gruas Adresa: Lagja “5 Maj”, Rruga “Muç Shqiptari” Pallati 450/1, Elbasan Tel: 054257723; 054254516 E-mail: forumigruaselbasan1991@gmail.com .com Ueb: www.forumigruaselbasan.org Aktivitetet: Organizata ka përvojë të gjerë me të drejtat e grave, ofrimin e shërbimeve drejtpërdrejtë grave dhe vajzave në nevojë, kapacitete trajnuese, si edhe ofrues shërbimesh menaxhimi dhe specifike. Organizata asiston çdo vit mbi 180 raste me këshillim psikologjik dhe ligjor. Ofron strehim për 48-72 orë.	Another Vision Adresa: Lagja “Aqif Pasha” Rruga “Ali Arapi”, Nr.19 Elbasan Tel: 00355 54 252919 E-mail: tjetervizion@gmail.com Ueb: www.tjetervizion.org Aktivitetet: Qendër ditore për fëmijë, shërbime për fëmijë, të rinj dhe gra, si edhe strehim.

Qendra Sociale “Hapa të Lehtë” Adresa: Rr. Murgeshave Nr 6, Shkodër Tel: 022241316 E-mail: qendragruashk@yahoo.com ; hapatelehte@gmail.com; Ueb: www.hapatelehte.org Aktivitetet: Ofron shërbime psikosociale, ligjore dhe mjekësore, si edhe aktivitete informimi dhe sensibilizimi.	Shoqata “Jona” Adresa: Rruga “Adem Sheme” Sarandë Tel: 085 222 425 E-mail: jonaojq@yahoo.com Ueb: www.facebook.com/pg/ShoqataJona Aktivitetet: Punon për të parandaluar dhunën në familje dhe trafikimin e personave. Mbledh të dhëna dhe punon të përmirësojë marrëdhëniet ndëretnike dhe gratë e vajzat e kualifikuara që të përfitojnë aftësitë që kërkon tregu i punës.
Qendra “Agritra Vizion” Adresa: Peshkopi E-mail: a-vizion@adanet.com.al Ueb: www.anrd.al Aktivitetet: Asiston dhe këshillon gratë rurale në zonën e Dibrës për sektorët e bujqësisë, blegtori dhe agropërpunimit, që të stimulojë dhe mbështetë organizimin (bashkëpunimin) e grave në grupe si mundësi për rritjen e rolit ekonomik të tyre në familje dhe komunitet.	Zyra për Burra dhe Djem Adresa: Shkodër Tel: +35522241154 E-mail: endrituligaj@yahoo.com Ueb: http://www.clmb.al/hello-world/ Aktivitetet: Këshillim individual për burrat dhe djemtë e dhunshëm, asistencë në menaxhim rasti, konflikti dhe sjelljeje agresive. Sensibilizim përmes medias.

REFERENCAT

- European Commission, Albania 2018 Report,. <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf> [accessed 22 Nov. 2021].
- Council of Europe, 1st General Report on GREVIO's Activities covering the period from June 2015 to May 2019. Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence (GREVIO).. 2019. <https://rm.coe.int/1st-general-report-on-grevio-s-activities/16809cd382> [accessed 22 November 2021].
- Council of Europe, Baseline Evaluation Report: Albania. Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence (GREVIO).. 2016. <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7> [accessed 22 Nov. 2021].
- Council of Europe, Council of Europe Convention on Action Against Trafficking in Human Beings, 16 May 2005, CETS 197, available at: <https://ec.europa.eu/anti-trafficking/council-europe-convention-action-against-trafficking-human-beingsen> [accessed 22 November 2021].
- [Council of Europe, ECRI General Policy recommendation No. 2, Equality Bodies to combat racism and intolerance at national level, February 2018, par 40 a-b. 16808b5a23 \(coe.int\)](#) [accessed 23 November 2021].
- Council of Europe. Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms, Nov. 4, 1950, Europ.T.S. No. 5; 213 U.N.T.S. 221. Available at: https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/005/declarations?p_auth=13Q66ql5&_coconventions_WAR_coeconventionsportlet_enVigueur=false&_coconventions_WAR_coeconventionsportlet_searchBy=state&_coconventions_WAR_coeconventionsportlet_codePays=ALB&_coconventions_WAR_coeconventionsportlet_codeNature=10 [accessed 22 November 2021].
- Council of Europe, ECRI Report on Albania (6th monitoring cycle). Adopted on 7 April 2020.. <https://rm.coe.int/report-on-albania-6th-monitoring-cycle-16809e8241> [accessed 22 November 2021].
- Law no. 7895, dated 27 January 1995, "Criminal Code of the Republic of Albania". Available at: <https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation/send/10-criminal-code/11-criminal-code-en> [accessed 22 Nov. 2021].

- Leviz Albania, Monitoring the referring mechanism for cases of violence in the family at the local level, April 2018. Available at <https://portavendore.al/wp-content/uploads/2018/05/“Monitorim-i-Mekanizmit-të-Referimit-për-rastet-e-Dhunës-në-Familje-në-nivel-lokal-aktivizëm-qytetar-për-përmirësimin-e-tij”.pdf> [accessed 23 November 2021].
- National Institute of Statistics (INSTAT) Albania. Domestic Violence in Albania, National population- based Survey, November 2013. pp. 9, 55, 56. http://www.instat.gov.al/media/2618/dhuna_ne_familje_ne_shqiperi_2013.pdf [accessed 22 Nov. 2021].
- OSCE Presence in Albania, Needs Assessment on National Human Rights Institutions in Albania, Mauro Puzzo, Albana Gerxhi, June 2021
- Principles relating to the Status of National Institutions (The Paris Principles). Adopted by the UN General Assembly resolution 48/134 of 20 December 1993. Available at: <https://www.un.org/ruleoflaw/files/PRINCI~5.PDF> [accessed 22 November 2021].
- UN General Assembly, Universal Declaration of Human Rights, 10 December 1948, 217 A (III), available at: <https://www.refworld.org/docid/3ae6b3712c.html> [accessed 22 November 2021]
- UN General Assembly, Convention on the Rights of Persons with Disabilities: resolution / adopted by the General Assembly, 24 January 2007, A/RES/61/106, available at: <https://www.refworld.org/docid/45f973632.html> [accessed 22 November 2021].
- UN General Assembly, Convention on the Rights of the Child, 20 November 1989, United Nations, Treaty Series, vol. 1577, p. 3, available at: <https://www.refworld.org/docid/3ae6b38f0.html> [accessed 22 November 2021].
- UN General Assembly, International Convention on the Protection of the Rights of all Migrant Workers and Members of Their Families : resolution / adopted by the General Assembly, 18 December 1990, A/RES/45/158, available at: <https://www.refworld.org/docid/3b00f2391c.html> [accessed 22 November 2021].
- UN General Assembly, International Covenant on Civil and Political Rights, 16 December 1966, United Nations, Treaty Series, vol. 999, p. 171, available at: <https://www.refworld.org/docid/3ae6b3aa0.html> [accessed 22 November 2021].
- UN General Assembly, International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights, 16 December 1966, United Nations, Treaty Series, vol. 993, p. 3, available at: <https://www.refworld.org/docid/3ae6b36c0.html> [accessed 22 November 2021].

- UN General Assembly. Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women. New York, 18 December 1979. Available at : <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cedaw.aspx> [accessed 22 November 2021].
- UN CRPD, Concluding Observations on the initial report of Albania. Committee for the Rights of Disabled Persons. 14 October 2019, para. 31. Available at : <http://docstore.ohchr.org/SelfServices/ler.x?enc=6QkG1d%2FPPRiCAqhKb7yhspdJq2SN0FynLS%2BUiWUaqofjmf0rHJ5MLWvzpc5ePiublk65eOKd%2FNGE6rLwV%2B8UH2qHAW2phpnAZHHFMFuZbruUZnINmuu8vWWy5fRMtguz> [accessed 22 November 2021].